



# ROLI DREJTUES I PROKURORIT



---

**Roli Drejtues i Prokurorit**

**MANUAL  
PËR  
PROKURORË**

Tirana, 2020

Autor: **Lence Ristoska**

*Konsulente ndërkombëtare*

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret lirisht dhe të kopjohet për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jo tregtare, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një thënie që njeh OSBE si burim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë, dosmosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

# LISTA E AKRONIMEVE

|                           |  |
|---------------------------|--|
| <b>KP</b>                 | Kodi Penal i Shqipërisë  |
| <b>KPP</b>                | Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë   |
| <b>BE</b>                 | Bashkimi European  |
| <b>EUROJUST</b>           | Agjencia e BE-së për Bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë Penale                               |
| <b>EUROPOL</b>            | Agjencia e BE-së për Bashkëpunimin e Agjencive Ligjzbatuese                                    |
| <b>FIU</b>                | Njësia e Hetimit Financiar ose Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. |
| <b>PP</b>                 | Prokuror i Përgjithshëm  |
| <b>INTERPOL</b>           | Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale  |
| <b>IPA</b>                | Instrumenti i Ndhmës së Para-Anëtarësimit  |
| <b>IT</b>                 | Teknologji Informacioni  |
| <b>GPH</b>                | Grupe të Përbashkëta Hetimore  |
| <b>PGJ</b>                | Policia Gjyqësore  |
| <b>OPGJ</b>               | Oficer i Policisë Gjyqësore  |
| <b>OLAF</b>               | Zyra Europiane kundër Mashtrimit   |
| <b>OSBE</b>               | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë  |
| <b>NNJ</b>                | Ndihma e Ndërsjellë Juridike   |
| <b>Prezenca e OSBE-së</b> | Prezenca e OSBE-së në Shqipëri   |
| <b>SHISH</b>              | Shërbimi Informativ Shtetëror  |
| <b>SPAK</b>               | Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar                              |
| <b>OKB</b>                | Organizata e Kombeve të Bashkuara  |
| <b>UNODC</b>              | Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin                               |

# SHKURTIME

- Ligji nr. 9157/2003    Ligji nr. 9157/2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10192/2009    Ligji nr. 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera përmes masave parandaluese kundër pasurisë”.
- Ligji nr. 112/2015    Ligji nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”.
- Ligji nr. 95/2016    Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
- Ligji nr. 96/2016    Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 97/2016    Ligji nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 25/2019    Ligji nr. 25/2019 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

# TABELA E PËRMBAJTJES:

|                                  |          |
|----------------------------------|----------|
| <b>Hyrje .....</b>               | <b>9</b> |
| 1. Konteksti .....               | 9        |
| 2. Metodologjia .....            | 10       |
| 3. Shënime të përgjithshme ..... | 11       |

## **Pjesa I - Roli drejtues në Prokurori dhe në Prokurorinë e Posaçme .....**

**12**

|  |    |
|--|----|
| I. Përmirësimi i bashkëpunimit me policinë .....   | 12 |
| 1. Varësia e dyfishtë dhe zinxhiri i komandës .....  | 13 |
| 2. Aktivitete të përbashkëta .....   | 15 |
| 3. Trajtimi i problemeve dhe ndarja e përvajës .....   | 19 |
| II. Përdorimi më i mirë i burimeve në Prokurori dhe në Prokurorinë e Posaçme .....               | 20 |
| 1. Përmirësimi i cilësisë së referimit të policisë .....   | 21 |
| 2. Prezantimi i praktikave profesionale .....  | 23 |
| III. Përmirësimi i perceptimit të publikut për punën e Prokurorisë/ Prokurorisë së Posaçme ..... | 25 |
| 1. Strategjitë e komunikimit .....   | 25 |
| 2. Dokumentimi i punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme .....                               | 29 |
| 3. Rritja e proaktivitetit të punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme .....                  | 31 |

## **Pjesa II - Roli drejtues i prokurorëve .....**

**33**

|   |    |
|---|----|
| I. Menaxhimi i ngarkesës së punës .....                             | 33 |
| 1. Përmirësimi i dokumentimit .....                                 | 33 |
| 2. Organizimi i punës .....   | 35 |
| 2.1. Prezantimi i procesverbaleve për aktivitetet e ndërmarra ..... | 35 |
| 2.2. Organizimi i punës në varësi të llojit të çështjeve .....      | 35 |
| 2.2.1. Kallëzimi penal dhe procedimi penal .....                    | 36 |
| 2.2.2. Organizimi i punës në çështje me autor të panjohur .....     | 37 |
| 2.2.3. Organizimi i punës në çështjet me autor të njohur .....      | 37 |
| 2.2.4. Organizimi i punës për kundërvajtjet penale .....            | 37 |

|  |           |
|--|-----------|
| 2.2.5. Organizimi i punës për krimet .....   | 38        |
| 2.2.6. Organizimi i punës në çështje komplekse .....   | 39        |
| <b>2.3.    Vendosja e përparësive në punë .....</b>  | <b>47</b> |
| <b>II.    Menaxhimi i çështjes .....</b>   | <b>49</b> |
| <b>1.    Kryerja e hetimit .....</b>   | <b>49</b> |
| <b>1.1.    Planifikimi i hetimit .....</b>   | <b>49</b> |
| 1.1.1. Veprimet përgatitore të prokurorit .....  | 50        |
| 1.1.2. Hartimi i urdhrat të hetimit .....  | 52        |
| 1.1.3.    Veprime hetimore .....   | 54        |
| 1.1.3.1.    Identifikimi i personave me interes .....  | 55        |
| 1.1.3.2.    Mbledhja e informacionit dhe marrja e dëshmisë nga dëshmitarët .....                           | 55        |
| 1.1.3.3.    Mbledhja e informacionit nga personi nën hetim dhe marrja në pyetje e personit nën hetim ..... | 58        |
| 1.1.3.4.    Ballafaqimet .....   | 59        |
| 1.1.3.5.    Njohjet .....  | 59        |
| 1.1.3.6.    Kryerja e një eksperimenti.....  | 60        |
| 1.1.3.7.    Mbledhja e dokumenteve .....   | 61        |
| 1.1.3.8.    Marrja e të dhënave kompjuterike .....   | 62        |
| 1.1.3.9.    Verifikimet e ngutshme në vend .....   | 65        |
| 1.1.3.10.    Këqyrjet .....  | 69        |
| 1.1.3.11.    Kontrollet .....  | 70        |
| 1.1.3.12.    Sekuestrimet .....  | 72        |
| 1.1.3.13.    Përgjimet .....   | 73        |
| 1.1.3.14.    Veprime simuluese .....   | 76        |
| 1.1.3.15.    Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal .....   | 76        |
| 1.1.3.16.    Dorëzimi i kontrolluar .....  | 78        |
| <b>1.2.    Zhvillimi i mëtejshëm i hetimit .....</b>   | <b>78</b> |
| 1.2.1. Angazhimi i një eksperti .....  | 79        |
| 1.2.2. Masat e sigurimit .....   | 79        |
| 1.2.3. Kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare .....   | 81        |
| <b>1.3.    Mbyllja e hetimit .....</b>   | <b>83</b> |
| 1.3.1. Pezullimi i çështjes .....  | 84        |



|   |           |
|---|-----------|
| 1.3.2. Pushimi i akuzës ose çështjes .....  | 85        |
| 1.3.3. Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë .....   | 86        |
| 1.3.4. Kërkesa për urdhër penal .....   | 86        |
| 1.3.5. Kërkesa për verifikimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë<br>dhe caktimin e dënimit ..... | 87        |
| 1.3.6. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq .....  | 90        |
| <b>2. Trajtimi i situatave specifike .....</b>  | <b>91</b> |
| 2.1. Sigurimi i provës .....  | 91        |
| 2.2. Kryerja e hetimeve financiare .....  | 91        |
| 2.3. Rastet e korrupsionit .....  | 94        |
| 2.4. Grupet e Përbashkëta Hetimore .....  | 96        |
| <b>3. Përmirësimi i bashkëpunimit me OPGJ .....</b>   | <b>98</b> |
| 3.1. Referimi i çështjes .....  | 99        |
| 3.2. Komunikimi me OPGJ-të .....  | 101       |
| 3.3. Rritja e efektivitetit të OPGJ-së .....  | 102       |

## **Pjesa III - Anekse .....104**

### **Aneksi I - Udhëzim i Përgjithshëm për Policinë Gjyqësore ...105**

### **Aneksi II - Udhëzim i Përgjithshëm për Referimin e Policisë ....114**

### **Aneksi III - Udhëzim i Përgjithshëm për Praktikat Profesionale .....120**

### **Aneksi IV - Fleta e Dokumentimit të Veprimtarisë ..... 128**

### **Aneksi V - Shembull i planifikimit të hetimit për kundërvajtjet penale ..... 132**

### **Aneksi VI - Planifikimi i hetimit ..... 134**

### **Aneksi VII - Listat e kontrollit për rezultatet dhe verifikimet e kërkuara ..... 141**

### **Aneksi VIII - Diagrami për përzgjedhjen e veprimit hetimor të përshtatshëm ..... 144**



# HYRJE

## 1. Konteksti

Në vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë nisi një reformë gjithëpërfshirëse në drejtësi përmes miratimit të ndryshimeve kushtetuese së bashku me 27 ligje ‘urgjente’, duke reformuar *ndër të tjera* organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, duke rritur autonominë e prokurorëve dhe duke formalizuar rolin e tyre drejtues në fazën hetimore të procedimeve penale.<sup>1</sup> Në fakt, sipas Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, të ndryshuar, prokurori dhe policia gjyqësore, në kuadër të kompetencave të tyre përkatëse, zhvillojnë hetimet e nevojshme për ndjekjen penale. Prokurori drejton hetimin dhe ka policinë gjyqësore në dispozicion të tij/të saj.<sup>2</sup>

Në vitin 2019, Departamenti i Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ndërmori një analizë në lidhje me bashkëpunimin në hetime ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri. U identifikuan një sërë fushash që kërkonin ndërhyrje si në drejtim, organizim, rregullim dhe legjislacion, ku roli drejtues i prokurorisë në fazën hetimore të procedimit penal u dallua si një nga problemet më të ngutshme.<sup>3</sup>

Ky Manual u përgatit në kuadër të projektit të Prezencës në vitin 2020 “Mbështetje për progresin e shtetit të së drejtës në Shqipëri”.

1 E ashtuquajtura “paketa e reformës në drejtësi” përfshin *ndër të tjera* ndryshimet kushtetuese, ndryshimet në KP dhe KPP, ligjin nr. 95/2016, ligjin nr. 96/2016, ligjin nr. 97/2016 dhe ligjin nr. 25/2019.

2 Neni 277 i KPP.

3 *Rritja e Bashkëpunimit dhe Koordinimit ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në Shqipëri*, OSBE, Tiranë 2019 <https://www.osce.org/files/f/documents/3/f/442660.pdf> (këtu e më poshtë, “Raport i Prezencës së OSBE-së 2019”).

Manuali nuk synon të bëjë interpretimin e dispozitave ligjore. Gjithashtu, nuk shërben si manual për mënyrën e kryerjes së hetimeve. Përkundrazi, fokusohet në zgjidhjet praktike që kanë të bëjnë me rolin drejtues të prokurorëve në fazën hetimore të procedimit penal, duke adresuar sfidat kryesore me të cilat përballen profesionistët. Qëllimi kryesor i Manualit është të inkurajojë sjelljen proaktive të prokurorëve dhe t'u japë atyre rekomandime për të ushtruar më mirë rolin e tyre drejtues. Prandaj, Manuali fokusohet në aspektet organizative që mund t'i ndihmojnë prokurorët të përdorin më mirë burimet në dispozicion dhe në aspektet praktike që prokurorët duhet të kenë parasysh gjatë hetimit.

## 2. Metodologjia

Procesi i përgatitjes së këtij Manuali filloi me një rishikim dhe vlerësim të kuadrit ligjor dhe materialeve mbështetëse përkatëse.

U shqyrtua me kujdes kuadri ligjor aktualisht në fuqi që rregullon dhe ndikon në punën e prokurorive në lidhje me aspektet organizative si edhe procedurale të punës së tyre dhe bashkëpunimin me policinë gjyqësore. Këtu përfshihet legjislacioni parësor dhe dytësor, si edhe akte të tjera normative në dispozicion. Burimet janë përkthime jozyrtare në gjuhën angleze të akteve të vëna në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme dhe burime të tjera zyrtare.<sup>4</sup>

Gjithashtu, për hartimin e këtij Manuali u vunë në dispozicion raporti i vitit 2019 për Rritjen e Bashkëpunimit dhe Koordinimit ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në Shqipëri<sup>5</sup>, raporti i tij statistikor dhe transkriptimet e intervistave të mëparshme me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të zhvilluara gjatë analizës së kryer nga stafi i Prezencës në disa prokurori dhe drejtori policie në vend. U konsultuan edhe materiale mbështetëse të hapura për publikun.<sup>6</sup>

Konstatimet paraprake dhe hipotezat e punës që rezultojnë nga puna kërkimore e sipërpërmendur u përdorën për të zhvilluar pyetje gjysmë të strukturuar për intervista anonime me një grup të vogël prokurorësh nga prokuroritë e Fierit, Vlorës, Elbasanit, SPAK dhe Prokuroria e Përgjithshme

4 Përveç ligjeve të përmendur *supra*, shënimi 1, u konsideruan aktet normative të mëposhtme: Ligji nr. 9157/2003; Ligji nr. 10192/2009; Ligji nr. 112/2015; Ligji nr. 9918/2008; Udhëzimi i Përgjithshëm i PP nr.12/2020 për Rolin Drejtues të Prokurorisë brenda Prokurorive.

5 Cituar, *supra*, shënim 3.

6 Raporti i Progresit të BE-së, Manualet e UNDOC, rekomandime të Komisionit të Venecias, etj. Lista e plotë e bibliografisë të përdorur jepet në fund të Manualit.

për të analizuar situatën përpara hartimit. Qëllimi i intervistave ishte të krijohej një ide për aspektet praktike të punës së prokurorëve dhe sfidat më të mëdha në ushtrimin e rolit të tyre drejtues në hetime. Pyetjet ishin kryesisht të hapura për t'i dhënë mundësi intervistuesit të ndiqte përgjigjet e marra.

Manuali është strukturuar si më poshtë:

**Pjesa 1** shqyrton rolin drejtues në prokurori, duke theksuar (i) nevojën dhe mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit me PGJ, (ii) përdorimin më të mirë të burimeve dhe (iii) përmirësimin e perceptimit të publikut për punën e prokurorisë.

**Pjesa 2** trajton rolin drejtues të prokurorëve, duke u përqendruar në (i) menaxhimin e ngarkesës në punë dhe (ii) menaxhimin e çështjes.

**Pjesa 3** përbëhet nga tetë Anekse që japin shembuj praktikë mbi tema konkrete, ku çdo aneks përmban një ose më shumë materiale, në varësi të temës që trajton. Referencat për Anekset jepen në kapitullin përkatës të Manualit.

### 3. Shënime të përgjithshme

Me zhvillimin në rritje të teknologjive novatore, globalizimin dhe qasjen në informacion, lufta kundër krimit bëhet gjithnjë e më e vështirë, pasi kriminelët përdorin zhvillimet dhe mundësitë e reja që ekzistojnë.<sup>7</sup> Për rrjedhojë, hetimet penale duhet të ndjekin zhvillimet e reja dhe të trajtojnë sfidat e reja. Prokurorët si drejtues të hetimit, më shumë se kurrë, duhet të marrin rolin drejtues që u ngarkon ligji dhe të miratojnë qasje të reja inovative për kryerjen e hetimeve, duke përdorur kërkesat dhe mundësitë ligjore në favor të tyre, duke vepruar në mënyrë proaktive dhe si frymëzim për të gjithë pjesëmarrësit në hetim. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore në organizimin e punës së tyre, në menaxhimin e burimeve dhe në hartimin e strategjive të hetimit do të jetë vlerë e shtuar në çdo hetim.

<sup>7</sup> Për më shumë informacion shihni: <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/do-criminals-dream-of-electric-sheep-how-technology-shapes-future-of-crime-and-law-enforcement>

# PJESA I

## ROLI DREJTUES NË PROKURORI DHE NË PROKURORINË E POSAÇME

Ngarkesa e madhe e punës dhe burimet e kufizuara karakterizojnë situatën në të gjitha prokuroritë në mbarë Shqipërinë.<sup>8</sup> Prandaj, rritja e efikasitetit dhe e efektivitetit të prokurorisë është thelbësore për të garantuar një proces të fuqishëm të ndjekjes penale dhe për të mbështetur punën e prokurorëve. Duke pasur parasysh problemet praktike me të cilat përballen aktualisht prokurorët, në këtë pjesë të Manualit trajtohen aspekte të (i) përmirësimit të bashkëpunimit me policinë, (ii) përdorimit më të mirë të burimeve, (iii) përmirësimit të perceptimit publik në punën e prokurorisë dhe (iv) rritjes së proaktivitetit të tyre.

Aspektet procedurale të disa prej temave të përmendura do të trajtohen në pjesën II të këtij Manuali.

### **I. Përmirësimi i bashkëpunimit me policinë**

Legjislacioni në Shqipëri thekson rolin drejtues të prokurorëve në hetime, ku përcaktohet se prokurori drejton hetimin dhe ka policinë gjyqësore në dispozicion të tij/të saj.<sup>9</sup> Prandaj, përmirësimi i bashkëpunimit me policinë është thelbësor për të siguruar rezultat më të suksesshëm të punës së prokurorisë. Edhe pse kjo marrëdhënie mund të vërehet në nivele të ndryshme, në këtë kapitull do të shtjellohen vetëm çështjet organizative në lidhje me bashkëpunimin me policinë, duke trajtuar sfidat kryesore me të cilat përballen profesionistët.

8 Për një vështrim të detajuar të sfidave me të cilat përballen prokuroritë shqiptare shihni Raportin e vitit 2019 të Prezencës së OSBE-së, cituar, *supra*, shënimi 3.

9 Neni 277, paragrafi 2 i KPP.

## 1. Varësia e dyfishtë dhe zinxhiri i komandës<sup>10</sup>

Varësia e dyfishtë e shërbimeve të OPGJ-së është një problem që krijon vonesa në procedura, ul besimin mes prokurorit dhe policisë gjyqësore dhe mundëson rrjedhjen e informacionit duke e bërë të pamundur përcaktimin e burimit të informacionit të rrjedhur. Përveç kësaj, transferimet e OPGJ-ve dhe lëvizja e tyre pa autorizimin e prokurorit shkakton paqëndrueshmëri në menaxhimin e çështjes.<sup>11</sup> Rregullimi i këtyre çështjeve të rëndësishme jo vetëm që do të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve aktuale, por gjithashtu do të sjellë drejtim vizionar dhe qëndrim proaktiv duke mundësuar pavarësi më të lartë të hetimeve.

### — Rekmandime praktike —

Problemet e menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të shkaktuara nga varësia e dyfishtë mund të kapërcehen në praktikë duke përdorur dispozitat ligjore të parashikuara në kuadrin ligjor. Rregullimi i marrëdhënies mes PGJ dhe prokurorëve me udhëzime të përgjithshme të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm duket se është një mënyrë efektive për të trajtuar shumicën e problemeve delikate në lidhje me këtë marrëdhënie.<sup>12</sup>

Prandaj, një udhëzim i përgjithshëm mund të rregullojë zinxhirin e komandës dhe varësinë e OPGJ gjatë hetimeve. Kuadri ligjor ekzistues qartëson se gjatë hetimeve oficerët e policisë gjyqësore i raportojnë prokurorit.<sup>13</sup> Duke pasur parasysh detyrimin e OPGJ-ve për të ruajtur fshehtësinë dhe sekretin hetimor dhe ndalimin e publikimit të dokumenteve dhe rrjedhjes së informacionit,<sup>14</sup> varësia e oficerëve të policisë gjyqësore vetëm nga prokurori nuk jep shkak për dyshim.

Në mënyrë që të jepen rregulla të qarta për zinxhirin e komandës dhe varësinë e OPGJ gjatë hetimeve, udhëzimi i përgjithshëm duhet të parashikojë protokolle komunikimi mes prokurorëve dhe PGJ, duke u përqendruar në modalitetet e komunikimit (për shembull, kush duhet të jetë

10 Kuadri ligjor përkatës: Neni 3, paragrafi 1, Neni 38, paragrafi 2-gj dhe 2-g, Neni 42, paragrafi 1-a, 1-b, 1-e dhe 1-gj, Neni 46, paragrafi 1, 2, 3-a, 4 i Ligjit nr. 97/2016; Neni 3 paragrafi 1-dh, Neni 7, paragrafi 1, Neni 8, Neni 21 paragrafi 1 dhe 3, Neni 22 paragrafi 3 dhe 4, Neni 33 paragrafi 4, Neni 103, Neni 104 dhe Neni 279 paragrafi 1 i Ligjit nr. 25/2019; Neni 3 i KPP.

11 Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, *supra*, shënim 3, fq. 20

12 Sipas nenit 7, paragrafi 6 të ligjit nr. 25/2019, udhëzimet e përgjithshme për policinë gjyqësore që nxirren nga Prokurori i Përgjithshëm janë detyruese.

13 Neni 7 i Ligjit nr. 25/2019.

14 Neni 8 i Ligjit nr. 25/2019; Neni 279 i KPP.

në dijëni, për çfarë duhet të jetë në dijëni, pse duhet të jetë në dijëni, deri kur duhet të jetë në dijëni dhe si do të dorëzohet informacioni) dhe dokumentet kryesore që do të shkëmbehen.

Shqetësim i veçantë në kuadrin ligjor ekzistues është mungesa e rregullave për marrëdhënien mes prokurorëve si mbikëqyrës të OPGJ-ve dhe drejtuesve të policisë si eprorë të tyre. Në këtë drejtim, udhëzimi i përgjithshëm mund të përcaktojë (i) procedurat për raportimin e përfshirjes së OPGJ dhe kohën efektive kushtuar hetimeve dhe (ii) procedurat për vlerësimin e rezultateve dhe cilësisë së punës së OPGJ në hetime.<sup>15</sup>

Në fakt, drejtuesit e policisë të OPGJ kanë interes të ndjekin angazhimin në punë të punonjësve të tyre në hetimet penale, dhe udhëzimi i përgjithshëm duhet të bëjë të mundur që ata të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me angazhimin e OPGJ. Prandaj, udhëzimi i përgjithshëm duhet të përmbajë rregulla të qarta se si të kapërcehet mbivendosja e detyrave të OPGJ-ve gjatë hetimeve dhe rregulla për caktimin e detyrave të reja të OPGJ-ve që janë përfshirë tashmë në hetime. Qëllimi kryesor i këtyre rregullave do të ishte që të sigurohet që drejtuesit e policisë të OPGJ të jenë në dijëni të detyrave që u janë dhënë OPGJ-ve nga prokurori dhe të kohës që u kushtohet hetimeve, pa u informuar mbi detajet dhe përmbajtjen e çështjes për të cilën OPGJ është duke punuar. Që të krijohet një ide për performancën e policisë për qëllime vlerësimi dhe raportimi, këshillohet një takim i nivelit të lartë mes përfaqësuesve të policisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Procedurat e raportimit mbi përfshirjen dhe veprimtarinë e OPGJ-së në hetim duhet të standardizohen për të siguruar vijueshmëri.

Praktika e zakonshme e transferimit dhe e komandimit të OPGJ-ve është një tjetër çështje shqetësuese për shkak të ndikimit të saj të mundshëm negativ në hetimin për të cilin ata ishin caktuar fillimisht.<sup>16</sup>

Varësia e dyfishtë e oficerëve të policisë të shërbimeve kërkon që të marrin pjesë në detyrat hetimore të caktuara nga prokurorët dhe në detyrat administrative dhe të zbatimit të ligjit të caktuara nga drejtuesit e drejtorive përkatëse të policisë. Prandaj, udhëzimi i përgjithshëm duhet të përmbajë rregulla të qarta se si të kapërcehet mbivendosja e detyrave të OPGJ-ve gjatë hetimeve dhe rregulla për caktimin e detyrave të reja të OPGJ-ve që janë përfshirë tashmë në hetime.

15 Miratimi i këtyre udhëzimeve do të bëjë të mundur zbatimin më të mirë të paragrafit 2 të nenit 29 të ligjit nr. 25/2019.

16 Për diskutim të çështjeve në lidhje me transferimin dhe komandimin e OPGJ-ve në Shqipëri shihni Raportin e vitit 2019 të Prezencës së OSBE-së, cituar *supra*, shënim 3, faqe 20.



Një analizë krahasuese e sistemeve të tjera ligjore tregon se OPGJ-të të cilëve u ngarkohet një detyrë e caktuar nga prokurori nuk mund të lëvizin ose transferohen derisa ajo detyrë të përfundojë zyrtarisht dhe prokurori të ketë dhënë pëlqimin e tij/saj.<sup>17</sup>

Në rastin e nevojave organizative ose hetimore në çështje komplekse<sup>18</sup>, kuadri ligjor shqiptar lejon prokurorin e çështjes të kërkojë nga Prokurori i Përgjithshëm t'i drejtohet Komisionit të Policisë Gjyqësore me një kërkesë të arsyetuar që një oficer i policisë gjyqësore të komandohet në një hetim tjetër. Nëse transferimi ndikon në ecurinë e hetimeve paraprake, prokurori i çështjes nga e cila është hequr oficeri i policisë mund të kërkojë që transferimi të shtyhet për një kohë të përshtatshme.<sup>19</sup> Në këtë situatë, problemi kryesor ka të bëjë me vendosjen e një ekuilibri të drejtë midis nevojave për hetim të dy çështjeve dhe lejimit të prokurorit të çështjes, nga e cila është hequr oficeri i policisë, që të informohet në kohë për transferimin.

Një shembull i Udhëzimit të Përgjithshëm për marrëdhënien mes OPGJ-së dhe prokurorit gjatë hetimeve, me shkaqet ligjore dhe arsyetimin për nxjerrjen e tij, jepet në Aneksin I të këtij Manuali.

## 2. Aktivitete të përbashkëta<sup>20</sup>

Ekspertiza specifike dhe e ndryshme e OPGJ-ve të shërbimeve dhe OPGJ-ve të seksioneve, si dhe vlera e shtuar e përfshirjes së dy agjencive në hetimin penal njihet gjerësisht nga prokurorët shqiptarë.<sup>21</sup> Veçanërisht, përdorimi i grupeve të përbashkëta hetimore që përfshijnë lloje të ndryshme të ekspertizës është i këshillueshëm për hetimin e çështjeve komplekse, përfshirë veprat penale të lidhura me korrupsionin.<sup>22</sup> Edhe pse në një farë mase kjo ka të bëjë me menaxhimin e çështjes, ka disa aspekte menaxhimi që mund të kontribuojnë në zhvillimin dhe rritjen e kulturës së punës në grup, veçanërisht në lidhje me veprimtari që kërkojnë përpjekje të përbashkëta dhe koordinim mes prokurorisë dhe policisë.<sup>23</sup> Adresimi i këtyre çështjeve

17 Shihni për shembull Të Drejtën e Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fletore Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr.150/2010, neni 50

18 Neni 21 i Ligjit nr. 25/2019.

19 Neni 22 i Ligjit nr. 25/2019.

20 Kuadri ligjor përkatës: Neni 5, 11 dhe 15 i ligjit nr. 95/2016; Neni 42 paragrafi 1- ç i ligjit nr. 97/2016; Neni 12, 13, 14, dhe 15 i ligjit nr. 25/2019; Neni 202, 208, 221 dhe 223 i KPP.

21 Intervistat me prokurorët të zhvilluara për qëllim të këtij Manuali dhe intervistat paraprake të zhvilluara për përgatitjen e Raportit të vitit 2019 të Prezencës së OSBE-së.

22 Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 42

23 Këto situata përfshijnë për shembull ekzekutimin e urdhrave të kontrollit, sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve të lidhura me veprën penale, përgjimet, etj.

organizative në nivelin drejtues do të kontribuojë në një përdorim më të mirë të burimeve jo vetëm brenda prokurorisë, por edhe brenda policisë dhe do të mundësojë ndarjen e burimeve të përbashkëta, krijimin e marrëdhënieve më të ngushta dhe rritjen e besimit.

### *Rekomandime praktike*

Grupet e përbashkëta shërbejnë për një sërë qëllimesh, dhe posaçërisht ato (i) rrisin aftësinë e prokurorisë për të trajtuar me sukses çështje komplekse dhe tepër sensitive, (ii) nxisin kulturën e punës në grup, (iii) mundësojnë reagim të shpejtë dhe efektiv në situata të caktuara duke përdorur qëllimisht aftësitë e larmishme të OPGJ-ve të seksioneve dhe të shërbimeve, (iv) mundësojnë shkëmbimin e përvojës dhe njohurive, si dhe rritjen profesionale të anëtarëve të grupit<sup>24</sup>, dhe (v) lejojnë zhvillimin në mënyrë të përbashkët të strategjive më të mira për ndërmarrjen e veprimtarive hetimore.

Grupet duhet të përfshijnë OPGJ të shërbimeve dhe OPGJ të seksioneve dhe duhet të mbikëqyren dhe të drejtohen nga prokurori që drejton çështjen. OPGJ të seksioneve mund të zgjidhen nga Drejtuesi i prokurorisë dhe OPGJ të shërbimeve nga drejtuesi i policisë së tyre, në varësi të natyrës së veprimtarisë që duhet të kryhet. Në rastin e fundit, prokurori kompetent mund të propozojë OPGJ që duhet të përfshihen në grup.

Ekipet e përbashkëta mund të krijohen paraprakisht, si një lloj strukture organizative e prokurorisë që do të bëhet funksionale vetëm kur lind nevoja, ose mund të krijohen rast pas rasti. Në rastin e parë, Drejtuesi i prokurorisë, pas konsultimit me Drejtuesin e Policisë, mund të krijojë një listë të OPGJ-ve që do të jenë pjesë e grupeve të përbashkëta dhe mund të informojë prokurorët sipas rasti. Duke pasur paraprakisht këtë listë do të lehtësohet puna e gjyqësorit, veçanërisht në ato çështje - si për shembull kërkesa për kontroll ose sekuestru drejtuar Gjykatës - ku në urdhrin e prokurorit mund të propozohet dhe të jepet emri i OPGJ-së të ngarkuar me ekzekutimin e urdhrin të gjykatës.

Nëse konsiderohet e nevojshme, Drejtuesi i prokurorisë mund të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm mbi krijimin e grupeve të përbashkëta, ku të jepen rregulla se si do të krijohen grupet dhe se si një prokuror mund të mbështetet nga grupi.

<sup>24</sup> Për shembull, OPGJ të seksioneve do të përmirësonin ekspertizën e tyre në terren ndërsa OPGJ-të e shërbimeve njohuritë e tyre ligjore.

Në krijimin e grupit, duhet të merren parasysh disa aspekte. I pari është lloji i veprimtarisë hetimore që do të kryejë grupi. Në fakt, kompleksiteti dhe vështirësia e veprimeve hetimore mund të kërkojnë ekspertizë specifike dhe/ose prani të një OPGJ-je më të vjetër me përvojë të zgjeruar në terren.

Aspekti i dytë që duhet të merret në konsideratë është mundësia apo madje nevoja për të bërë një ndarje të qartë të roleve mes anëtarëve të grupit, veçanërisht kur bëhet fjalë për pozicione kyçe. Situata ideale kërkon një drejtues grupi, një OPGJ përgjegjës për komunikimin mes anëtarëve të grupit dhe prokurorit, një OPGJ të seksioneve përgjegjës për çdo problem ligjor që mund të lindë, dhe një ose më shumë OPGJ në gatishmëri, për të ndërhyrë, në rast nevoje.

Së treti, protokollet për kryerjen e veprimeve hetimore duhet të miratohen nga anëtarët e grupit përpara se të kryhet veprimi hetimor i planifikuar. Prokurori duhet të qartësojë gjithmonë protokollin dhe formatet e dokumenteve dhe procesverbaleve që OPGJ-ja planifikon të përdorë<sup>25</sup>, pasi vlefshmëria ligjore e disa veprimeve mund të varet nga saktësia e këtyre materialeve dhe përputhja e tyre me kuadrin aktual ligjor.

Së katërti, kur krijohet dhe vihet në lëvizje një grup, prokurori duhet (të kërkojë zyrtarisht) të informohet menjëherë nga drejtuesi i grupit për momentin e fillimit të veprimtarisë, gjendjen e veprimeve hetimore, nëse kanë ndodhur disa sfida të paparashikuara, momentin e përfundimit të veprimeve dhe rezultatin e tyre.

Grupet e përbashkëta mund të krijohen për veprimtari të tilla si urdhër kontrolli ose urdhra sekuestrimi, përgjime, etj.

Kur bëhet fjalë për përgjimet, krijimi i grupeve përgjegjëse për kryerjen e përgjimeve dhe transkriptimeve (apo zbardhjeve) mund të rezultojë shumë efektiv. Sipas KPP-së, përgjimet dhe transkriptimet bëhen nga oficerët e policisë gjyqësore, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e prokurorit të çështjes.<sup>26</sup> Kur një OPGJ caktohet për përgjime, natyra e punës duhet të vlerësohet me kujdes, duke përfshirë nivelin e fshehtësisë së nevojshme, aftësitë e OPGJ-së për të zbardhur bisedën e përgjuar dhe për të zgjedhur informacionin më të rëndësishëm, etj. Në varësi të çështjeve, oficeri që ka filluar hetimin mund të mos ketë aftësitë e nevojshme profesionale për të kryer përgjimet dhe grupi duhet të përfshijë OPGJ të aftë për të kryer detyrën në fjalë. Duke pasur parasysh natyrën e përgjimeve, grupi duhet të

25 Anëtarëve të ekipit duhet t'i jepen materiale mbështetëse siç janë formatet për regjistrimin e sendeve të sekuestruara, formatet për regjistrimin e sendeve të konfiskuara, etj.

26 Neni 223 i KPP

punojë me turne në mënyrë që të jetë në gjendje të ndjekë komunikimet e përgjuara në kohë reale.

Krijimi i grupeve të përbashkëta mund të jetë një mjet veçanërisht efektiv për Prokurorinë e Posaçme pasi Byroja Kombëtare e Hetimit kryen shërbime të policisë gjyqësore. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të nxjerrin urdhra të përbashkët që rregullojnë organizimin e brendshëm të grupeve.<sup>27</sup> Grupet e përbashkëta, për përmbushjen e detyrave specifike, duhet të përfshijnë profesionistë me formime të ndryshme, duke mundësuar kështu shkëmbimin e përvojës dhe forcimin e kapaciteteve brenda prokurorisë. Duke pasur parasysh strukturën e Byrosë Kombëtare të Hetimit, duhet të emërohet një person përgjegjës për grupet. Ky person mund të zhvillojë strategji për veprimtaritë e grupit, të propozojë përbërjen e grupit në varësi të situatës konkrete, të organizojë punën e grupit dhe të sigurojë materiale dhe formate të përshtatshme mbështetëse, dhe të shërbejë si pikë kryesore kontakti në rastet kur disa grupe do të punojnë në të njëjtën kohë, etj. Të gjitha sugjerimet e dhëna më parë në lidhje me krijimin e grupit, fushat e veprimtarisë dhe mënyra e punës zbatohen edhe për Prokurorinë e Posaçme.

---

### *Konsiderata shitesë*

---

Grupet e përbashkëta të propozuara në këtë kapitull janë të ndryshme nga grupet hetimore që Drejtuesi i Prokurorisë mund të krijojë për raste të veçanta sepse atyre u ngarkohen detyra shumë specifike dhe mund të veprojnë në raste të ndryshme. Pas përfundimit të detyrës së tyre, grupet e përbashkëta mund të përfshihen në të njëjtën çështje vetëm nëse lind nevoja. Arsyeja për këtë është se në çështje komplekse (për shembull, çështje në lidhje me lëndët narkotike), mund të duhet të ekzekutohen urdhrat e kontroleve të shumfishta. Sidoqoftë, rregullat e propozuara për krijimin e grupeve të përbashkëta dhe strukturën e tyre mund të jenë të dobishme për Drejtuesit e Prokurorisë që të krijojnë grupet hetimore edhe për çështje të veçanta.

---

27 Neni 32 i Ligjit nr. 95/2016.

### 3. Trajtimi i problemeve dhe ndarja e përvojës<sup>28</sup>

Në Shqipëri policisë dhe prokurorisë i mungojnë objektivat e përbashkëta në hetimet penale dhe kanë tendencë të paraqesin punën e tyre në mënyrë të pavarur.<sup>29</sup> Kjo shpesh rezulton në rrjedhje të informacionit në media përpara se prokurori të vihet në dijeni të disa ngjarjeve me lidhje të mundshme kriminale. Kjo lloj marrëdhënieje jo vetëm që dëmton hetimin, por gjithashtu ul besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, pasi dy homologët kryesorë shihen si konkurrentë më shumë se si bashkëpunëtorë.

#### *Rekomandime praktike*

Duke pasur parasysh kompleksitetin e hetimit dhe përfshirjen e agjencive të ndryshme, shkëmbimi i informacionit rreth temave dhe problemeve që lindin është me rëndësi të madhe. Kjo do të rrisë besimin te prokurorët dhe policia. Do të nxisë një kulturë respekti dhe bashkëpunimi reciprok dhe do të krijojë një qasje të përbashkët në trajtimin e sfidave që lidhen me hetimin e krimit dhe parandalimin e tij.

Këshillohet që Drejtuesit e Prokurorisë / Kryeprokurori i Posaçëm të zhvillojnë takime të rregullta (për shembull, mujore) me drejtuesit e policisë të territorit brenda kompetencës së tyre, për të diskutuar problemet më të fundit me të cilat përballet policia, për të miratuar strategji të përbashkëta se si të adresohen dhe të luftohen lloje të caktuara të krimit dhe për të shkëmbyer informacion për burimet ekzistuese dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të bëjë të mundur që të dy autoritetet të marrin parasysh sfidat me të cilat përballet homologu i tyre.

Gjatë organizimit dhe zhvillimit të takimeve me nivelin e lartë drejtues të policisë, është e rëndësishme të theksohet dhe të ruhet pavarësia e prokurorisë nga çdo ngjarje ndikimi ose presioni.

Gjithashtu, këshillohet të zhvillohen strategji të përbashkëta se si do të trajtohet abuzimi i detyrës nga policia. Kjo mund të shoqërohet me ndryshime në organizim brenda prokurorisë sa i përket caktimit të një prokurori si edhe OPGJ të seksioneve për t'u marrë me rastet kur raportohen abuzime nga policia.

28 Kuadri ligjor përkatës: Neni 42, paragrafi 1-b dhe 1-d i Ligjit nr. 97/2016.

29 Raport i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 24

Publiku duhet të informohet si duhet për këto takime si një formë e qasjes strategjike të prokurorisë për kryerjen e detyrave të saj, duke zgjedhur me kujdes formulimin e përdorur në informacionin e dhënë për publikun e gjerë në mënyrë që të kuptohet qasja bashkëpunuese e ndjekur nga agjencitë në lidhje me politikën penale ose veprimin e ndjekur.

Drejtuesit e prokurorive / Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të krijojnë botime elektronike, të disponueshme vetëm për përdorim të brendshëm, në të cilat mund të përshkruhen iniciativat dhe praktikat më të mira të oficerëve të policisë. Për të realizuar këtë veprimtari, drejtuesi i prokurorisë mund të ngarkojë secilin prokuror që ka pasur përvojë pozitive me OPGJ që të raportojë mbi praktikat dhe nismat më të mira që vijnë nga OPGJ-të dhe t'i përfshijë këto praktika në një dokument që mund të qarkullojë brenda për brenda prokurorisë. Më tej, ky dokument mund t'u komunikohet drejtuesve të policisë ku punon OPGJ, duke stimuluar në këtë mënyrë një qasje proaktive nga OPGJ dhe duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe ndarjen e praktikave më të mira. Kur raportohen praktikat më të mira, prokurorët duhet të marrin parasysh kontekstin e çështjes, duke dhënë sa më pak detaje të jetë e mundur dhe duke shpjeguar se si iniciativa ka ndihmuar dhe ka ndikuar te rezultati. Meqenëse fokusi kryesor i raportimit të praktikave më të mira është shkëmbimi i përvojave, përmirësimi i punës, gjenerimi i ideve dhe nxitja e proaktivitetit, duhet të shmangen detajet personale të oficerëve të përfshirë.

## **II. Përdorimi më i mirë i burimeve në Prokurori dhe në Prokurorinë e Posaçme**

Zakonisht prokuroritë nuk kanë burimet e mjaftueshme materiale dhe njerëzore për realizimin me sukses të punës së tyre.<sup>30</sup> Prandaj, përdorimi më i mirë i burimeve ekzistuese del si domosdoshmëri e vazhdueshme. Në Shqipëri, ka dy aspekte kryesore në lidhje me këto burime: i pari ka të bëjë me volumin e punës së panevojshme administrative që rrjedh nga cilësia e ulët e referimit fillestar të policisë dhe i dyti me mungesën e stafit mbështetës të prokurorëve që shpesh i detyron këta të fundit të bëjnë vetë punë administrative (fotokopje, sistemim të dosjeve, etj.).

---

30 Raport i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 25

## 1. Përmirësimi i cilësisë së referimit të policisë<sup>31</sup>

Sfida më e zakonshme me të cilën përballen prokurorët dhe që ndikon negativisht në menaxhimin e kohës së hetimit është cilësia e referimeve fillestare që vijnë nga policia. Shpesh kjo cilësi vlerësohet si e dobët, referimeve u mungojnë elementet e krimit dhe krijojnë nevojën për verifikime shtesë dhe punë të panevojshme administrative<sup>32</sup>, duke e bërë kështu të vështirë për prokurorët që të përmbushin afatin prej 15 ditësh për të vendosur mbi fillimin e procedimit.<sup>33</sup>

Ka raste që raportimet vijuese nga OPGJ janë gjithashtu të një cilësie të dobët, kështu që prokurorët shpesh përballen me nevojën për të ndërmarrë veprime shtesë dhe për të sqaruar aspekte të caktuara që mund të çojnë në zgjatjen e hetimit.<sup>34</sup>

### *Rekomandime praktike*

Një mënyrë më efektive për të trajtuar këtë sfidë dhe për të siguruar në të njëjtën kohë uniformitetin apo njehsimin e procedurave në territorin e të gjithë shtetit është nxjerrja e **Udhëzimit të Përgjithshëm për Referimin e Policisë**, i cili do të përmbajë dispozita administrative dhe procedurale. Një udhëzim i tillë mund të nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm për qëllim të orientimit të veprimtarisë së Policisë Gjyqësore dhe koordinimit të punës mes prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore. Prokurori i Përgjithshëm gjithashtu mund të miratojë një Udhëzim të Përgjithshëm për Policinë Gjyqësore dhe të përfshijë një kapitull mbi Referimin e Policisë.

Meqenëse ka të bëjë me çështjet e funksionimit të duhur dhe përdorimit efektiv të burimeve të prokurorisë, një Udhëzim i Përgjithshëm mbi Referimin e Policisë në parim mund të nxirret nga Drejtuesit e secilës prokurori. Sidoqoftë, arsyet e lëvizjes së shpeshtë të policisë në të gjithë vendin dhe vlerësimi i provave nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të tilla si Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë sugjerojnë një formë standardizimi dhe koherence të dispozitave me zbatim të përgjithshëm.

31 Kuadri ligjor përkatës: Neni 3, paragrafi 1; Neni 38, paragrafi 2-gh dhe 2-g; Neni 42, paragrafi 1-a, 1-b, 1-e dhe 1-gj; Neni 46, paragrafi 1, 2, 3-a dhe paragrafi 4 i Ligjit nr. 97/2016; Neni 281, paragrafi 1 dhe 4; Neni 293 i KPP.

32 Intervista me prokurorët, Raporti statistikor i OSBE-së, i vitit 2019, fq. 186 dhe Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 34.

33 Neni 291 paragrafi 1 i KPP

34 Intervista me prokurorët, Raporti statistikor i OSBE-së, i vitit 2019, fq. 180-185 dhe Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 34-35.



Objektivi kryesor i Udhëzimit të Përgjithshëm për Referimin e Policisë është adresimi i dy fazave kryesore të referimit: referimi fillestar i policisë dhe relacioni vijues ose përfundimtar i policisë. Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të synojë standardizimin e referimit të policisë, përcaktimin e rregullave procedurale dhe administrative që do të zbatohen dhe që do të mundësojnë zbatimin e duhur të standardeve të KPP-së. Ai gjithashtu do të krijojë një bazë për vlerësimin e referimit të policisë. Rezultati afatmesëm dhe afatgjatë do të jetë eliminimi i punës së panevojshme administrative nga prokurorët dhe rritja e cilësisë së referimit, duke bërë kështu të mundur që prokurorët të vendosin për fillimin e hetimit brenda afatit kohor prej 15 ditësh të përcaktuar në KPP, si edhe të marrin vendime përfundimtare në bazë të këtyre referimeve.

Përmbajtja e Udhëzimit të Përgjithshëm duhet të përfshijë standardin ligjor për referimin e përmendur në KPP, me një shtjellim më të hollësishëm të elementeve që duhet të përmbajë referimi. Duke qenë baza për vendimet e prokurorisë, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet dokumenteve mbështetëse që duhet të përfshijnë referimet. Për shembull, nëse referimi bazohet në intervista me dëshmitarë, duhet të përfshihen shënime të shkurtra të thënieve të dëshmitarit. Duhet të përfshihen gjithashtu rregullat për mënyrën e paraqitjes, sistemit dhe organizimit të provave mbështetëse, rregullat për gjuhën që do të përdoret në referim<sup>35</sup> dhe rregullat se si të veprohet kur informacioni i jepet prokurorit gojarisht.

Për të siguruar që informacioni për hetimet penale të kryera nga policia të mbahet sekret dhe i fshehtë, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të japë rregulla për shpërndarjen e informacionit me shkrim dhe kopje të dokumenteve të policisë të cilat më vonë i dërgohen Prokurorisë. Policia duhet të ketë një dosje që do të përmbajë të gjithë informacionin<sup>36</sup> në lidhje me një hetim penal. Nëse informacioni në lidhje me një çështje konkrete vjen nga departamente të ndryshme të policisë, secili prej departamenteve duhet ta dërgojë atë në formën e tij origjinale në departamentin përgjegjës për hetimin penal. Në vend që të bëhen dhe të mbahen kopje të informacionit të përcjellë, duhet të bëhet një shënim zyrtar që informacioni origjinal iu përcoll departamentit kompetent të policisë.

Gjatë hartimit të Udhëzimit të Përgjithshëm mbi referimin e policisë, duhet të merren parasysh niveli i njohurive ligjore të disa oficerëve të policisë

35 Shembullin praktik për atë që mund të përfshihet dhe si mund të duket Udhëzimi për referimin e gjeni në [https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/\\_internal/\\_documents/rwm.pdf](https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/_internal/_documents/rwm.pdf)

36 "Informacion" në këtë kontekst do të thotë vetë informacioni dhe gjithçka që gjeneron informacion siç janë provat, dokumentet policore etj.



gjyqësore të policisë së shtetit, mundësitë teknike që ata kanë, ngarkesa e tyre në punë dhe koha në dispozicion për hetime. Prandaj, këshillohet që Udhëzimi i Përgjithshëm për referimin të përfshijë modele tip referimesh për krimet më të zakonshme.

Në mungesë të rregullave specifike procedurale për referimin e standardizuar dhe sanksionet për referimin që nuk bëhet në përputhje me KPP-në, nxjerrja e Udhëzimit të Përgjithshëm për referimin e policisë do të luante rol kryesor në ndryshimin e praktikave aktuale të pakënaqshme dhe në mundësimin e përdorimit më të mirë të burimeve të prokurorisë. Mund të krijohet një procedurë administrative për kthimin e referimit që nuk i plotëson këto standarde dhe për të kërkuar sqarime dhe shtesa, së bashku me një procedurë për vendosjen e masave disiplinore kundër OPGJ-së i cili raportohet se nuk ka respektuar standardet e përmendura.

Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin e Policisë duhet t'i komunikohet zinxhirit të komandës së Policisë në mënyrë që të sigurohet zbatimi i duhur. Duhet të theksohet se Udhëzimi i Përgjithshëm, veçanërisht nëse nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm, mund të përfshihet më vonë në programet për edukimin dhe trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore.

Kuadri ligjor ekzistues bën të mundur që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim për Byronë Kombëtare të Hetimit për të rregulluar çështjet e ngritura në këtë kapitull.<sup>37</sup>

Një shembull i përmbajtjes që mund të ketë Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin e Policisë, me bazën ligjore dhe arsyetimin për miratimin e tij, jepet në Aneksin II të Manualit.

## **2. Prezantimi i praktikave profesionale<sup>38</sup>**

Programet e praktikës profesionale brenda prokurorisë janë bërë gjithnjë e më të zakonshme në shumë juridiksione në botë për shkak të ndikimit të tyre të larmishëm pozitiv në punën e prokurorive dhe më gjerë. Në fakt, praktikat profesionale ofrojnë mbështetje për punën e prokurorisë (për shembull, shoqërimi i prokurorit në gjykatë, mbajtja e shënimeve gjatë takimeve të caktuara, kryerja e hulumtimit mbi tema të zgjedhura) duke rritur në të njëjtën kohë ndërgjegjësimin mes studentëve dhe të rinjve për rëndësinë e punës së prokurorisë, ofrimin e mundësisë për praktikë ligjore

<sup>37</sup> Neni 15 paragrafi 2/ ë i Ligjit 95/2016.

<sup>38</sup> Kuadri ligjor përkatës: Neni 42, paragrafi 1-a, 1-b, 1-e dhe 1-gj; Neni 46, paragrafi 4 i Ligjit nr. 97/2016.

dhe rritjen e entuziazmit dhe interesit për zhvillimin e karrierës në fushën e prokurorisë. Megjithëse studentët e drejtësisë të interesuar për karrierë në fushën e praktikës juridike janë aplikantët më të zakonshëm për këtë lloj praktike, studentët me formim tjetër arsimor ose pritshtëri tjetër profesionale (për shembull, studentë në fushën e sociologjisë, kriminologjisë, gazetarisë investigative) mund të jenë të gatshëm të aplikojnë dhe mund të jenë vlerë e shtuar për stafin e prokurorisë. Në përgjithësi, praktikat profesionale do të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e opinionit publik për punën e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme pasi ato do të tregojnë përkushtimin dhe investimin e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme për edukimin dhe trajnimin e profesionistëve të rinj dhe promovimin e përfshirjes së komunitetit në punën e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme, duke nxitur kështu pranim më të mirë të punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme, më tepër hapje dhe transparencë.

---

### *Rekomandime praktike*

---

Legjislacioni në Shqipëri ofron mundësi që Drejtuesi i Prokurorisë të nxjerrë Udhëzime të Përgjithshme për çështjet e organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që ata drejtojnë<sup>39</sup>, përfshirë udhëzime për praktikantët. Gjithashtu, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim për procedurat administrative dhe rregulloret e nevojshme për funksionimin efektiv të Prokurorisë së Posaçme,<sup>40</sup> përfshirë udhëzime për praktikantët.

Udhëzimi i Përgjithshëm për praktikantët profesionale duhet të përmbajë kushtet arsimore që duhet të përmbushë praktikanti, kohëzgjatjen e praktikës profesionale, paraqitjen e detyrave të mundshme, detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional dhe konfidencialitetit të të gjithë informacionit të shqyrtuar gjatë praktikës profesionale.

Praktikantët nuk duhet të perceptohen si forcë pune e papaguar për kryerjen vetëm të detyrave administrative të cilat të punësuarit nuk kanë kohë ose dëshirë t'i kryejnë. Përkundrazi, ata duhet të mirëprehen si një pjesë e integruar, megjithëse e përkohshme e stafit, me nevojë për ngritje profesionale dhe edukative. Prandaj, praktikantëve duhet t'u bëhet i qartë përfitimi nga kryerja e praktikës profesionale. Veçanërisht, studentët e drejtësisë duhet të perceptohen dhe të trajtohen si aktorë dhe kolegë të

---

39 Neni 46 i Ligjit nr. 97/2016.

40 Neni 15 paragrafi 2/ ë i Ligjit 95/2016.

ardhshëm dhe gjatë praktikës profesionale duhet t'u ofrohet orientim cilësor dhe profesional.

Aneksi III i këtij Manuali, ofron një shembull të përmbajtjes që mund të ketë Udhëzimi i Përgjithshëm për praktikantët profesionalë, përfshirë shkaqet ligjore dhe arsyetimin për miratimin e tyre.

### **III. Përmirësimi i perceptimit të publikut për punën e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme**

Sondazhet e opinionit publik kanë treguar se besimi i publikut te gjyqësori është shumë i ulët. Për shembull, një sondazh i opinionit publik i kryer në vitin 2017 ka treguar se 73.4% e qytetarëve të intervistuar në Shqipëri besojnë se sistemi gjyqësor nuk mbron të drejtat e tyre, dhe përqindja është edhe më e madhe për ata që në fakt kanë pasur një përvojë me sistemin.<sup>41</sup> Edhe pse Shqipëria ka pësuar ndryshime të mëdha në legjislacion dhe në kuadrin organizativ që nga ajo kohë, besimi i kufizuar në sistemin e drejtësisë mbetet ende një çështje shqetësuese.

Përmirësimi i perceptimit të publikut për punën e prokurorëve ka tendencë të rrisë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, të sigurojë hetime më efektive dhe të krijojë një kulturë kujdesi për shqetësimet e qytetarëve. Duke rritur besimin te prokuroria, cilësia e punës do të rritet gjithashtu pasi njerëzit do të ndjehen më të sigurt dhe më të lirë për të kontaktuar prokurorinë, për të kallëzuar krimet, për të bashkëpunuar në hetime dhe për të mbështetur punën e prokurorisë. Kështu, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet strategjive të komunikimit, dokumentimit të veprimtarisë së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme dhe nevojës për të rritur proaktivitetin e saj.

#### **1. Strategjitë e komunikimit<sup>42</sup>**

Prokurorët në Shqipëri argumentojnë se shumë shpesh media merr informacion në lidhje me disa ngjarje me rëndësi kriminale edhe para se të informohet prokuroria. Në situata të tjera, veprimet hetimore ose identiteti i dëshmitarëve dhe i të dyshuarve dalin në media në shkelje të

41 Anketa për Aksesin në Drejtësi në Shqipëri, UNDP - [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/FINAL\\_DRAFT\\_SURVEY\\_EN.pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/FINAL_DRAFT_SURVEY_EN.pdf)

42 Kuadri ligjor përkatës: Neni 61 i Ligjit nr. 97/2016; Neni 7, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit nr. 96/2016 dhe Neni 103; Neni 104; Neni 279 paragrafi 1 dhe 3 i KPP.

konfidencialitetit dhe sekretit hetimor.<sup>43</sup>

Kjo tregon qartë se ka mungesë koordinimi midis prokurorisë dhe policisë kur bëhet fjalë për komunikimin me mediat gjatë hetimeve. Situata e përshkruar jo vetëm që rrezikon kryerjen e efektshme të procedimeve penale, por është gjithashtu burim presioni mbi punën e prokurorëve të cilët shpesh veprojnë nga frika e reagimit publik dhe jo sipas asaj që ata e konsiderojnë si vendimin e duhur në një çështje të caktuar.

Prandaj, prokuroritë kanë nevojë për strategji të mira komunikimi që adresojnë sfidat në komunikimin e përditshëm brenda dhe jashtë tyre, duke synuar rritjen e transparencës për punën e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme, rritjen e besimit të publikut të Prokuroria/Prokuroria e Posaçme dhe rritjen e ndërgjegjësimit për efektet e krimeve, për rëndësinë e luftës kundër krimit dhe për historitë e suksesit që kanë potencialin të ndikojnë në jetën e qytetarëve.

---

### *Rekomandime praktike*

---

Strategjia e komunikimit duhet të përqendrohet në masa që do të japin informacion në kohë, të saktë dhe në dispozicion të publikut dhe personave të interesuar, duke adresuar komunikimin e brendshëm (komunikimi brenda Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme), komunikimin e jashtëm (komunikimi midis Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme dhe institucioneve të tjera dhe komunikimi me media) dhe komunikimin në situata krize.

Edhe mjetet e komunikimit që do të përdoren nga prokuroritë për të dhënë orientime mbi situata specifike duhet të parashikohen në strategjinë e komunikimit. Për shembull, strategjia e komunikimit mund të përfshijë sugjerime për mjetet e komunikimit që janë të këshillueshme për lloje të veçanta të krimeve, të tilla si krimet elektorale, dhuna seksuale, krimet e urrejtjes ose pastrimi i parave, duke shpjeguar se cilat aspekte duhet të merren parasysh kur zhvillohen konferenca shtypi ose kur shkruhen deklaratat për shtyp dhe cilat detaje mund të përfshihen në informacion. Konferencat për shtyp duhet të përdoren sa më shpesh të jetë e mundur, veçanërisht në çështjet me interes të lartë publik, pasi janë instrument që u mundëson mediave të bëjnë drejtpërdrejt pyetje dhe të marrin përgjigje në mënyrë transparente dhe të paanshme.

---

<sup>43</sup> Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 22 dhe intervista me prokurorët

Një strategji efektive komunikimi duhet të adresojë standardet etike, profesionale dhe ligjore të menaxhimit të informacionit brenda prokurorisë, së bashku me aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe protokollat e informacionit në dobi të përfaqësuesve të mediave në lidhje me fshehtësinë e hetimit dhe efektet negative që ka shkelja e këtij sekreti në suksesin e hetimit.

Për rrjedhojë, strategjia e komunikimit duhet të përcaktojë qartë se kush do të japë informacion gjatë hetimeve, duke theksuar rolin drejtues të prokurorisë pas fillimit të hetimit dhe faktin që policia nuk mund të japë informacion për hetimin pa lejen e prokurorisë. Duhet të përcaktohet gjithashtu një bazë referimi për atë që do të konsiderohet informacion zyrtar për hetimin. Para fillimit zyrtar të hetimit ka një moment kur policia e shtetit vepron ose mund të veprojë e pavarur. Ky moment kërkon rregullim të veçantë të dakordësuar më parë ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Policisë për procedurat që duhen ndjekur, për të shmangur që hetimet formale të rrezikohen në të ardhmen.

Prokurorët që hetojnë çështjet e lidhura me korrupsionin tregojnë se njerëzit ngurrojnë të bashkëpunojnë me prokurorin dhe të denoncojnë rastet e korrupsionit, pasi korrupsioni shpesh perceptohet si një mënyrë e zakonshme e të bërit biznes dhe zyrtarët e korruptuar shpesh vlerësohen.<sup>44</sup> Kështu, programi i komunikimit me komunitetin për luftën kundër korrupsionit duhet të jetë pjesë e strategjisë së komunikimit. Shpjegimi i efekteve negative të korrupsionit dhe pasojat dhe dëmet me të cilat përballen njerëzit mund të rrisë ndërgjegjësimin e njerëzve për nevojën e përfshirjes më aktive nga ana e tyre në hetime. Shembull i mirë janë rastet e korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor (ku jeta e qytetarëve është në rrezik), në industrinë e ndërtimit (ku qëndrueshmëria e ndërtesave dhe qëndrueshmëria e tyre gjatë fatkeqësive natyrore mund të ndikojë në jetën e njerëzve), në industrinë ushqimore dhe çdo fushë tjetër që mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve. Kështu, rastet e korrupsionit duhet të komunikohen rregullisht me median dhe publikun e gjerë. Prokurorët nuk duhet të hezitojnë të nënvizojnë sfidat më të mëdha dhe pengesat me të cilat përballen prokurorët gjatë këtyre hetimeve, pasi publiku është shpesh i vetmi aleat që prokurorët kanë në luftën kundër korrupsionit. Nëse ushtrohet presion politik mbi prokurorët, ata nuk duhet të kenë frikë ta vënë në dukje këtë fakt gjatë komunikimit me publikun dhe duhet të sigurojnë publikun se ky presion është i kotë.

44 Intervista me prokurorët.

Strategjia e komunikimit duhet të përmbajë shpjegimin themelor të kushteve ligjore, kufizimeve ligjore dhe kërkesave ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë që medias t'i jepet informacion për hetimin. Megjithatë, strategjia e komunikimit dhe marrëdhëniet e Prokurorisë/ Prokurorisë së Posaçme me publikun nuk duhet të ndërhyjnë në politikën redaktoriale të mediave dhe duhet të ruajnë në mënyrë rigoroze një marrëdhënie profesionale.

Meqenëse kuadri ligjor shqiptar nuk i centralizon çështjet që kanë të bëjnë me strategjinë e komunikimit dhe çdo prokurori ka volum dhe lloj të ndryshëm ngarkese në punë, çdo drejtues prokurorie mund të hartojë një strategji të përshtatur që sidoqoftë duhet të jetë koherente dhe në përputhje me standardet e pranuar, të përcaktuara në nivelin e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në rastin e Prokurorisë së Posaçme, koordinatori i marrëdhënieve me median duhet të miratojë një strategji vjetore komunikimi që përcakton misionin dhe vizionin e Prokurorisë së Posaçme dhe kalendarin e aktiviteteve kryesore, duke përfshirë strategjinë e përgjithshme të prokurorisë dhe përcaktimin e kanaleve të komunikimit që do të përdoren.

Legjislacioni shqiptar përmban rregulla shumë të qarta dhe rigoroze në lidhje me publikimin e informacionit për hetimet. Kështu, sfida kryesore është përmirësimi i zbatimit praktik të këtyre rregullave. Kjo do të kërkojë personel të specializuar dhe të trajnuar në radhët e prokurorëve dhe personelit mbështetës së bashku me kontaktet më të shpeshta të prokurorisë me median në mënyrë që të jepet informacion i mjaftueshëm sipas kufizimeve që parashikon ligji. Për rritjen e transparencës, duhet të merren në konsideratë mjetet alternative të vizibilitetit të Prokurorisë/ Prokurorisë së Posaçme (përdorimi i rrjeteve sociale<sup>45</sup>, organizimi i programeve të kontaktit etj.).

Standardet dhe udhëzuesit ekzistues ndërkombëtarë për komunikimin e prokurorisë me median duhet të merren parasysh.<sup>46</sup>

---

45 Zgjedhja e rrjeteve sociale varet nga ajo që përdoret më së shumti në Shqipëri dhe në rrjetet sociale që do të kenë qasje më të mirë. Nëse përdoret FB, duhet t'i kushtohet vëmendje privatësisë dhe mundësisë për të bërë komente. Shembuj të përdorimit të rrjeteve sociale mund të gjenden në BE dhe autoritetet gjyqësore ndërkombëtare: <https://twitter.com/IntlCrimCourt> <https://twitter.com/Eurojust>

46 Manuali i komunikimit me mediat, i CEPEJ(2018)15 - <https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe>

## 2. Dokumentimi i punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme

Prezantimi i suksesshëm i punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme është i lidhur ngushtë me raporte cilësore dhe dokumentim të qëndrueshëm të veprimtarisë në çështje lëndore dhe procedurale, veçanërisht për ato që janë theksuar si më të rëndësishme dhe për të cilat Shqipëria ka detyrime ndërkombëtare për të raportuar. Dokumentimi është një nga mjetet që shërben për të vlerësuar efektivitetin e punës së prokurorëve. Një nga rekomandimet kryesore që i është dhënë Shqipërisë në raportin e progresit të BE-së, të vitit 2019, është ecuria e mëtëjshme drejt krijimit të historikut të rezultateve të qëndrueshme të sekuestrimit dhe konfiskimit/ rikuperimit të pasurive kriminale që rrjedhin nga veprat penale të lidhura me korrupsionin. Krijimi i historikut të qëndrueshëm të rezultateve të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare në çështjet e korrupsionit mbetet objektiv afatgjatë që duhet konsoliduar më tej.<sup>47</sup> Sidoqoftë, nevoja për një dokumentim të duhur të veprimtarisë është po aq e rëndësishme kur bëhet fjalë për ngarkesën në punë dhe rezultatet e punës së prokurorëve në të gjitha llojet e çështjeve penale.

### *Rekomandime praktike*

Në mungesë të standardeve ndërkombëtare për vlerësimin e efektivitetit të prokurorëve, është e mundur që të propozohen kritere bazuar në praktikën e mirë të zhvilluar në vende të ndryshme, si më poshtë:

- ⊙ Raporti i ndjekjes penale: numri i personave të ndjekur penalisht, përfshirë vendimet për heqjen dorë nga ndjekja penale, krahasuar me numrin e përgjithshëm të aktakuzave;
- ⊙ Shpejtësia e zhvillimit të çështjes: sa shpejt merret një vendim për të filluar apo jo ndjekjen penale;
- ⊙ Numri i çështjeve të dërguara në gjykatë krahasuar me numrin e çështjeve që janë referuar për ndjekje penale nga organet hetimore;
- ⊙ Uniformiteti i zbatimit të ligjit për llojet më të zakonshme të vendimeve të prokurorisë.<sup>48</sup>

47 SWD(2019) 215 final, Dokument pune i stafit të Komisionit, Shqipëri 2019. Raport shoqërues i dokumentit “Komunikatë e Komisionit për Parlamentin Europian, Këshillin, Komitetin Europian Social Ekonomik dhe Komitetin e Rajoneve”, 2019 Komunikatë për Politikën e Zgjerimit të BE-së, {COM(2019) 260 final}, Bruksel, 29.5.2019.

48 Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve, Seri e Manualit të Drejtësisë Penale, Organizata e



Kuadri ligjor shqiptar përcakton qëllimin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve dhe lidhet jo vetëm me përmirësimin e aftësive etike dhe profesionale të prokurorëve, por edhe me krijimin e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e punës së tyre dhe për zhvillimin e karrierës së tyre në bazë të meritokracisë. Kjo bëhet - mes të tjerash - duke identifikuar nevojat për trajnim dhe prokurorët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale të rëndësishme për sistemin e drejtësisë dhe duke kontribuar në përmirësimin e strukturës organizative të Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme dhe kushteve të punës së prokurorëve.<sup>49</sup> Për më tepër, kuadri ligjor në Shqipëri parashikon që vetë drejtuesit e prokurorisë janë subjekt i vlerësimit<sup>50</sup>, duke i bërë thirrje në këtë mënyrë nivelit drejtues të prokurorisë që të tregojë aftësi drejtuese dhe organizative<sup>51</sup> duke marrë masat e duhura për të krijuar bazat e referimit për dokumentimin.

Bazat e referimit sigurisht që do të synojnë të japin statistika të mjaftueshme për sa i përket vëllimit të punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme, duke përfshirë numrin e çështjeve të reja, numrin e çështjeve të përgjithshme, numrin e çështjeve të mbyllura si dhe arsyet e mbylljes, numrin e padive të ngritura, numrin e veprimeve të ndërmarra nga prokurorët (p.sh.: numri i seancave gjyqësore të ndjekura), numrin e vendimeve gjyqësore, numrin e sekuestrove preventive të kërkuara dhe numrin e urdhrave për sekuestro preventive të dhëna nga gjykata.

Sidoqoftë, këto pika referimi duhet të japin informacion në lidhje me llojet e krimeve, numrin e të pandehurve (duke treguar nëse i pandehuri është i mitur, autor për herë të parë apo përsëritës) dhe kohëzgjatjen mesatare të procedurave, masat e ndërmarra për të rritur efikasitetin e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme dhe për të siguruar respektimin e afateve të përcaktuara me ligj. Kryesisht, dokumentimi duhet të nxjerrë në pah rezultatin e një çështjeje gjatë të gjitha proceseve - përfshirë hetimin policor dhe rezultatin vijues në gjykatë - dhe jo thjesht proceset për të cilat prokurori është përgjegjës.

Prokuroria në Shqipëri ka një sistem të menaxhimit të çështjeve, por nxjerrja e të dhënave statistikore ka rezultuar e vështirë.<sup>52</sup> Derisa ky problem

---

Kombeve të Bashkuara, Nju Jork, 2014. Gjithashtu, kapitulli për vlerësimin e magjistratëve në ligjin nr. 96/2016 parashikon kriteret e përmendura në tekst.

49 Neni 68 i Ligjit nr. 96/2016.

50 Neni 79 i Ligjit nr. 96/2016.

51 Neni 80 i Ligjit nr. 96/2016 përkufizon aftësitë drejtuese dhe organizative të drejtuesve të prokurorisë që janë subjekte të vlerësimit.

52 Intervistë me një prokuror të Prokurorisë së Përgjithshme.



të zgjidhet në mënyrë sistematike, duhet që çdo prokuror të dokumentojë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe të ketë detyrimin t’ia paraqesë këtë dokumentim çdo muaj Drejtuesit të Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme.

Shembulli i aktit të dokumentimit jepet në Aneksin IV të Manualit.<sup>53</sup>

### 3. Rritja e proaktivitetit të punës së Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme

Proaktiviteti i pamjaftueshëm i prokurorëve për fillimin e hetimeve penale është një tipar i përsëritur i sistemit të prokurorisë shqiptare.<sup>54</sup> Në fakt, shumica e çështjeve me të cilat merren prokuroritë në Shqipëri referohen nga policia. Numri i çështjeve të iniciuara *ex officio* është shumë i ulët<sup>55</sup>, edhe pse kuadri ligjor parashikon mundësinë që prokurorët të marrin njoftim për vepra penale me iniciativën e tyre.<sup>56</sup>

#### *Rekomandime praktike*

Proaktiviteti i prokurorëve varet kryesisht nga njohja me informacionin e hapur që mund të tregojë ekzistencën e një vepre penale. Në shumicën e rasteve, ky informacion vjen nga raportimet e mediave të cilat duhet të kontrollohen me saktësi për këtë qëllim. Stafi i përkushtuar me njohuri të mjaftueshme ligjore (për shembull, oficerët e policisë gjyqësore të sektorit, këshilltarët ligjorë nëse ka) mund të ngarkohet me detyrën që të shqyrtojnë rregullisht informacionin në median e përditshme dhe t’ia raportojnë drejtuesit çdo lajm që tregon veprimtari të dyshimtë.

Në të njëjtën linjë, prezantimi i përmbledhjeve periodike me gazetarë investigativë për ndjekjen e tendencave të reja dhe seanca dëgjimore për shqetësimet ekzistuese janë një tjetër mjet proaktiv në dispozicion të prokurorisë. Kur zhvillon seanca informimi me gazetarët, është e rëndësishme të keni një rend dite, në mënyrë që pjesëmarrësit të dinë qëllimin e takimit dhe të kenë pritshmëritë e duhura. Shpresat e rreme për marrjen e informacionit të brendshëm për çështje që ata i konsiderojnë të rëndësishme duhet të shmangen.

53 Relacioni shpjegues i Aneksit jep detaje për mundësinë e nxjerrjes së statistikave për llojin specifik të çështjeve.

54 Raporti i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 28

55 Prokurorët që u intervistuan për qëllim të këtij manuali qartësuan që vetëm pak çështje janë filluar *ex officio* dhe që shumica e tyre janë referuar nga policia.

56 Neni 280 i KPP.

Për më tepër, stafit të përkushtuar mund t'u caktohet detyra e marrjes dhe vlerësimit të ankesave për parregullsi<sup>57</sup> që mund të mos përmbushin standardin e KPP-së për kallëzim, por që gjithsesi përmbajnë informacion të vlefshëm. Dhënia e kësaj mundësie do të krijojë një qasje më të mirë të personave të thjeshtë në prokurori dhe në sistemin e drejtësisë, një qasje të drejtpërdrejtë në drejtësi për informatorët dhe krijimin e një qasjeje më të hapur dhe transparente për marrjen e shqetësimeve të qytetarëve për funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore.

---

57 Parregullsi në këtë drejtim do të thotë të gjitha veprimtaritë e dyshuara për mashtrim, korrupsion, mosrespektim ose zbatim të gabuar të legjislacionit dhe rregulloreve të tjera si edhe marrëveshjeve ndërkombëtare që lindin nga veprimi ose mosveprimi i përdoruesve të fondeve publike dhe që kanë ose mund të kenë ndikim negativ në buxhet, fondet e BE-së dhe fonde nga burime të tjera të brendshme dhe të jashtme.

# PJESA II

## ROLI DREJTUES I PROKURORËVE

Aftësitë drejtuese të prokurorëve hyjnë në lojë në dy nivele të ndryshme organizative, domethënë në menaxhimin e ngarkesës së përgjithshme të punës së prokurorit dhe në menaxhimin e punës në çështje individuale.

### **I. Menaxhimi i ngarkesës së punës**

Ngarkesa e punës së prokurorëve në Shqipëri është e lartë, pasi ata detyrohen të punojnë gjatë fundjavave dhe në kohën e tyre të lirë në mënyrë që të përmbushin afatet ligjore dhe kërkesat procedurale. Për më tepër, mungesa e rregullave ose udhëzimeve për organizimin e punës së prokurorëve sjell rrezik për zbatimin e paqëndrueshëm të ligjit dhe në të njëjtën kohë pengon vlerësimin e duhur të punës së prokurorit, gjë kjo që nga ana tjetër ndikon në motivimin dhe përkushtimin e tyre. Prandaj, prokurorët dhe drejtuesit e tyre duhet të hartojnë strategji dhe plane pune për një përdorim më të mirë të burimeve në dispozicion kundrejt ngarkesës ekzistuese dhe në rritje të punës.

### **1. Përmirësimi i dokumentimit**

Rëndësia e dokumentimit të veprimtarisë së prokurorëve shkon përtej arsyeve të përmendura në kapitullin e mëparshëm dhe ndikon drejtpërdrejt në menaxhimin e duhur të ngarkesës së punës në prokurori.

---

#### *Rekomandime praktike*

Siç është përmendur më lart, për shkak të zhvillimit aktual të pamjaftueshëm

të sistemit të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë shqiptare, është e rëndësishme që prokurorët të dokumentojnë në mënyrë të efektshme dhe të përditësuar çështjet që u janë caktuar.

Dokumentimi i veprimtarisë duhet të tregojë qartë të gjithë procesin e zhvillimit të çështjes, të gjitha vendimet e marra, datën e vendimeve, rezultatin, kohëzgjatjen e procedurave në lidhje me faza të ndryshme dhe masat e sigurimit të marra si edhe informacionin organizativ, si për shembull ku ndodhen dosjet e çështjeve ose informacion tjetër që prokurori e konsideron të rëndësishëm.

Prokurorët dhe stafi i prokurorëve duhet të bëhen të zotë dhe të përdorin në mënyrë efektive IT dhe mjetet teknike në dispozicion. Të gjithë prokurorët kanë adresa zyrtare të postës elektronike dhe përdorin menaxherë të automatizuar të informacionit personal që përfshijnë funksione të tilla si klienti i postës elektronike, kalendari, menaxhimi i detyrave, menaxhimi i kontakteve dhe mbajtja e shënimeve. Përdorimi i kalendarëve dhe agjendave mund të jetë shumë efektiv. Përveç seancave gjyqësore dhe afateve për veprimtari të caktuara, pjesë e dokumentimit mund të jetë plani ditor i takimeve me OPGJ, me drejtuesin e Prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme dhe takimeve të tjera të rëndësishme. Planin ditor do të tregojë qartë kohën e caktuar për veprimtari administrative dhe të tjera që janë jashtë fushës së hetimeve dhe do të bëjë të mundur që të kuptohen më mirë veprimtaritë që kërkojnë më shumë kohë.

Ndërsa disa prokurorë mund të ndjehen më të sigurt për të plotësuar detyrat e dokumentimit në kopje fizike, duhet theksuar se përparësia e formateve elektronike qëndron në faktin që procesi bëhet më i shpejtë dhe më i saktë, ndërsa të dhënat dhe statistikat mund të nxirren dhe të përpunohen më lehtë.

Në fillim prokurorët mund të hezitojnë të plotësojnë aktin e dokumentimit të veprimtarisë, agjendën ose kalendarin për shkak të orarit të tyre të mbingarkuar, por këto veprimtari - nëse kryhen çdo ditë - do të marrin shumë pak nga koha e prokurorit dhe do të paraqesin një pasqyrë të qartë të punës së kryer dhe kohës së shpenzuar në veprimtari të ndryshme. Prandaj, dokumentimi mund të përdoret për të mbrojtur nevojën për të përmirësuar kushtet e punës së prokurorëve dhe stafit të tyre.

Një shembull i dokumentimit të veprimtarisë jepet në Aneksin IV të Manualit.

## 2. Organizimi i punës

Çdo prokuror duhet të caktojë një mënyrë për të organizuar punën e tij të përshtatur me nevojat dhe përparësitë e identifikuara. Në këtë kapitull jepen disa sugjerime se si mund të organizohet puna.

### *Rekomandime praktike*

Rekomandimet praktike për një organizim më të mirë të punës ndahen në tri kategori kryesore: (i) prezantimi i procesverbaleve për aktivitetet e ndërmarra, (ii) organizimi i punës në varësi të llojit të çështjeve dhe (iii) vendosja e përparësive në punë.

### 2.1. Prezantimi i procesverbaleve për aktivitetet e ndërmarra

Siç është përmendur tashmë në kapitullin e mëparshëm, një sistem i duhur dokumentimi i ngarkesës me punë të prokurorëve përfaqëson një hap të parë të rëndësishëm drejt organizimit efikas dhe efektiv të punës në prokurori. Këtu është e rëndësishme të theksohet se procesverbalet duhet të mundësojnë dallimin e qartë të llojeve të çështjeve (mund të përdoren ngjyrat), afatin kohor në të cilën janë ndërmarrë disa aktivitete dhe një pasqyrë të qartë të veprimtarive të prokurorit.

### 2.2. Organizimi i punës në varësi të llojit të çështjeve

Organizimi i punës së prokurorit mund të bazohet në kriterin e llojit të çështjes. Prokurorët mund të mbajnë fizikisht lloje të ndryshme të çështjeve në raftet e ndryshme dhe t'i shënojnë ato me ngjyra të ndryshme (ngjithëse me ngjyra, lapsa me ngjyra, kapakë me ngjyra) në mënyrë që ato të jenë menjëherë të dukshme dhe të dallueshme. Një sistem i ngjashëm mund të përdoret për të shënuar të gjitha ose një pjesë të rafteve ku ruhen dosjet.

Së pari, puna mund të organizohet duke ndarë regjistrimet penale nga procedimet penale, sepse veprimtaria për secilën prej këtyre lloj çështjesh është e ndryshme. Pastaj, rastet me autor të njohur mund të ndahen nga ato me autor të panjohur.

Gjithashtu, kompleksiteti i dosjeve dhe gama e veprimeve që duhet të kryhen lejon organizimin e çështjeve në tri kategori kryesore, përkatësisht

kundërvajtjet penale, krimet dhe çështjet komplekse.

Gjithashtu, çështjet mund të organizohen sipas OPGJ-së kompetent (nga seksioni ose nga shërbimi) për menaxhimin e dosjes ose kryerjen e veprimeve të caktuara.

Në përgjithësi, tipologjitë e sugjeruara të organizimit të çështjeve mundësojnë mbikëqyrje më të mirë të ngarkesës me punë të prokurorëve, duke pasur parasysh fazën e procedimit, kompleksitetin e çështjes dhe atë që ndihmon prokurorin në hetim.

### **2.2.1. Kallëzimi penal dhe procedimi penal**

Pas marrjes së një kallëzimi penal, prokurori ka 15 ditë kohë për të vendosur nëse do të fillojë procedimin. Nëse nevojiten verifikime dhe informacione shtesë, brenda pak ditësh pas marrjes së kallëzimit, prokurori duhet të caktojë një takim me OPGJ që ka paraqitur kallëzimin dhe të kërkojë dokumente shtesë në mbështetje të kallëzimit ose sqarime shtesë.

Kuadri ligjor ekzistues nuk e kufizon mundësinë që prokurori të kërkojë sqarime përpara se të vendosë fillimin e një procedimi. Nga njëra anë, këto sqarime nuk përbëjnë kërkesë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, por më shumë përqendrohen në informacionin dhe provat që policia ka mbledhur para depozitimit të referimit dhe që mund të mos jenë ndarë me prokurorin. Nga ana tjetër, për të regjistruar një procedim, prokurori duhet të sigurohet që të mos ketë pengesa ligjore për fillimin e një procedimi.<sup>58</sup>

Në rastet kur sqarimet shtesë nuk sjellin një pasqyrë të re dhe në rastet kur prokurori nuk mund të vendosë të regjistrojë apo jo një procedim, duhet të merret vendimi për të mos filluar procedimin.<sup>59</sup> Meqenëse KPP parashikon<sup>60</sup> që vendimi për të mos filluar procedimin, i cili merret për shkak të mungesës së ankimit, nuk do të pengojë kryerjen e hetimeve për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person. Në qoftë se më pas bëhet ankim, nuk ekziston rreziku për pandëshkueshmëri dhe policia mund të vazhdojë punën e saj

58 Neni 290 i KPP.

59 Shihni për shembull *Guida e Zbatimit dhe Kuadri i Vlerësimit për nenin 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit* i cili thekson se “prokurori [k]ur fillon procedim penal duhet të vijojë vetëm nëse çështja është e mirë argumentuar, e bazuar në prova që në mënyrë të arsyeshme besohet se janë të besueshme dhe të pranueshme, dhe nuk duhet të vijojë me procedimin në mungesë të këtyre provave.”: [https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2014/Implementation\\_Guide\\_and\\_Evaluative\\_Framework\\_for\\_Article\\_11\\_-\\_English.pdf](https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2014/Implementation_Guide_and_Evaluative_Framework_for_Article_11_-_English.pdf)

60 Neni 292 i KPP.

dhe mund të bëjë përsëri referimin e veprës penale nëse shfaqen elemente të reja që justifikojnë fillimin e procedimit. Kjo është në përputhje me parimin e përdorimit efektiv të burimeve, pasi prokurorët nuk do të përfshihen në çështje kur nuk është nevoja.

### **2.2.2. Organizimi i punës në çështje me autor të panjohur**

Në çështjet me autor të panjohur, prokurorët duhet të kërkojnë që të kryhen veprime hetimore për identifikimin e tij/saj. Në varësi të llojit të çështjes, veprimet hetimore që mund të kontribuojnë në identifikimin e autorit të krimit do të përqendrohen kryesisht në marrjen në pyetje të dëshmitarëve, shqyrtimin e provave materiale, kërkimin e regjistrimeve të mbikëqyrjes me video, ekzaminimet mjeko-ligjore, kontrollin e bazave ekzistuese të të dhënave dhe krahasimin me provat e çështjes, kërkimin e burimeve në internet dhe të dhënave elektronike, analiza financiare, etj.

Nëse me gjithë përpjekjet për identifikimin e autorit të krimit, autori mbetet i panjohur, prokurori duhet të pezullojë hetimin.<sup>61</sup>

### **2.2.3. Organizimi i punës në çështjet me autor të njohur**

Objektivi kryesor në hetimet me autor të njohur është të sigurohen prova që do të bëjnë të mundur që prokurori të përcaktojë se çfarë ka ndodhur, nëse veprimet e kryera përbëjnë vepër penale, cili është roli i saktë i personit të raportuar si autor, nëse ai person mund të ketë përgjegjësi penale, si dhe fakte të tjera që janë të rëndësishme për ndjekjen penale.

### **2.2.4. Organizimi i punës për kundërvajtjet penale**

Kundërvajtjet penale përcaktohen qartë në Kodin Penal të Shqipërisë.<sup>62</sup>

Në përgjithësi, natyra e këtyre çështjeve dhe kompleksiteti i tyre (relativ) më i pakët lejon që prokurori të ketë kryesisht rol koordinues dhe nuk kërkon që veprimet hetimore të ndërmerren nga vetë prokurori. Prandaj, organizimi i punës në këto çështje duhet të përqendrohet në planifikimin e duhur të hetimit.

61 Neni 326 i KPP.

62 Nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, 123, 125, 126, 127, 128, 130, 133, 149/a, 149/b, 167, 169, 170, 170/a të KP.

Në veçanti, prokurori duhet të përcaktojë objektivat dhe qëllimin e hetimit, të identifikojë një sërë burimesh informacioni në mënyrë që të përcaktojë orientimet e hetimit dhe të zhvillojë planin e ndjekjes së hetimit. Urdhri i prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore në çështjet e kundërvajtjeve penale duhet të jetë shumë i saktë dhe konciz me objektiva të përcaktuara qartë për të mbledhur prova që vërtetojnë veprimtarinë kriminale të referuar.

Nëse konsiderohet e nevojshme, prokurorët mund të organizojnë punën për ato çështje duke i shpërndarë mes OPGJ të seksioneve dhe OPGJ të shërbimeve. Kjo qasje organizative mund të kontribuojë për të kuptuar më mirë efektivitetin, shpejtësinë dhe efikasitetin e sektorëve të ndryshëm të policisë në mënyrë vendimet për OPGJ-në më të përshtatshëm në lidhje me hetimin e kundërvajtjeve penale në të ardhmen, të jenë më të bazuara në fakte.

Avantazhi kryesor procedural në çështjet e kundërvajtjeve penale është mundësia për të nxjerrë urdhra penalë. Ndërkohë që nxjerrja e këtyre urdhrave bëhet brenda një afati ligjor të caktuar,<sup>63</sup> nëse nuk veprohet brenda këtij afati dhe nëse gjithsesi prokurori ka mbledhur prova të mjaftueshme, duhet të konsiderohet më së shumti mundësia për arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit.<sup>64</sup>

Një shembull i planifikimit të hetimit të kundërvajtjeve penale jepet në Aneksin V të këtij Manuali.

### **2.2.5. Organizimi i punës për krimet**

Sistemi i prokurorisë shqiptare karakterizohet nga një specializim progresiv si për sa u përket strukturave organizative (p.sh. e ashtuquajtura SPAK) ashtu edhe për sa i përket ndarjes së përgjithshme të çështjeve (p.sh., krijimi së fundmi i strukturës të posaçme kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimit financiar dhe konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurive kriminale brenda shtatë prokurorive kryesore në të gjithë vendin). Kjo qasje do të thotë fokusim më i madh dhe performancë më e mirë e prokurorëve.

Në parim, organizimi i punës për krimet, ashtu si për kundërvajtjet penale, mund të bëhet bazuar në kriterin e strukturës së OPGJ (seksioni ose shërbimi) e cila kryen veprimet hetimore. Sidoqoftë, për shkak të natyrës ose kompleksitetit të tyre, lloje të caktuara krimesh kërkojnë përfshirje të

63 Neni 406/a i KPP.

64 Neni 406/d i KPP.



drejtpërdrejtë të prokurorit në kryerjen e veprimeve hetimore.

Planifikimi i hapave kryesorë që prokurori pret të kryhen gjatë hetimit është çelësi i suksesit. Vendosja e përparësive për këto hapa dhe rritja e afateve të detyrueshme për përmbylljen e tyre do të rrisin mbikëqyrjen e hetimeve nga ana e prokurorëve dhe në këtë mënyrë ata do të reagojnë menjëherë me masa korigjuese në rast të vonesave ose performancës së dobët. Për shembull, një fazë e hetimit mund të përqendrohet në të provuarin e elementeve të caktuara të krimit dhe prokurori mund të caktojë afate të detyrueshme vetëm për këtë veprimtari specifike. Nëse brenda afatit të dhënë nuk ka rezultate thelbësore, prokurori mund të sugjerojë veprime të ndryshme hetimore dhe të diskutojë propozime nga OPGJ për të tejkaluar pengesat ekzistuese. Prokurori duhet të sigurohet që ai/ajo të informohet si duhet për të gjitha hapat e hetimit gjatë të gjitha fazave të hetimit dhe - nëse është e nevojshme - duhet të kërkojë në mënyrë aktive informacion nga OPGJ. Një mjet i dobishëm për këtë lloj monitorimi është krijimi i një gjurmuesi veprimtarie për të ndjekur veprimet që i janë ngarkuar OPGJ-së dhe respektimin e afateve të përcaktuara për veprime konkrete.

Një shembull i modelit për gjurmuesin e veprimtarive të OPGJ-së për krime<sup>65</sup> jepet në Aneksin IV të këtij Manuali.

## **2.2.6. Organizimi i punës në çështje komplekse**

Çështjet komplekse sjellin shumë sfida organizative për prokurorët, duke filluar me planifikimin e veprimeve hetimore pasi merren në konsideratë burimet në dispozicion deri në menaxhimin e fluksit të informacionit dhe parandalimin e rrjedhjes së informacionit, zhvillimin e një sistemi për qëllime arkivimi dhe regjistrimi në mënyrë që të lehtësohet përzgjedhja e provave për procedime të mëtejshme, krijimi i protokolleve të komunikimit, etj.

Meqenëse nuk ekziston asnjë pengesë ligjore në këtë drejtim, në çështje komplekse policia gjyqësore dhe prokurorët duhet të marrin në konsideratë diskutimin e përmbylljes së referimit fillestar të veprës penale para se referimi të paraqitet në prokurori. Kjo mund të kontribuojë në hartimin e një referimi fillestar të veprës penale më të qartë dhe më gjithëpërfshirës dhe mund të shkurtojë kohën e hetimit meqenëse përzgjedhja e provave dhe fakteve përkatëse do të bëhet paraprakisht. E rëndësishme është që përmes kësaj praktike të shmanget gjithashtu edhe paraqitja e referimeve të veprave penale të cilat janë të pajustificuara.

<sup>65</sup> Modeli mund të përdoret për të gjitha llojet e veprave penale.

Pas marrjes së një çështjeje komplekse, prokurorët duhet të caktojnë shtrirjen dhe llojin e veprimeve hetimore që duhet të ndërmerren, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në pyetjen se cila agjenci do të kryejë veprimet hetimore. Në shumë raste **krijimi i një grupi** me OPGJ-të përgjegjës për hetimet, është mënyra më efektive. Në varësi të kompleksitetit të çështjes, grupi mund të jetë një grup i përbashkët i përbërë nga OPGJ të shërbimeve dhe OPGJ të seksioneve,<sup>66</sup> ose mund të kërkojë mbështetje nga agjenci të tjera. Prokurori duhet t'i japë detyra anëtarëve të grupit dhe të identifikojë drejtuesit e grupit mes OPGJ-ve. Prokurori duhet të sigurohet që caktimi i detyrave midis anëtarëve të grupit të jetë efikas dhe në çdo kohë të hetimit mund të ndryshojë detyrat e dhëna ose të japë detyra të reja.

Në çështje komplekse, prokurori mund të ketë nevojë **të marrë pjesë drejtpërdrejt në veprime specifike hetimore**, të tilla si marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe e të dyshuarve dhe pjesëmarrja në hetim në vendin e ngjarjes. Gjatë këtyre veprimeve, prokurori do të jetë në gjendje të mbikëqyrë punën e OPGJ-së, të japë ide ose udhëzime të mëtijshme mbi veprimet në vazhdim dhe të propozojë veprime shtesë që mund t'i konsiderojë të nevojshme dhe / ose urgjente. Në lidhje me intervistat, është thelbësore që prokurori të vlerësojë drejtpërdrejt besueshmërinë e dëshmitarëve dhe të veprojë menjëherë, nëse ka arsye, për mbrojtjen e dëshmitarëve ose për përdorimin e teknikave speciale të marrjes në pyetje të dëshmitarëve.<sup>67</sup> Gjithashtu, vendosja e komunikimit të drejtpërdrejtë me të pandehurin gjatë hetimit është e rëndësishme për rritjen e mundësive të bashkëpunimit në hetim dhe për krijimin e kushteve më të mira për arritjen e një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë, sipas rastit.<sup>68</sup>

Ndërsa numri i personave të përfshirë në hetim varet nga kompleksiteti i çështjes së caktuar dhe aftësitë teknike të kërkuara për përfundimin e saj me sukses, në çështje komplekse është e vështirë të menaxhosh në mënyrë të sigurt **aksesin në informacion hetimor konfidencial dhe sekret**. Sa më shumë persona të përfshihen, aq më e madhe është mundësia e rrjedhjes së informacionit. Prandaj, prokurori duhet të organizojë punën në një mënyrë që do të përshkruajë qartë qarkullimin e informacionit dhe zinxhirin e komandës kur bëhet fjalë për hetimin.

66 Neni 26 i Ligjit nr. 25/2019.

67 Neni 165/a i KPP.

68 Neni 304, paragrafi 1 i KPP parashikon, mes të tjerash, detyrimin e prokurorit që të vërtetojë çdo fakt dhe rrethanë në favor të personit nën hetim. Meqë qëndrimi bashkëpunues i të pandehurit mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese, është e rëndësishme që prokurori të ketë një perceptim të qartë të qëndrimit të të pandehurit në lidhje me hetimin.

Për çështjet më sensitive këshillohet që dosja e çështjes të qëndrojë në prokurori. Në këtë rast, të gjitha provat duhet t'i paraqiten prokurorisë menjëherë pasi të mbliidhen. Relacioni shpjegues përfundimtar i hartuar nga OPGJ mund të përgatitet në prokurori. Në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e informacionit, prokurori duhet të krijojë një sistem të ndarjes së informacionit gjatë hetimit mbi bazën e nevojës për marrjen në dijeni. Detajet dhe informacioni përkatës duhet të ndahen vetëm me prokurorin dhe më pas prokurori do të vendosë se kush tjetër mund të njihet me informacionin. Ky sistem do të lehtësojë përpjekjet e prokurorit për të identifikuar rrjedhjen, për të marrë masa korrigjuese, për të kërkuar procedime disiplinore dhe ndoshta për të filluar një hetim penal.

Në mënyrë që të mbikëqyret kush merr çfarë në një hetim kompleks, çdo kopje e dokumentit që del nga prokuroria mund të përmbajë elemente dalluese. Këto elemente duhet të përfshihen në pjesën e dokumentit që tregon numrin e dosjes së çështjes ose temën e dokumentit. Elementet dalluese më të përdorura janë numrat që përcaktojnë numrin e kopjeve të bëra për një dokument. Për shembull, nëse në një çështje prokurori nxjerr një dokument në tre kopje, ku secila prej tyre duhet t'i dërgohet marrësve të ndryshëm, në cepin e sipërm në të djathtë të kopjes së dokumentit shënohet një numër tjetër (kopja nr.1, kopja nr.2 ose kopja nr.3). Kopja që do të qëndrojë në prokurori do të jetë kopja nr.1. Kopja që - për shembull - do t'i dërgohet OPGJ do të jetë kopja nr. 2 dhe kopja që do t'i dërgohet gjykatës do të jetë kopja nr. 3. Nëse më vonë gjatë hetimit del një kopje e dokumentit, është më e lehtë të identifikohet burimi i rrjedhjes (në shembullin e dhënë, nëse ka dalë nga prokuroria, OPGJ apo gjykata).

Zbatimi i një “zinxhiri ruajtjeje” për dokumentet, i ngjashëm me zinxhirin e ruajtjes për provat, mund të kontribuojë gjithashtu në zvogëlimin e numrit të personave që kanë kontakte me dokumentet brenda prokurorisë. Sistemi i “zinxhirit të ruajtjes” për dokumentet mundëson gjurmimin e personit që trajton dosjen e dhënë në çdo kohë të caktuar, personit që fut dhe heq dokumentet nga dosja e çështjes, personit që ka kërkuar kopje të dosjeve dhe arsyet për të, personit që ka lejuar lëshimin e kopjeve dhe arsyet për të, personit të cilit më vonë i janë dhënë kopjet, etj. Për të zbatuar një sistem të tillë, drejtuesi i prokurorisë/Prokurorisë së Posaçme duhet të parashikojë procesverbale të brendshme për njohjen me dosjen e çështjes. Për rrjedhojë, lista e personave që janë njohur me dosjen e çështjes, arsyet e njohjes, data dhe ora si edhe nënshkrimi i personit që ka lejuar njohjen me dosjen e çështjes duhet të jenë pjesë e secilës dosje të çështjes.

Shmangia e rrezikut të rrjedhjes mund të arrihet me anë të përcaktimit të **zinxhirit të komandës** në fushën e menaxhimit të qarkullimit të informacionit gjatë hetimit. Në këtë drejtim, prokurori mund t'i japë urdhra OPGJ-së që të komunikojë ekskluzivisht me prokurorin e çështjes dhe të ndajë me të çdo informacion në lidhje me çështjen.<sup>69</sup> Në të njëjtën kohë prokurori duhet të informojë drejtuesin e Policisë për përfshirjen e OPGJ-së së shërbimit në çështje dhe për urdhrin. Kjo nuk duhet të përjashtojë gatishmërinë e prokurorit për t'i dhënë drejtuesit të policisë informacion që prokurori beson se është e mundur që të ndahet.

Qarkullimi i duhur i informacionit ndërmjet prokurorit dhe oficerëve të policisë që janë caktuar për një çështje të caktuar kërkon rregulla dhe praktika komunikimi. Nevojiten **takime të rregullta** (të paktën një takim në javë) ndërmjet prokurorit dhe OPGJ-së, në prani ose me lidhje përmes internetit. Takimet në internet mund të ngrenë çështjen e sigurisë së komunikimit. Megjithatë duhet të theksohet se sot ka shumë alternativa programesh kompjuterike që mundësojnë komunikim të koduar që konsiderohet i sigurt (mesazh me zë, thirrje me video dhe mesazhe) ndërmjet palëve të interesuara.<sup>70</sup> Prandaj, nëse prokurorët përdorin telefona për të diskutuar çështje në lidhje me hetimin, ata nuk duhet të ngurrojnë të përdorin alternativat e programeve kompjuterike që mundësojnë takime përmes internetit me OPGJ-të.<sup>71</sup> Në këto takime, çdo OPGJ do të shpjegonte se sa ka ecur me hetimin, cilat veprime hetimore ka ndërmarrë dhe cilat janë rezultatet paraprake të veprimeve. Veprimet dhe veprimtaritë e ardhshme duhet të diskutohen gjithashtu. Nëse çështja është shumë sensitive, prokurori mund të ketë takime të veçanta me OPGJ-të e caktuar ose të vendosë se cili prej tyre duhet të marrë pjesë.

Gjatë hetimit duhet të ekzistojë një **protokoll për komunikimin**. OPGJ-të duhet të dinë se cilit prej tyre i është ngarkuar veprimi hetimor, kush është personi i parë për t'u kontaktuar në rast komplikimesh ose sfidash të tjera, si do të komunikojnë me prokurorin (me telefon, me internet përmes aplikacioneve të komunikimit, me SMS, me postë elektronike, etj.), si do të

69 Raportimi i të dhënave për hetimin jashtë prokurorisë konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore, sipas nenit 33 paragrafi 4/a të ligjit nr. 25/2019.

70 [http://www.eurojust.europa.eu/doclibrary/Eurojust-framework/Casework/First%20report%20of%20the%20observatory%20function%20on%20encryption%20%28joint%20Europol-Eurojust%20report%20-%20January%202019%29/2019-01\\_Joint-EP-EJ-Report\\_Observatory-Function-on-Encryption\\_EN.pdf](http://www.eurojust.europa.eu/doclibrary/Eurojust-framework/Casework/First%20report%20of%20the%20observatory%20function%20on%20encryption%20%28joint%20Europol-Eurojust%20report%20-%20January%202019%29/2019-01_Joint-EP-EJ-Report_Observatory-Function-on-Encryption_EN.pdf)

71 Megjithatë, problemet më sensitive duhet të diskutohen personalisht dhe alternativat e programeve kompjuterike nuk duhet të përdoren për të dërguar ose marrë dokumente, foto ose dosje në lidhje me hetimin. Qëllimi i tyre i vetëm duhet të jetë komunikimi gjatë hetimit (video, audio ose mesazhe).

regjistrohet ky komunikim, veçanërisht nëse ata marrin urdhra të ndryshëm nga ato të rëna dakord më parë, etj. Këto pyetje duhet të diskutohen në takimin e parë midis prokurorit dhe OPGJ-së. Prokurori duhet të ketë parasysh që gjuha e koduar/veprimtaritë përmblyllëse<sup>72</sup> mund të përdoren gjithashtu në komunikim kur ekziston rrezik i lartë i komunikimit me gojë. Për shembull, prokurorët dhe OPGJ-të mund të bien dakord që në rast se lind rrezik i papritur ose në rast se aksioni kompromentohet, OPGJ do të dërgojë një SMS bosh si një sinjal i ndërprerjes së aksionit. Kur OPGJ të ketë mundësinë, ai / ajo do të kontaktojë prokurorin dhe do ta informojë për atë që ka ndodhur.

Çështjet komplekse krijojnë një sasi të madhe dokumentacioni. Për të kuptuar qartë çështjen, provat dhe veprimet e kryera, është thelbësore që prokurori të zhvillojë **një sistem për qëllime arkivimi dhe regjistrimi**. Edhe pse në Shqipëri si rregull mbahen kopje fizike të dosjeve, organizimi i dosjeve elektronike është po aq i rëndësishëm dhe duhet të pasqyrojë organizimin e kopjeve fizike të dosjeve.

### 2.2.6.1. Organizimi i dosjes së çështjes

Ka disa mënyra për të organizuar kopje fizike të dosjeve.

Mënyra më e zakonshme është të mbahen dokumentet e dosjes sipas rendit kronologjik (dokumenti më i fundit në krye të dosjes), të numërohen faqet në mënyrë progresive (me numrin një shënohet dokumenti i parë në dosje) dhe të përgatitet indeksi i dosjes dhe nën-dosjeve që do të përditësohen rregullisht.

Kjo metodë - megjithëse më e lehtë për t'u zbatuar - mund të rezultojë më pak praktike, veçanërisht në lidhje me dosjet voluminoze, për të cilat mund të rrezikojë problematike tërheqja e materialeve dhe/ose organizimi i tyre sipas rëndësisë dhe logjikës. Sidoqoftë, ajo mund të përdoret në kombinim me metoda të tjera siç përshkruhen më poshtë.

Në secilën dosje të çështjes, nën-dosjet mund të organizohen në mënyrë tematike, për kategori specifike të informacionit, të tilla si, për shembull:

(a) Dosja e personit të përfshirë, e ndarë më tej në **nën-dosjen e dëshmitarëve** (që përmban informacionin e kontaktit dhe thëniet e

<sup>72</sup> Veprimtari përmblyllëse janë veprimtari që kanë kuptim të paracaktuar dhe nuk përfshijnë komunikim me gojë, siç është tundja e kokës për të treguar mungesë dakordësie.

dëshmitarëve), **nën-dosjen e të dyshuarve / të të pandehurve** (që përmban informacionin e kontaktit në lidhje me të pandehurit, thëniet dhe dokumentet mbështetëse siç janë prokura e avokatit dhe informacioni i kontaktit në lidhje me avokatin, informacioni për veprimtarinë e mëparshme kriminale të të pandehurit), **nën-dosjen e viktimave**, etj.;

(b) Dosja e korrespondencës së jashtme, që përmban më tej nën-dosje të ndryshme si **nën-dosja për gjykatat, nën-dosja për ekspertët, nën-dosja për bankat**, etj.;

(c) Dosja e inteligjencës, ku mblidhen të gjitha informacionet e inteligjencës që nuk mbështeten/ende nuk mbështeten në prova;

(d) Dosja e hetimit financiar, ku mbahen të gjitha provat dhe analizat për qëllimin e hetimit financiar (nëse kryhet);

(e) Dosja e kërkimit ligjor, ku mbahet kuadri ligjor përkatës, kërkimi ligjor dhe shembuj të praktikës gjyqësore.

Përveç organizimit të dosjes së çështjes në nën-dosje, duhet të hartohet edhe një protokoll për emërtimin e dokumenteve. Ky protokoll bën të mundur që vendndodhja e dokumenteve të përcaktohet lehtësisht dhe që provat të paraqiten më me lehtësi para gjykatës. Ai duhet të jetë sa më i saktë dhe i detajuar që të jetë i mundur.

Një mënyrë efikase për ta bërë këtë është duke zbatuar një protokoll emërtimi përshkrues dhe duke emërtuar çdo nën-dosje kryesore me shkronja të ndryshme të mëdha të alfabetit, dhe çdo nën-ndarje të mëtejshme me shkronja të vogla të alfabetit. Për shembull, Dosja e Personave të Përfshirë mund të emërtohet me “P”, Dosja e Korrespondencës së Jashtme me “K”; Dosja e Hetimeve Financiare me “F”, etj. Brenda dosjes “P”, nën-dosja për dëshmitarët mund të etiketohet me “d”, dhe nën-dosja për të pandehurit me “p”, etj.

Pastaj duhet të jepet një përshkrim i provave. Përshkrimi duhet të jetë i shkurtër, të përmbajë thelbin e provave dhe detaje të tjera të rëndësishme. Për shembull, procesverbalet e thënieve të dëshmitarit mund të emërtohen si “Deklarimi XX”, ku XX janë inicialet e dëshmitarit. Në vend të inicialeve, mund të përdoret gjithashtu një emër i plotë ose mbiemër. Mund të shënohet edhe data kur është dhënë deklarimi i dëshmitarit (p.sh.: “Deklarimi XX 15.08.2020”). Pasqyra e llogarisë bankare për vitin 2009 mund të emërtohet “Llogaritë 2009 (emri i bankës)”, ndërsa transkriptimi i përgjimit të të pandehurit duhet të përmbajë datën dhe orën e bisedës, i tillë si “përgjimi AA (numri i telefonit mund të shtohet gjithashtu ) 15.08.2020-18:00”, etj.

Gjithashtu, provat mund të etiketohen bazuar në formatin teknike që i përmban ato, siç janë dokumente (“doc”), foto (“pic”) audio ose video. Kur etiketoni llojin e provës, mund të shënohet gjithashtu edhe data e krijimit të provës nëse është e dobishme:<sup>73</sup> për shembull, “pic 01.01.2020”.

Kështu, një protokoll i plotë i emërimit do të dukej si më poshtë:

<emri i dosjes> \_ <emri i nën-dosjes> \_ <përshkrimi i provave> \_  
<lloji i provës>

Për shembull, “P\_d\_Deklarim-XX\_doc” i referohet formatit të dokumentit të një deklarami të dhënë nga dëshmitari XX që ndodhet në nën-dosjen e dëshmitarit të Dosjes së Personave të Përfshirë.

“K\_b\_2019\_llogaria XX Banka e Parë e Investimeve\_doc” i referohet formatit dok të pasqyrës së një llogarie bankare që i përket një personi XX dhe të siguruar nga Banka e Parë e Investimeve që ndodhet në nën-dosjen e Bankës së Dosjes së Korrespondencës së Jashtme. Për t’u theksuar, në shembullin e fundit dokumenti u vendos në Dosjen K (Korrespondencë e Jashtme) dhe jo në Dosjen F (Hetimi Financiar) sepse dokumenti ishte marrë nga banka, por jo si pjesë e një hetimi financiar.

Duhet të theksohet se kur organizoni prova në nën-dosje, baza për këtë organizim është burimi nga vijnë provat dhe jo kujt i referohen provat. Në nën-dosjen e të Pandehurit duhet të vendosen vetëm provat e mbledhura nga i pandehuri (p.sh. deklaramet e të pandehurit, provat e paraqitura nga i pandehuri, etj.). Në Dosjen e Korrespondencës së Jashtme duhet të jenë të gjitha provat që janë mbledhur nga palët e jashtme si bankat (Nën-dosja e Bankave), institucionet shtetërore (Nën-dosja e Policisë, Nën-dosja e Zyrës së Auditimit etj.), personat juridikë (Nën-dosja e Ofruesve të Shërbimeve), etj.

Një tjetër metodologji për emërtimin e protokolleve - më pak vizuale dhe relativisht më pak praktike se ajo përshkruese - bazohet në numërtimin e brendshëm. Sipas kësaj metodologjie, çdo aktivitet kryesor gjatë hetimit etiketohet me një numër dhe çdo rezultat i kësaj veprimtarie lidhet me të përmes nën-numrave. Për shembull, në një çështje komplekse prokurori paraqet një kërkesë për kontroll dhe gjykata e pranon kërkesën. Gjatë atij kontrolli, janë marrë prova dhe është mbajtur një procesverbal për këtë veprimtari. Kërkesa për kontroll e bërë nga prokurori do të etiketohej me numrin e brendshëm 1, urdhri i gjykatës për kontroll do të etiketohej

73 Në disa situata, data do të jetë tashmë pjesë e protokollit të emërimit (p.sh. deklarime të dëshmitarit). Në raste si këto, nuk është e nevojshme të shënohet datë në etiketën për formatin teknike.



me nën-numrin 1/2, procesverbali do të etiketohej si 1/3, dhe secila provë që rezulton nga kontrolli do të merrte nën-numrat vijues (p.sh. 1/4, 1/5, etj.). Nëse prokurori bën kërkesë për përgjim në të njëjtën çështje, ajo do të etiketohet si 2 dhe çdo veprim vijues i lidhur me këtë kërkesë me nën-numrin 2/2, 2/3 etj.

Cilado qoftë metoda që zgjidhet ose edhe nëse metodat kombinohen, nëse organizimi i dosjes bëhet siç duhet ndërkohë që vazhdon hetimi dhe provat janë akoma duke u mbledhur, në fund të hetimit prokurori do të jetë në gjendje të vlerësojë në mënyrë efikase rezultatet e tij dhe të vendosë rrjedhën e duhur të veprimit.

Gjithashtu, prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për teknologjitë digjitale dhe shkencore në dispozicion që ndikojnë në formatin në të cilin mblidhen dhe paraqiten prova të caktuara. Për shembull, për kontabilitetin për qëllime gjyqësore, të dhënat nga llogaritë bankare dhe të dhënat e tjera financiare normalisht mbahen dhe menaxhohen më mirë në formatin excel ose CSV. Nëse merret edhe një kopje elektronike e provave, preferohet që kopja të ketë një format të lexueshëm dhe të redaktueshëm.

Pavarësisht nga fakti që secili prokuror mund të ketë preferenca të ndryshme kur bëhet fjalë për organizimin e dosjes dhe zhvillimin e një protokollit emërtimi, do të jetë më praktik nëse përdoren metoda të standardizuara për emërtimin e protokolleve dhe sistemin e dosjeve. Kjo do të kontribuojë në unifikimin e praktikës së prokurorëve në të gjitha fazat e procedimeve penale, duke lehtësuar punën e OPGJ-ve të cilëve - duke punuar me prokurorë të ndryshëm - përndryshe do t'i duhet të përshtaten me preferencat e emërtimit të secilit prej tyre. Prandaj, Drejtuesit e Prokurorisë/ Prokurorisë së Posaçme ose Prokurori i Përgjithshëm mund të miratojnë Udhëzime të Përgjithshme për organizimin e dosjeve të çështjeve dhe protokolleve të emërtimit, duke përcaktuar (i) nën-dosjet që mund të jenë pjesë e dosjes së çështjes; (ii) përmbajtjen e secilës prej nën-dosjeve, duke përshkruar informacionin, provat dhe të dhënat që duhet të përfshihen në nën-dosje; (iii) emërtimin e nën-dosjeve dhe organizimin e brendshëm të dokumenteve (duke përcaktuar se si do të emërtohet nën-dosja dhe se si do të organizohen dokumentet, p.sh. në rend kronologjik të datës së secilit dokument); (iv) protokollin përfundimtar të emërtimit që do të përdoret për etiketimin e secilës provë, etj.



### 2.3. Vendosja e përparësive në punë

Ngarkesa e madhe e prokurorisë e bën të pamundur trajtimin e të gjitha çështjeve në të njëjtën kohë. Gjithashtu, lloje të ndryshme çështjesh dhe aktesh hetimore brenda çështjeve kërkojnë lloje të ndryshme kujdesi dhe përfshirje të ndryshme të prokurorëve në drejtim. Prandaj, prokurorëve u kërkohet të zhvillojnë mënyra efikase të vendosjes së përparësisë në ngarkesën e punës në mënyrë që të gjitha çështjet e caktuara të ndiqen si duhet dhe me profesionalizëm duke respektuar të drejtat e të dyshuarve, viktimave dhe të pandehurve si dhe detyrën kushtetuese për të dhënë drejtësi në çështjet penale.

Rregullat themelore për vendosjen e përparësive të çështjeve burojnë nga dispozitat e KPP-së. Në të gjitha situatat e tjera - që përfshijnë vendosjen e përparësive mes çështjeve tashmë me përparësi ose mes veprimtarive hetimore - është thelbësore një qasje profesionale me gjykim të shëndoshë e bazuar në menaxhim efikas të burimeve dhe delegimin efektiv.

Çështjet ose aktet hetimore ku **kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut** është në rrezik kanë përparësi, duke përfshirë çështjet ku (do të) merren masat e sigurimit personal si dhe masat e sigurimit pasuror.

Po kështu, çështjeve me **afat parashkrimi** të shkurtër ose që janë afër mbarimit të afatit të parashkrimit duhet t'u jepet përparësi për të shmangur pandëshkueshmërinë.

Çështjet për të cilat kërkohet **akuza e viktimës** duhet të kenë përparësi gjithashtu. Në disa nga këto çështje praktika tregon se vonesat në procedim ndikojnë në vendimin e viktimër për të paraqitur ose tërhequr akuzën, pasi shpesh viktimat i nënshtrohet presionit dhe ndikimit nga autori i krimit dhe në disa raste nga familjet e tyre dhe komuniteti, veçanërisht në çështje të dhunës seksuale dhe kundërvajtjet në kontekstin e marrëdhënieve familjare. Dhënia e përparësisë për këto çështje do të rrisë besimin e palëve të dëmtuara në efektivitetin e sistemit të drejtësisë, duke i bërë ata të ndihen të sigurt për të vazhduar me akuzën.

Veprimtarive me afat kohor ose **afate** të detyrueshme kohore duhet gjithashtu t'u jepet përparësi. E njëjta gjë vlen për çështjet për të cilat do të mbarojë afati i hetimit.

Gjithashtu, **çështjet me interes të lartë publik** mund të kërkojnë përparësi. Këto çështje ushtrojnë ndikim të madh në opinionin publik dhe perceptimin e publikut mbi efektivitetin e prokurorisë dhe sistemit të

drejtësisë në përgjithësi. Është e rëndësishme të tregohet përkushtim dhe përpjekje në hetimin e këtyre lloj çështjeve, por pritshmëria e publikut për rezultatin e hetimit nuk duhet të jetë faktori kryesor që përcakton nivelin e përkushtimit të prokurorisë për një çështje.

Këshillohet që prokurorët të mbajnë shënime zyrtare për caktimin e përparësisë së çështjeve. Shënimet duhet të përmbajnë një shpjegim të shkurtër të arsyeve për dhënien e përparësisë një çështjeje të caktuar. Në rast të vlerësimit të punës së prokurorëve, ky shënim mund të jetë një mjet shumë i dobishëm për të treguar objektivitetin dhe paanshmërinë e prokurorit, pasi vlerësuesi do të kuptojë qartë arsyet e prokurorit për të zgjedhur një çështje të caktuar mbi të tjerat dhe do të shmanget rreziku i akuzave për anshmëri.

Në përfundim, duhet të theksohet se caktimi i përparësive nuk do të thotë vetëm vendosje e përparësive mes çështjeve që i janë caktuar prokurorit, por gjithashtu do të thotë të vendosësh përparësi kur bëhet fjalë për veprimet e përgjithshme në portofolin e tij/saj. Meqenëse prokurorët kalojnë shumicën e kohës së tyre në gjykatë, është thelbësore të caktojnë të paktën dy ditë në javë vetëm për veprimet hetimore, për të zhvilluar takime me OPGJ-të dhe për të ushtruar rolin drejtues në hetim.

Drejtuesi i prokurorisë / Prokurorisë së Posaçme duhet të komunikojë planifikimin javor të secilit prokuror te kryetari i gjykatës kompetente për menaxhim efikas të gjykatës.

---

### *Konsiderata shtesë*

---

Prokurorët duhet të mësojnë të mendojnë jashtë kornizave kur bëhet fjalë për përdorimin e suksesshëm të burimeve në organizimin e punës së tyre. Kuadri ligjor në këtë drejtim lë hapësirë të mjaftueshme për qasje inovative duke lejuar përdorimin strategjik të të gjitha mundësive dhe ndihmës në dispozicion gjatë hetimeve.

Për shembull, praktikantët mund të ofrojnë mbështetje efektive në mbajtjen e shënimeve të veprimtarive të prokurorit, në dhënien e ndihmës së rëndësishme administrative dhe - në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjeve - në trajtimin e kundërvajtjeve penale dhe përgatitjen e urdhrave penal.

Në përfundim, është pothuajse e pamundur të dalin rezultate të efektshme hetimore nëse prokurori nuk është plotësisht i angazhuar në hetim, nuk i njeh të gjitha aspektet e çështjes dhe nuk është në gjendje të

përpunojë informacionin e inteligjencës të mbledhur nga OPGJ. Prandaj, për të drejtuar hetimin në mënyrë efektive, prokurori duhet të ketë informacion dhe njohuri përkatëse të mjaftueshme për çështjen. Përveç thjesht studimit të dosjes, përfshirja e drejtpërdrejtë e prokurorit në aktivitete të caktuara hetimore është thelbësore dhe duhet të kërkohet në mënyrë proaktive.

## **II. Menaxhimi i çështjes**

Siç parashikohet në kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë roli i prokurorit ka fokus kryesor drejtimin e hetimeve në çështje konkrete. Roli drejtues i prokurorit është një pozicion menaxherial që kryhet gjatë hetimit, i cili përfshin organizimin e përgjithshëm të hetimit, drejtimin e veprimeve hetimore dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të çështjes duke siguruar zbatimin e duhur të të gjitha rregullave procedurale. Ndryshimet në legjislacion që parashikojnë rolin drejtues të prokurorëve në hetime janë relativisht të reja. Si rezultat, aktualisht prokurorët kryejnë rolin e tyre në një kontekst ku ky rol i ri drejtues nuk është ende i mbështetur me burime të mjaftueshme dhe praktikat e konsoliduara të sistemit të mëparshëm vazhdojnë të zbatohen, duke e bërë të vështirë ushtrimin e plotë, të shpejtë dhe efektiv të këtij roli të ri, më të pavarur dhe drejtues. Vështirësia në fjalë shfaqet në nivelet e ndryshme të rolit drejtues që duhet të ushtrohet gjatë hetimit.

### **1. Kryerja e hetimit**

Gjatë hetimit mund të identifikohen tri faza kryesore, përkatësisht (i) planifikimi i hetimit, (ii) kryerja e hetimit dhe (iii) mbyllja e hetimit. Secila prej këtyre fazave ka specifikat e veta që kërkojnë qasje të ndryshme të rolit drejtues nga ana e prokurorit. Në paragrafët vijues, do të trajtohen disa nga sfidat kryesore me të cilat përballet prokurori.

#### **1.1. Planifikimi i hetimit**

Një nga hapat më të rëndësishëm për zhvillimin e suksesshëm të hetimit është planifikimi i duhur. Planifikimi i hetimit nuk është një veprimtari që ndodh vetëm një herë, por duhet parë më tepër si një proces. Ndërsa vijon hetimi, veçanërisht në çështje komplekse, duhet të bëhet edhe rishikimi edhe rregullimi i planeve fillestare dhe planifikime shtesë që do të ndjekin zhvillimet e çështjes.

Çdo çështje kërkon një qasje metodike, sistematike dhe të plotë. Meqenëse qëllimi kryesor i fazës përgatitore është të japë udhëzime hetimore dhe të përcaktojë veprimet hetimore, tashmë gjatë kësaj faze komunikimi i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i mendimeve me OPGJ-të me përvojë është thelbësor për zhvillimin e ideve mbi atë që duhet të hetohet, ku do të kërkohen provat, cilat mbrojtje të mundshme mund të jenë në dispozicion, etj.

### 1.1.1. Veprimet përgatitore të prokurorit

Planifikimi fillestar i hetimit përcakton drejtimin e hetimit dhe shkallën e suksesit të tij. Informacioni fillestar mbi veprimtarinë e dyshuar kriminale zakonisht jepet në referimet e policisë.<sup>74</sup> Sidomos në çështje komplekse, këshillohet që të mbahet një takim i shkurtër me OPGJ-në që ka bërë referimin dhe të verifikohet që i gjithë informacioni, përfshirë inteligjencën, të ndahet me prokurorin. Kjo do ta ndihmojë prokurorin të përcaktojë objektivin e hetimit dhe veprimet hetimore që do të ndërmerren. Gjatë takimit, prokurori duhet të inkurajojë OPGJ-në që të ndajë mendimet dhe idetë në lidhje me rrjedhën e mundshme të ngjarjes. Ky lloj bashkëpunimi fillestar forcon marrëdhënien profesionale mes prokurorit dhe OPGJ-së, krijon ndjenjën e punës në grup dhe nxit kulturën e bashkëpunimit dhe besimit të vazhdueshëm.

Para hartimit të urdhrit të hetimit, prokurori duhet së pari të **përcaktojë objektivat dhe qëllimin e hetimit** në mënyrë që të japë udhëzime të efektshme dhe të mbajë fokusin operacional. Në këtë moment, prokurori duhet të hartojë një strategji për hetimin, duke vlerësuar të gjithë faktorët e rëndësishëm për qëllimet e planifikimit dhe duke vendosur sekuencën e përgjithshme të veprimeve hetimore. Gjatë hartimit të strategjisë, prokurori duhet të konsiderojë nevojën për të mbledhur prova të ndodhura jashtë vendit, riskun e manipulimit të provave, manipulimit të dëshmitarëve dhe vonesat e qëllimshme të hetimit nga të dyshuarit, si edhe mundësinë e përgjithshme të pengimit dhe zgjatjes së hetimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në çështjet e lidhura me korrupsionin, pasi autorët e krimit shpesh kanë akses në dokumente zyrtare dhe kanë fuqinë të ndikojnë te dëshmitarët. Përcaktimi i veprimtarive hetimore që mund të marrin kohë dhe sfidat me të cilat mund të përballlet hetimi do të ndihmojnë për hartimin

---

<sup>74</sup> Megjithatë, siç thuhet më sipër, kallëzimet nga nëpunësit publikë dhe qytetarët si edhe përzgjedhja e mençur e medias përbën burim njësoj të rëndësishëm informacioni për të filluar në mënyrë proaktive një hetim dhe/ose për të urdhëruar policinë që të japë informacion të mëtejshëm më të saktë.

e një strategjie që mundëson menaxhim më të mirë të kohës dhe mbledhjen më efikase të provave.

Hapi tjetër për prokurorin është **të përcaktojë udhëzimet hetimore, përkatësisht** mënyrën (mënyrat) në të cilën prokurori parashikon se do të zhvillohet hetimi. Këto udhëzime përfaqësojnë skicën e parë të teorisë së çështjes<sup>75</sup> nga prokurori. Kur përcakton udhëzimet hetimore, prokurori duhet të ketë parasysh objektivat e hetimit, burimet e informacionit në dispozicion, burimet në dispozicion dhe strategjinë e përgjithshme për hetimin. Ndërsa shumë burime mund të japin informacion ose prova për rrethanat përkatëse dhe duhet të merren parasysh, prokurori duhet të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore dhe materiale në dispozicion dhe të identifikojë pista hetimore që janë realiste.

Prokurorët duhet të vlerësojnë nëse dhe në çfarë mase nevojitet përfshirja e agjencive<sup>76</sup> të tjera në hetim. Nëse ekziston një nevojë e tillë, para përgatitjes së urdhrat të hetimit, prokurori duhet të identifikojë agjencitë, të mbledhë informacionin e rëndësishëm për anëtarët që duhet të përfshihen në hetim, të vlerësojë aftësinë e tyre për të kontribuar dhe të negociojë pjesëmarrjen dhe rolet e tyre në hetim.

Në këtë fazë të planifikimit të hetimit, prokurori duhet të jetë i hapur për çdo informacion, përfshirë informacionin e inteligjencës që nuk mund të verifikohet me prova, por mund të ndihmojë në zhvillimin e teorisë së çështjes. Sidoqoftë, në fund të hetimit, prokurori duhet të jetë në gjendje të mbulojë të gjitha aspektet e teorisë së çështjes me prova, qofshin ato të drejtpërdrejta ose rrethore.

75 Teoria e çështjes nuk është asgjë më shumë se një ngjarje bindëse logjike e asaj që ka ndodhur nga këndvështrimi i prokurorit. Kjo është “arsyeja”, “justifikimi” ose “shpjegimi” pse akuzat duhet të ketë epërsi në gjykim. Teoria e çështjes duhet të zhvillohet në mënyrë logjike dhe të qëndrueshme në mënyrë që pas shqyrtimit të provave dhe dëshmimeve nga të gjithë dëshmitarët, gjykata në mënyrë racionale të mund të japë vendimin në favor të prokurorit. Shihni në këtë drejtim *Investigative Activities, a guidebook for practitioners*, Mision i OSBE-së në Shkup, 2010 <https://www.osce.org/skopje/78151>. Për një model të teorisë së çështjes shihni <https://law.indiana.edu/instruction/tanford/b584/CaseTheory.pdf>.

76 Për shembull, Ministria e Financave (që ofron ekspertë për inspektimin financiar publik); doganat, FIU; SHISH etj. Duhet të theksohet se veprimet hetimore duhet të kryhen vetëm nga OPGJ, ndërsa profesionistët e tjerë të përfshirë në hetim mund të ndihmojnë duke dhënë informacion specifik, njohuri dhe sugjerime për orientimet hetimore.

## 1.1.2. Hartimi i urdhrin të hetimit

Pasi prokurori të ketë kryer të gjitha veprimet përgatitore, hapi tjetër është **zhvillimi dhe hartimi i planit të hetimit** ku do të përshkruhen objektivat e identifikuara, përshtatjet e hetimit, rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesuara. Ndërsa kuadri ligjor ekzistues nuk e parashikon planin e hetimit si një dokument të veçantë, zyrtar, përmbajtja e tij zakonisht pasqyrohet në **urdhrin e hetimit**, përmbajtja e të cilit përcaktohet lirisht nga prokurori i çështjes, pasi ligji nuk përcakton ndonjë përmbajtje specifike të urdhrin të hetimit.

Minimalisht, urdhri i hetimit duhet të strukturohet si më poshtë:

**Seksioni I:** përcaktimi i objektiveve të hetimit dhe faktet që duhet të vërtetohen; **Seksioni II:** përcaktimi i veprimeve hetimore, radha sipas së cilës ato duhet të kryhen dhe OPGJ-të kompetente për t'i kryer; **Seksioni III:** përcaktimi i zinxhirit të komandës dhe qarkullimit të informacionit.

Gjatë hartimit të urdhrin të hetimit, prokurorët duhet të jenë sa më specifike dhe të saktë. Së pari, prokurori duhet të shprehë objektivat e hetimit, duke përshkruar cilat rrethana dhe cilat elemente të veprimtarisë kriminale duhet të hetohen dhe duke shpjeguar rrethanat për të cilat nevojiten provat. Më pas, prokurori duhet të japë drejtimet e hetimit, duke shpjeguar veprimet e pritshme hetimore, dhe nëse është e nevojshme radhën e tyre dhe afatin deri kur duhet të kryhen këto veprime. Në fund, prokurori duhet të caktojë se kush do të kryejë veprimet. Nëse agjenci të tjera përveç policisë duhet të përfshihen në hetim, prokurori duhet të japë udhëzime të qarta se cilat veprime hetimore do të kryhen nga agjencitë e tjera. Urdhra të veçantë që i drejtohen OPGJ-ve të caktuar për të kryer veprime specifike hetimore, mund t'i bashkëngjiten urdhrin kryesor të hetimit. Nëse vendoset krijimi i një grupi, prokurori ose mund të caktojë ose të delegojë aktivitete specifike tek anëtarët e grupit, ose të lejojë grupin që të vendosë se kush do të kryejë secilën veprimtari.

Nëse është e nevojshme, prokurori mund të miratojë plane taktike - d.m.th. udhëzime praktike për kryerjen e veprimeve hetimore - që mund të jenë pjesë e urdhrin të hetimit ose të përfshihen në një akt të veçantë me shkrim të prokurorit.

Për shembull, në një hetim, mes pyetjeve të tjera, prokurori duhet të sqarojë marrëdhënien midis disa të dyshuarve që janë bashkëpunëtorë në veprimtari biznesi. Në urdhrin e hetimit, prokurori tregon që veprimtaritë e mëposhtme hetimore duhet të kryhen sipas radhës që vijon: (i) përgjimi, (ii)

mbledhja e dokumenteve, (iii) kontrole të personit të dyshuar dhe banesës së tij / saj, (iv) marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe (v) marrja në pyetje e të dyshuarve. Prokurori pastaj zhvillon një plan taktik në formën e një aneksi të urdhrit të hetimit.

Plani taktik përcakton që dy javë pas fillimit të përgjimit dhe ndërkohë që përgjimi vazhdon akoma, OPGJ do të mbledhë dokumentacionin nga kompania e të dyshuarit. Pas pesë ditësh nga mbledhja e dokumentacionit, do të kryhet kontrolli i të dyshuarve dhe banesës së tyre. Të nesërmen e kontrollit, do të merret në pyetje ish-bashkëshortja e njërit prej të dyshuarve, bashkëpunëtori i tij i biznesit dhe llogaritari i të dyshuarit të dytë. Marrja në pyetje e të dyshuarit do të caktohet pak para se të mbarojë përgjimi. Në këtë mënyrë prokurori do të jetë në gjendje të ndjekë komunikimet mes të dyshuarve ndërkohë që veprimi hetimor është ende duke u kryer dhe me shpresën që nga ai komunikim do të merret informacion i dobishëm.

Prokurorët duhet të kenë parasysh se ka situata ku dëshirohet dhe rekomandohet përfshirja e drejtpërdrejtë dhe kryerja e veprimeve hetimore nga vetë prokurori, siç janë pjesëmarrja për verifikim në terren, marrja në pyetje e dëshmitarëve, marrja në pyetje e të dyshuarve, etj.<sup>77</sup> Këto veprime mund të identifikohen tashmë në këtë fazë ose më vonë gjatë hetimit.

Siç u përmend më lart, **çështjet e qarkullimit të informacionit dhe zinxhirit të komandës** për të mbrojtur hetimin nga rrjedhjet e informacionit duhet të adresohen në fazën e hartimit të urdhrit të hetimit. Prokurori duhet të përshkruajë qartë qarkullimin e informacionit, duke miratuar nëse është e nevojshme një protokoll të bazuar **në parimin e nevojës për marrje të dijenisë** për (i) mënyrën e ecurisë së dosjes së çështjes gjatë hetimit, (ii) vendin ku do të mbahet, (iii) mënyrën e trajtimit nga OPGJ, (iv) personin që mund të njihet me të, etj. Sa i përket zinxhirit të komandës gjatë hetimit, prokurori mund të urdhërojë OPGJ-në të komunikojë ekskluzivisht me prokurorin për qëllim të hetimit. Urdhri mund të jepet si pjesë e urdhrit të hetimit ose në një akt të veçantë me të cilin prokurori i cakton OPGJ-së kryerjen e veprimeve hetimore. Siç u sugjerua më lart, prokurori duhet të informojë drejtuesin e Policisë për urdhrin ndërkohë që ofrohet të qëndrojë në dispozicion për të dhënë informacion që prokurori beson se është e mundur të ndahet.

Një format tip i planit të hetimit jepet në Aneksin VI të këtij Manuali.

<sup>77</sup> Më shumë detaje për momentin kur dhe arsyen pse këshillohet që prokurori të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në kryerjen e veprimeve hetimore jepen në Pjesën II, Kapitulli 1.1.3 të këtij Manuali.



### **1.1.3. Veprime hetimore**

Qëllimi kryesor i veprimitarisë hetimore është mbledhja e provave për veprën penale të dyshuar. Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë parashikon që në gjykatë pranohen vetëm provat e mbledhura në përputhje me rregullat procedurale.<sup>78</sup> Prandaj, një nga aspektet kryesore ku roli drejtues i prokurorëve bëhet më i rëndësishëm është të sigurohet që veprimet hetimore të qëndrojnë gjithmonë brenda caqeve ligjore të rëndësishme për pranueshmërinë dhe përdorimin e provave në gjykatë, si dhe për respektimin e të drejtat themelore të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve.

Edhe pse qëllimi kryesor i veprimeve hetimore është mbledhja e provave, prokurori duhet të ketë parasysh se për të rritur shanset e një hetimi të suksesshëm, ai/ajo duhet të ketë një qasje sa më gjithpërfshirëse për veprën e dyshuar dhe rrethanat e saj, pavarësisht nga fakti që në fund të hetimit ai/ajo mund të mos jetë në gjendje të provojë disa nga aspektet e çështjes. Prandaj, mbledhja e inteligjencës gjatë hetimeve është po aq e rëndësishme sa mbledhja e provave për të vërtetuar ngjarjet.

KPP përshkruan një gamë të gjerë të veprime hetimore. I takon prokurorit dhe policisë gjyqësore të zgjedhin ato më të përshtatshmet për mbledhjen e provave, duke pasur parasysh rrethanat në secilën çështje. Në Aneksin VIII jepet një diagram i veprimeve hetimore, që përmban hapat për zgjedhjen e veprimeve më të përshtatshme.<sup>79</sup>

Seksionet e mëposhtme ofrojnë disa konsiderata në lidhje me rolin drejtues të prokurorit gjatë fazës së mbledhjes së provave. Disa paragrafë i referohen drejtpërdrejt tekstit të kodit procedural dhe të tjerët u referohen detyrave që kodi i cakton kryesisht OPGJ-ve. Qëllimi për këtë është që të orientojë vëmendjen e prokurorit drejt disa kërkesave të detyrueshme procedurale, si dhe nevojës për të ushtruar një rol drejtues dhe monitorues në të gjithë ciklin e hetimit.

---

78 Neni 149 paragrafi 1 i KPP parashikon si më poshtë: “Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.”

79 Diagrami shoqërohet me relacion shpjegues.



### 1.1.3.1. Identifikimi i personave me interes<sup>80</sup>

Identifikimi i personave të interesit - qofshin personat nën hetim ose persona që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimin e hetimit - është një veprimtari tipike e policisë.

Prokurorët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë respektimit nga policia e procedurave të parashikuara në KPP - veçanërisht kur bëhet fjalë për gjurmët e gishtërinjve, ekzaminimet fotografike dhe antropometrike, si dhe kampionët biologjikë<sup>81</sup> të personave në hetim - përfshirë afatet kohore për kufizimin e lirisë së personave në proces identifikimi.

Pasi të jetë informuar për shoqërimin e një personi në polici për qëllime identifikimi, prokurori duhet të mbajë shënime për kohën kur ai / ajo është informuar, identitetin e oficerëve të policisë që kanë ndërmarrë veprimtarinë, identitetin e personit që është shoqëruar, vendin e shoqërimit, arsyet e shoqërimit, momentin e liritit dhe rezultatit e kontrolleve.

### 1.1.3.2. Mbledhja e informacionit dhe marrja e dëshmisë nga dëshmitarët<sup>82</sup>

Sipas legjislacionit shqiptar, dëshmitarët mund të intervistohen nga vetë prokurorët ose nga OPGJ. Kuadri ligjor përcakton disa kërkesa procedurale ndaj të cilave prokurori i çështjes duhet të ushtrojë vëgjelencë.

Si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët **do të merren në pyetje për faktet që përbëjnë objektin e provave<sup>83</sup> dhe faktet specifike<sup>84</sup>.**

80 Neni 295, Neni 297 paragrafi 1 i KPP.

81 Neni 201/a i KPP kërkon pëlqimin e personit të cilit i merret kampioni biologjik. Në mungesë të pëlqimit të personit, prokurori duhet të kërkojë një urdhër gjykate për të marrë kampionin biologjik.

82 Neni 297 i KPP, Neni 312 i KPP.

83 Neni 153 dhe 154 i KPP. Kjo kërkesë procedurale ka dy përjashtime kryesore: 1) dëshmitari nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit, përveçse kur çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë shoqërore dhe 2) marrja në pyetje e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farenfisnisë dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe palëve apo dëshmitarëve të tjerë, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Dëshmia mbi faktet që shërbejnë për të përcaktuar personalitetin e viktimës nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza ndaj të pandehurit duhet të vlerësohet në lidhje me sjelljen e viktimës.

84 Dëshmitari nuk do të dëshmojë për fakte që i ka mësuar nga të tjerë as nuk do të japë mendimin e tij personal, përveçse kur ato janë pjesë e pandarë e dëshmisë së tij për faktet. Gjithashtu nuk pranohet dëshmia indirekte (fjalët e të tjerëve), nëse personat prej të cilëve dëshmitari ka dëgjuar faktet nuk dëshmojnë vetë. Ka përjashtime vetëm në situata ku marrja në pyetje e këtyre personave është e pamundur sepse ata kanë vdekur, janë shumë të sëmurë ose nuk

Veç kësaj, prokurorët duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë **rrethanave ekzistuese të papajtueshmërisë me detyrën e dëshmitarit<sup>85</sup> dhe përjashtimeve ekzistuese nga detyrimi për të dëshmuar<sup>86</sup>**. Kur policia ngarkohet me mbledhjen e deklarimeve nga dëshmitarët, prokurori duhet të informojë OPGJ-në për nenet përkatëse të KPP-së. Nëse gjatë marrjes në pyetje OPGJ-ja gjen arsye për papajtueshmëri ose përjashtim nga detyrimi për të dëshmuar, ai / ajo duhet të ndalojë marrjen në pyetje dhe të informojë prokurorin. Në një situatë të tillë - pasi dëshmitarët mund të përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar para gjykatës edhe pse gjatë hetimit ata kanë vendosur të japin deklarin e tyre - prokurori duhet të sigurohet që të mblidhen prova të tjera për fakte për të cilat dëshmitari duhej të dëshmonte.

Edhe pse KPP nuk i detyron zyrtarisht prokurorët dhe OPGJ të paralajmërojnë dëshmitarët për përgjegjësinë penale për dëshmi të rreme ose refuzim për të dëshmuar, ekzistenca objektive e kësaj përgjegjësie dhe interesi për zhvillim efikas të procedimit e bën të këshillueshme që para dhe gjatë pyetjes (në rast të deklaratave që janë kontradiktore, jo të plota ose të kundërta me provat e tjera) dëshmitarët të paralajmërohen për pasojat e kallëzimit të rremë<sup>87</sup>, deklarin të rremë<sup>88</sup> dhe dëshmisë së rreme<sup>89</sup> ose refuzimit për të dëshmuar.

Prokurorët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë regjimit të përdorimit të thënieve të dëshmitarëve siç parashikohet në dispozitat e KPP-së dhe interpretimit të tyre. Në fakt, shkelja e dispozitave që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe përmbajtjen e deklarimeve mund të kthehet në një deklaratë pavlefshmërie. Ndërkohë që një praktikë gjyqësore më tolerante zbaton parimin e efikasitetit dhe deklaron “pavlefshmërinë e pjeshme” të një deklarin (duke ruajtur kështu pjesët e saj që nuk preken nga shkelja), qasje më të rrepta do të çonin në fshirjen e të gjithë deklarin nga lista e provave.

**Prokurorët duhet të marrin në konsideratë marrjen e deklarimeve të dëshmitarëve drejtpërdrejt nga ata vetë në disa situata, për shembull kur dëshmitari është gjithashtu viktimë e krimit, kur**

---

mund të gjenden. Megjithatë, nëse dëshmitari refuzon të tregojë personin ose burimin që e ka informuar për faktet, dëshmia e tij/saj nuk do të përdoret.

85 Neni 156 i KPP.

86 Neni 158, Neni 159 dhe Neni 160 i KPP.

87 Neni 305 i KP.

88 Nenet 305/a dhe 305/b të KP.

89 Neni 307 i KP.

dëshmitari është nga një kategori vulnerabël<sup>90</sup>, kur janë kryer krime sipas neneve 230, 230 / a, 230 / b, 230 / c, 230 / ç, 231, 232, 232 / a, 232 / b, 234, 234 / a, 234 / b, 265 / a, 265 / b, 265 / c të KP me qëllim që prokurori të përcaktojë nëse teknikat e veçanta të marrjes në pyetje duhet të zbatohen<sup>91</sup>, si dhe sa herë që konsiderohet e nevojshme ose e përshtatshme. Ndër arsyet që sugjerojnë një ndërhyrje të drejtpërdrejtë të prokurorit është armiqësia e mundshme, rezistenca ose ndjenja e “viktimizimit” që zhvillohen te dëshmitarët kundrejt oficerëve të policisë nëse ata duhet të merren në pyetje në mënyrë të përsëritur. Për më tepër, prania e prokurorit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve vulnerabël rrit besimin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe gjithashtu zhvillon ndjesinë e kontrollit dhe ekuilibrit, ku një autoritet më i lartë vlerëson punën e policisë, duke bërë të mundur që viktimat të marrin mbrojtje të plotë nga sistemi. Për shembull, edhe pse oficerët e policisë gjyqësore mund të mbledhin informacione nga të miturit në prani të një prindi ose kujdestari ligjor ose të një personi të rritur të zgjedhur nga i mituri dhe psikologu, preferohet që këta dëshmitarë të merren në pyetje nga prokurori për t’u siguruar që vetëm me një deklaram të mbulohen të gjitha faktet përkatëse.

Duke iu referuar sidomos rasteve të marrjes në pyetje me identitet të fshehur, dëshmitarët shpesh ngurrojnë të diskutojnë me oficerët e policisë rreziqet me të cilat përballen pasi ata zakonisht janë informatorë që nuk besojnë në autoritetet e tjera publike ose kanë vuajtur nga kërcënimet e mëparshme. Praktika ka treguar se prania e një prokurori gjatë marrjes në pyetje sjell ndjenjën e një angazhimi më të lartë në sytë e dëshmitarit dhe perceptimin e seriozitetit në qasje. Gjithashtu, gjatë paraqitjes në gjykatë të kërkesës për marrjen në pyetje të një dëshmitari me identitet të fshehur, prokurori duhet të paraqesë arsyet pse nevojitet përdorimi i një ose më shumë teknikave të posaçme të marrjes në pyetje.<sup>92</sup> Kështu, prokurori duhet të bindet personalisht që arsye të tilla ekzistojnë vërtet dhe cila është masa e rrezikut të mundshëm me të cilin përballen dëshmitarët.

Marrja në pyetje e një dëshmitari kërkon **mbajtjen e procesverbalit**. KPP nuk përshkruan përmbajtjen e procesverbalit të seancave dëgjimore të zhvilluara gjatë hetimit. Sidoqoftë, duhet t’i bëhet referencë dispozitave të përgjithshme që përmban neni 115 e në vijim, *mutatis mutandis*.

90 Autorë të rinj ose me paaftësi fizike, autoret femra, viktimat e mitur, dëshmitarët e mitur, dëshmitarët e moshuar, dëshmitarët me paaftësi fizi

91 Neni 165/a i KPP.

92 Neni 165/a i KPP.

Pjesë e aftësive drejtuese të prokurorit është gjetja e mënyrave **për të motivuar dëshmitarët** të japin deklaratimet e tyre, duke i bërë ata të ndjehen të sigurt dhe të gatshëm për të kontribuar në hetime. Prandaj, prokurori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin e një marrëdhënieje të bazuar në besim me dëshmitarët kryesorë.<sup>93</sup> Për këtë qëllim, dëshmitarët mund të kenë disa biseda joformale me OPG-në ose prokurorin dhe pasi të krijohet besimi, deklaratimet zyrtare mund të merren nga policia ose prokurori, në varësi të rrethanave në secilën çështje. Në çështje sensitive, dhe para marrjes në pyetje, - inteligjenca për të shkuarën e një dëshmitari të mundshëm, që mund të japë informacionin e duhur, mund të jetë jashtëzakonisht e dobishme.

Në çështje sensitive - përfshirë ato të dhunës në familje, dëshmitarët mund të ngurrojnë të bashkëpunojnë me autoritetet hetimore. Në shumicën e rasteve, mungesa e dëshirës për të bashkëpunuar vjen për shkak të frikës nga ekspozimi publik, kërcënimet dhe hakmarrja. Gjithashtu, disa dëshmitarë mund të jenë subjekt i kërcënimit dhe manipulimit përpara se autoritetet zyrtare t'i kontaktojnë ose gjatë hetimit. Kështu, prokurorët duhet të jenë të gatshëm të marrin masat e duhura për të përballuar këto vështirësi, përfshirë kërkesën për masa sigurimi personale ndaj atyre që ushtrojnë ndikim, kërkesën për pranimin e provave në seancën paraprake, mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit dhe personit sipas nevojës, masën e ruajtjes së distancës fizike mes dëshmitarit dhe të dyshuarit gjatë marrjes në pyetje, etj. Kur merret në pyetje një viktimë e dhunës në familje, OPGJ-ja ose prokurori duhet ta informojnë viktimën për llojet e mundshme të mbështetjes (mbështetje ligjore, qendra strehimi, etj.) dhe ta inkurajojnë viktimën që të përdorë këto shërbime, veçanërisht në rastet kur autori është recidivist.

### **1.1.3.3. Mbledhja e informacionit nga personi nën hetim dhe marrja në pyetje e personit nën hetim<sup>94</sup>**

Prokurori mund t'i delegojë OPGJ-së marrjen në pyetje të personit nën hetim. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet rregullave që kanë të bëjnë me procedurën e saktë të njoftimit, praninë e mbrojtësit gjatë hetimit, si edhe dispozitave që rregullojnë caktimin dhe pjesëmarrjen e avokatit

93 Krijimi i kësaj marrëdhënieje nuk duhet të kuptohet në asnjë mënyrë si “ushqimi” i dëshmitarit me një variant të caktuar të fakteve në hetim. Një sjellje e tillë jo vetëm që nuk do të ishte etike, por do të çonte edhe në shpalljen e pavlefshmërisë së dëshmisë.

94 Neni 296, Neni 308 i KPP.

mbrojtës në veprimet hetimore.

Sidomos në çështje më komplekse dhe në ato ku ekzistojnë mundësitë për pranim të fajësisë, marrja në pyetje e personit nën hetim duhet të bëhet personalisht nga prokurori.

Nëse një person është i pandehur në një procedim të bashkuar, marrja në pyetje duhet të kryhet nga prokurori.<sup>95</sup>

#### **1.1.3.4. Ballafaqimet<sup>96</sup>**

Ballafaqimet si veprime hetimore duhet të kryhen vetëm kur ka deklarime të ndryshme kontradiktore dhe prokurori dyshon se kë të besojë. Duke pasur parasysh që ky veprim hetimor ka për qëllim sqarimin e fakteve dhe rrethanave dhe eliminimin e mospërputhjeve, është më e përshtatshme që prokurori t'i zhvillojë ato personalisht.

Kur vendos nëse do të kryejë ballafaqimin, prokurori duhet të marrë parasysh llojin e krimit, statusin e njerëzve që janë subjekt i ballafaqimit dhe nevojën për një veprimtari të tillë. Ballafaqimet duhet të shmangen kur ka prova të mjaftueshme në mbështetje të një prej deklarimeve. Gjithashtu, ballafaqimet mes të pandehurve të akuzuar për vepra penale të dhunës në familje ose seksuale dhe viktimave të tyre të dyshuara sjellin rrezikun e traumatizimit të mëtejshëm të viktimave dhe duhet të shmangen.

#### **1.1.3.5. Njohjet<sup>97</sup>**

Njohja është një veprimtari hetimore që sipas legjislacionit shqiptar mund të kryhet për personat dhe sendet.

Rregullat për kryerjen e njohjes përcaktohen në mënyrë rigorozë në KPP dhe mosrespektimi i këtyre dispozitave rezulton në pavlefshmëri të njohjes. Kur urdhërohet njohja, këshillohet që prokurori të theksojë në urdhrin e hetimit kushtet për vlefshmërinë e procedurës, duke i bërë referencë specifike pranisë së detyrueshme të avokatit mbrojtës gjatë njohjes së personave dhe detyrimit për të mbajtur procesverbalin e veprimit.

Ky veprim hetimor duhet të kryhet nga OPGJ-ja në bashkëpunim me oficerë policie të policisë së shtetit të cilët mund të ndihmojnë në gjetjen

<sup>95</sup> Neni 311 i KPP.

<sup>96</sup> Neni 169 -170 i KPP.

<sup>97</sup> Neni 171 -175 dhe Neni 313 i KPP.

e personave ose sendeve me tipare të ngjashme me ato të objektit të njohjes. Nëse ka dyshime për mënyrën se si duhet të bëhet njohja, OPGJ duhet të kontaktojë prokurorin dhe të kërkojë udhëzime. Gjithashtu, prokurori mund të caktojë një OPGJ të seksioneve të marrë pjesë në procedurën e njohjes dhe të sigurojë përmbushjen e të gjitha kërkesave procedurale.

Personat, sendet dhe objektet e tjera duhet t'i paraqiten vizualisht ose t'i tregohen personit që duhet të bëjë njohjen. Kur ka arsye të bazuara për të besuar se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të ngurrojë ose të jetë ndikuar nga prania e personit që do të njihet, prokurori merr masa për kryerjen e këtij veprimi në mënyrë që personi i thirrur për të bërë njohjen, të mos shihet. Në çështje shumë të rënda (terrorizëm, krim të organizuar ose korrupsioni) këshillohet që prokurori të organizojë dhe të marrë pjesë personalisht në njohjen e personave. Para se të bëhet njohja, prokurori mund të urdhërojë regjistrim me video dhe audio të procedurës së njohjes, pasi më vonë gjatë procedurës personat që kanë bërë njohjen mund të argumentojnë se ata ishin të detyruar nga policia për të bërë njohjen, ose që policia u ka treguar atyre personin që duhet të njohin. Pas këtyre pretendimeve, gjykata mund të vendosë të mos pranojë njohjen dhe një nga provat kryesore mund të humbasë. Kështu, prania e prokurorit paralelisht me regjistrimin video dhe audio do të ngushtojë mundësitë për abuzim në procedurat e njohjes dhe do të kryhet me më tepër objektivitet.

### **1.1.3.6. Kryerja e një eksperimenti<sup>98</sup>**

Prokurori mund të urdhërojë kryerjen e një eksperimenti si një veprim hetimor kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur apo mund të ketë ndodhur në një mënyrë të caktuar.

Eksperimenti është një veprim hetimor që zakonisht ndodh në fazën e mëvonshme të hetimit. Para se të urdhërohet eksperimenti, prokurori së pari duhet të mbledhë të gjitha provat e çështjes, të kuptojë qartë situatën dhe të vlerësojë nevojën për një ekspert që do të kontribuojë në përfundimet përkatëse.

KPP përshkruan rregulla se si duhet të kryhet eksperimenti dhe përshkruan vendimin nga organi procedues. Vendimi duhet të përmbajë një njoftim përmbledhës mbi objektin e eksperimentit duke përfshirë ditën, orën dhe vendin ku do të zhvillohen veprimet. Gjithashtu, prokurori, si organ procedues gjatë hetimeve, duhet të miratojë masat e duhura për të

98 Nenet 176 – 177 e KPP.

kryer veprimet, duke përfshirë urdhrin për fotografim dhe regjistrim video, dhe për të parandaluar çdo rrezik për sigurinë personale ose publike.

Eksperimenti zakonisht kryhet nga OPGJ dhe mund të ndihmohet nga një ekspert. Meqenëse është një veprimtari që kërkon mbështetje të konsiderueshme organizative dhe logjistike, këshillohet që prokurori të jetë i pranishëm gjatë eksperimentit për të vëzhguar rregullsinë e procedurës, për të dhënë orientim të mëtejshëm mbi realizimin e tij, për të marrë sqarime nga OPGJ dhe eksperti, për të propozuar teori alternative në lidhje me ndodhjen e ngjarjeve, dhe për këtë arsye për të kontribuar në mënyrë aktive në vërtetimin e fakteve.

### **1.1.3.7. Mbledhja e dokumenteve<sup>99</sup>**

Prokurori mund të urdhërojë mbledhjen e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, regjistrimit ose çdo mjeti tjetër. Dokumentet që përbëjnë provë materiale duhet të merren pavarësisht personit që i ka krijuar ose që i mban.

Kur është e mundur, duhet të merren dokumentet origjinale. Sidoqoftë, në rastet kur origjinalet janë prishur, kanë humbur ose janë të papërdorshme, duhet të merren kopjet.

Urdhri i prokurorit për mbledhjen e dokumenteve duhet të ketë disa udhëzime në lidhje me natyrën e dokumenteve që duhet të merren (p.sh. dokumentet në lidhje me procedura të caktuara të prokurimit publik), vendin ku mendohet se mbahen dokumentet (p.sh. dokumentet që mban Kontrolli i Lartë i Shtetit) ose llojin e dokumenteve të kërkuara (p.sh. fotografi, video, audio, të shkruara, etj.). Kur urdhërohet mbledhja e regjistrimeve audio, nëse është e nevojshme, prokurori mund të urdhërojë edhe transkriptimin e tyre. Rekomandohet që prokurori së pari të dëgjojë regjistrimet audio dhe pastaj të urdhërojë transkriptimin e tyre në mënyrë që të shmanget përdorimi i panevojshëm i burimeve.

Kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se dikush po fsheh një dokument që përbën provë materiale ose sende që i përkasin veprës penale, atëherë prokurori duhet të marrë një urdhër kontrolli.

Gjithashtu, mund të kërkohet urdhri i sekuestrimit nëse dokumenti ndodhet në një kompjuter ose mbahet nga një ofrues shërbimi; paraqet korrespondencë që është dërguar nga ose për të pandehurin qoftë me emër

<sup>99</sup> Nenet 191 -197 e KPP.



tjetër ose përmes një personi tjetër; është një dokument bankar; klasifikohet si sekret ose ndodhet në zyrat e shërbimit informativ, etj.

Të gjitha dokumentet e tjera mund të mblidhen drejtpërdrejt nga policia gjyqësore. Megjithatë, dokumentet që përbëjnë njoftime anonime ose nuk do të merren ose nuk do të përdoren, përveç rasteve kur ato përbëjnë prova materiale ose janë krijuar nga i pandehuri.

Në rastet kur prokurori duhet të vlerësojë personalitetin e të pandehurit ose të viktimës kur fakti që shqyrtohet do të vlerësohet në lidhje me sjelljen ose cilësitë e tyre morale, prokurori mund të kërkojë mbledhjen e dëshmimeve penale dhe vendimeve të formës së prerë të dhëna nga gjykata. Dokumente të tilla mund të merren gjithashtu për të vlerësuar besueshmërinë e një dëshmitari.

Prokurori gjithashtu mund të urdhërojë mbledhjen e procesverbaleve të provave nga procedime të tjera penale, nëse ato kanë të bëjnë me marrjen e provave përpara procesit gjyqësor ose prova të administruara gjatë gjykimit; mbledhjen e procesverbaleve të provave të marra në një gjykim civil për të cilin është dhënë një vendim i formës së prerë; mbledhjen e procesverbaleve të veprimeve që nuk mund të përsëriten dhe mbledhjen e vendimeve të formës së prerë.

### **1.1.3.8. Marrja e të dhënave kompjuterike<sup>100</sup>**

Të dhënat kompjuterike mund të merren, të kërkohen dhe të sekuestrohen.

KPP jep mundësi për ruajtjen e **përsheptuar të të dhënave të caktuara kompjuterike**, përfshirë qarkullimin e të dhënave sa herë që ka arsye të mjaftueshme për të besuar se të dhënat mund të humbasin, të dëmtohen ose të ndryshohen. Rastet që përfshijnë të dhëna kompjuterike ose qarkullim të të dhënave kërkojnë njohuri specifike dhe prokurori duhet të konsultohet me një ekspert IT ose një OPGJ që ka formim në krimin kibernetik për pyetjet në lidhje me llojin e informacionit që mund të nxirret nga të dhënat, sfidat që mund të hasen në procesin e marrjes së të dhënave dhe llojin e analizave shtesë që do të nevojiten në lidhje me të dhënat kompjuterike. Prokurori duhet të jetë i vetëdijshëm për të gjitha mundësitë e aksesit në distancë në të dhënat kompjuterike dhe mundësitë për veprimtari në distancë në drejtim të të dhënave. Nëse ekziston një mundësi e tillë,

<sup>100</sup> Neni 191/a, Neni 202/a paragrafi 2, Neni 208/a, Neni 299/a i KPP.



prokurori duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e tyre.<sup>101</sup>

**Marrja e të dhënave kompjuterike** rregullohet në KPP duke iu referuar specifikisht çështjeve penale që lidhen me IT në të cilat lind nevoja për nxjerrjen ose trajtimin e të dhënave kompjuterike të ruajtura në një sistem kompjuterik ose në një mjet tjetër të ruajtjes. Gjithashtu, mund të kërkohet nxjerrja e informacionit mbi pajtimtarët dhe shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve.

Për të marrë të dhëna kompjuterike dhe të dhëna të ofruesve të shërbimeve, prokurori paraqet një kërkesë në gjykatë. Në kërkesë, prokurori duhet të përmendë personin fizik ose juridik që mban ose mbikëqyr të dhënat kompjuterike, detajet e kontaktit dhe vendndodhjen, llojin, volumin ose përmbajtjen e të dhënave kompjuterike të kërkuara, mënyrën si do të dorëzohen të dhënat e kërkuara, kujt do t'i dorëzohen të dhënat dhe afatin e fundit për dorëzimin e tyre. Gjatë marrjes së të dhënave nga ofruesit e shërbimeve, prokurori duhet të ketë parasysh se kuadri ligjor mund të parashikojë afate brenda të cilave ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të mbajnë të dhënat.<sup>102</sup>

Kur ka arsye të bazuara për të dalë në përfundimin se vonesat mund të dëmtojnë seriozisht hetimet, prokurori merr një vendim të arsyetuar që urdhëron nxjerrjen e të dhënave kompjuterike dhe menjëherë njofton gjykatën, e cila më pas vlerëson vendimin e prokurorit.

Kur bëhet fjalë për kontrollet dhe sekuestrimet e të dhënave kompjuterike, organet proceduese kanë më shumë mundësi. Ato mund të kontrollojnë sistemet kompjuterike, të marrin të dhëna nga sistemi kompjuterik, të kryejnë aktivitete që do të parandalojnë modifikime të mëtejshme, etj. Në rastet kur prokurori dyshon se të dhënat kompjuterike mund të fshihen, të modifikohen ose të shkatërrohen, kontrolli ose sekuestrimi është zgjedhja e duhur për veprimin hetimor.

KPP rregullon gjithashtu **kontrollin e sistemeve informatike ose telematike**, me qëllim marrjen e të dhënave, informacionit, programeve informatike ose gjurmëve të tyre që janë në një sistem informatik ose telematik dhe që janë provë materiale e veprës penale ose kanë lidhje me veprën penale.

101 Për shembull, ruajtja e postës elektronike mund të kërkohet nga ofruesit e shërbimit.

102 Neni 101 i ligjit nr. 9918/2008 për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë parashikon që sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe të administrojnë, për një afat 2-vjeçar, skedarët e të dhënave për pajtimtarët e tyre.

Ka shumë sfida në lidhje me kontrollin e të dhënave kompjuterike. Njëri prej tyre është kontrolli i llogarive *cloud* të përdorura nga i dyshuari. Normalisht, kjo nënkupton që duhet të bëhet planifikim strategjik i kontrollit të ambienteve të të dyshuarit. Gjithashtu, prokurori duhet të marrë parasysh rutinën e punës së të dyshuarit dhe mundësinë e gjetjes së kompjuterëve të hapur ose laptopëve të lidhur me internetin gjatë kontrollit të ambienteve, që bëjnë të mundur mbledhjen e të dhënave nga OPGJ në momentin kur i dyshuari ka akses të hapur në llogaritë *cloud*. Kështu, përveç kërkesës për kontrollin e ambienteve, prokurori duhet në të njëjtën kohë të kërkojë kontrollin e sistemit informatik të përdorur nga i dyshuari.<sup>103</sup>

Kontrolli i sistemeve informatike ose telematike kryhet në bazë të një urdhri kontrolli të lëshuar nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Kërkesa duhet të përmbajë llojin e kontrollit që kërkohet, vendndodhjen e sistemeve informatike ose telematike për t'u kontrolluar, arsyet për lejimin e kontrollit, prova ose sende që pritet të gjenden, mënyrën se si do të kryhet kontrolli dhe nga kush. Prokurori duhet të propozojë masat e duhura teknike, të cilat sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë modifikimin e tyre.

Në rastet e *flagrancës* ose ndjekjes së një personi në arrati ose kur duhet të ekzekutohet një urdhër ndalimi, vendim arrestimi ose dënimi me burg, policia gjyqësore do të marrë të gjitha masat teknike që synojnë të sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike dhe parandalimin e humbjes, dëmtimit, dhe ndryshimit të tyre dhe do të kryejë të gjitha kontrollet e mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se ato përmbajnë informacion, programe kompjuterike ose gjurmë të veprës penale. Në këtë rast, policia gjyqësore duhet t'i dërgojë menjëherë prokurorit procesverbalin e veprimeve të kryera, me detaje për vendin ku u krye kontrolli dhe arsyet përkatëse për të. Në këtë rast, prokurori duhet të vlerësojë me kujdes procesverbalin dhe të vleftësojë veprimet me vendim të arsyetuar nëse plotësohen parakushtet.

Kur kryen kontrollin e sistemeve informatike ose telematike, prokurori duhet të ketë parasysh skedarë regjistrimi dhe metadat që krijojnë sistemet. Këta skedarë regjistrimi ose metadata mund të japin informacione shumë të dobishme, p.sh. kush ka hyrë në sistem, kur, sa kohë ka qenë i regjistruar përdoruesi, çfarë ka ndodhur në sistem gjatë kohës që përdoruesi ka qenë i regjistruar, etj.

---

<sup>103</sup> Gjatë kontrollit, OPGJ duhet të kërkojë gjithmonë për shënime që mund të mbajnë emrin e përdoruesit dhe fjalëkalime për llogaritë *cloud* ose të tjera që ka përdorur personi, banesa ose ambientet e të cilit janë objekt kontrolli.

**Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ose sistemeve** mund të bëhet në rastet e procedimeve kundër krimeve në lidhje me teknologjinë e informacionit. Kërkesa e prokurorit në gjykatë duhet të përmbajë kërkesën për vendosjen e së drejtës për akses si edhe kërkesën për kontrollin dhe marrjen e të dhënave kompjuterike nga sistemi kompjuterik si edhe ndalimin për të kryer veprime të mëtejshme ose për sigurimin e të dhënave kompjuterike ose të sistemit.

Gjatë ekzekutimit të vendimit të gjykatës për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike ose sistemeve, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar nga prokurori miraton një sërë masash të përshkruara në kod, përfshirë thirrjen e një eksperti që është kompetent në fushën e sistemeve kompjuterike ose mbrojtjen e të dhënave kompjuterike.

Duke pasur parasysh tendencën në rritje të përdorimit të teknologjive të informacionit për qëllime krimi, këshillohet që prokurorët të ndjekin një qasje më të gjerë të asaj që konsiderohet krim i lidhur me IT ose krime në lidhje me teknologjinë e informacionit. Për shembull, rastet kur krimi në vetvete nuk ka të bëjë me IT ose kompjuterët, por është i lidhur me keqpërdorimin e sistemeve informatike me qëllim lehtësimin dhe mundësimin e krimit ose kur prova materiale ndodhen në kompjuterë ose sisteme të tjera informatike, duhet të konsiderohen si çështje krimi të lidhura me teknologjinë e informacionit.

### **1.1.3.9. Verifikimet e ngutshme në vend<sup>104</sup>**

Verifikimi i ngutshëm në vend është zakonisht veprimi i parë hetimor që ndërmarrin oficerët e policisë kur është kryer një krim dhe kur duhet të verifikohet ekzistenca e fakteve në bazë të vëzhgimeve të menjëhershme. Prokurori mund të vendosë të marrë pjesë personalisht në verifikimet e ngutshme në vend. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që vendngjarja dhe sendet të mos ndryshojnë. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme.

Nëse policia gjyqësore sekuestron provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, duhet të ushtrohet vigjilencë e veçantë në mënyrë që - brenda afateve strikte të përcaktuara nga ligji - policia të informojë

<sup>104</sup> Neni 300 -302 i KPP.

prokurorin (jo më vonë se dyzet e tetë orë) dhe ky i fundit të vleftësojë sekuestrimin me vendim të arsyetuar, nëse ekzistojnë kushtet, ose të vendosë kthimin e sendeve të sekuestruara (në dyzet e tetë orët e ardhshme).

Siç u përmend më lart, pjesëmarrja e prokurorit në verifikimin në vend nuk është e detyrueshme dhe në shumicën e rasteve nuk është e nevojshme. Kështu, prokurorët duhet të vendosin se në cilat verifikime të ngutshme në vend do të marrin pjesë në varësi të seriozitetit të krimit të kallëzuar, personave të përfshirë, mallrave të prekura dhe numrit të viktimave. Rekomandohet që prokurorët të marrin pjesë në verifikime të ngutshme në vend (i) sa herë që ka ndodhur një pasojë fatale, (ii) sa herë që ka ndodhur dëmtim i pronës në shkallë të gjerë, (iii) në rastet kur është shkatërruar një objekt me rëndësi të madhe për ekonominë ose jetën, (iv) në raste shpërthimesh, zjarri, përmbytjesh ose veprimesh të tjera përgjithësisht të rrezikshme me pasoja të rënda, (v) në rastet e aksidenteve të rënda të qarkullimit, aksidenteve ajrore ose hekurudhore që kanë rezultuar me viktima ose një numër të madh të personave të plagosur rëndë (vi) në rastet e aksidenteve të rënda të trafikut që përfshijnë një automjet të një misioni diplomatik ose konsullor, automjet policie ose automjet ushtrie, (vii) në rastet e veprave të rënda penale që përfshijnë një zyrtar, nëpunës shteti, përfaqësues të huaj diplomatik ose konsullor ose një personalitet të medias, (viii) në rastet që ka shumë të ngjarë të nxisin interes të madh publik dhe në (ix) të gjitha rastet e tjera që prokurori do të vlerësojë se prania e tij / saj gjatë verifikimeve të ngutshme në terren është e nevojshme.

Nëse prokurori vendos të marrë pjesë në verifikimet e ngutshme në terren, ai / ajo duhet të vendosë se cilët persona duhet të jenë të pranishëm dhe cilat do të jenë rolet e tyre. Prokurori mund të urdhërojë njërin prej OPGJ-ve që të marrë rolin drejtues në verifikimet e ngutshme në vend dhe ky person do të jetë përgjegjës për menaxhimin e procesit. Gjithashtu, prokurori mund të caktojë një OPGJ që të mbajë procesverbale për veprimtarinë, mund të urdhërojë mbulimin me video ose foto të procesit, mund të vendosë të përfshijë një ekspert që mund të ndihmojë në verifikimet e ngutshme në vend, etj. Roli i prokurorit do të jetë kryesisht për të vëzhguar dhe drejtuar procesin, për të dhënë sugjerime në lidhje me veprimet që duhet të ndërmerren dhe për të dhënë këshilla ligjore në rastet kur është e nevojshme.<sup>105</sup>

105 Kur merr pjesë në verifikimet e ngutshme në vend, oficeri përgjegjës duhet:

- të kujdeset që të mos ndryshojnë ose të rivendosen kushtet e mjedisit me qëllim që të mos humbasin gjurmët e autorit dhe të vetë krimit;
- të sigurohet që ajo që shihet në vendngjarje të shënohet dhe të përshkruhet me saktësi;

KPP përshkruan detyrimin për të mbajtur procesverbale për verifikimet e ngutshme në vend (inspektimet), por nuk përshkruan përmbajtjen e procesverbaleve. Procesverbali duhet të pasqyrojë të gjitha faktet përkatëse në lidhje me këtë veprim hetimor. Prandaj, këshillohet që procesverbali të përmbajë të paktën informacionin vijues:

- Informacion për emrin e organit shtetëror që kryen inspektimin, vendin ku kryhet veprimi, ditën dhe orën kur ka filluar dhe përfunduar veprimi, emrat dhe mbiemrat e personave të pranishëm dhe në çfarë cilësie janë të pranishëm dhe ngjarjen në bazë të së cilës ndërmerret veprimi;
- Të dhënat thelbësore për rrjedhën dhe përmbajtjen e veprimeve që janë ndërmarrë, duke përfshirë detajet në lidhje me sekuestrimin e sendeve ose regjistrave, duhet t'u bashkëngjiten procesverbaleve ose duhet të jepet informacioni për vendin ku ato ruhen;
- Të dhënat që janë të rëndësishme duke pasur parasysh natyrën e veprimit që është ndërmarrë ose që janë të rëndësishme për përcaktimin e vërtetësisë së objekteve të veçanta (përshkrimi, masa dhe madhësia e objekteve ose gjurmëve, shënimi në objekte, etj.) duhet të shënohen në procesverbal. Dhe nëse janë bërë skica, vizatime, plane, fotografi, shënime në pajisje elektronike, mekanike ose pajisje të tjera për regjistrim audio ose audiovizual dhe shënime me dorë, kjo gjithashtu duhet të shënohet në procesverbal dhe materialet mbështetëse duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.

Në varësi të ngjarjes, procesverbali duhet të ketë gjithashtu një informacion narrativ për sa vijon:

- data dhe ora kur policia u informua fillimisht dhe mbërriti në vendin e ngjarjes, data dhe ora kur prokurori u informua dhe nëse prokurori vendosi të marrë pjesë në verifikimin e ngutshëm në vend, data dhe ora e mbërritjes së prokurorit, si dhe data dhe ora e përfundimit të

- 
- të sigurohet që në fillim të vërehen dhe të përshkruhen karakteristikat e përgjithshme të mjedisit, paštaj veçoritë e mjedisit, paštaj karakteristikat e përgjithshme të përmbajtjes dhe karakteristikat specifike të përmbajtjes;
  - të sigurohet që vendi, pozicioni, drejtimi, forma, ngjyra, përmasat dhe karakteristikat fizike të çdo sendi të vëzhguar të përshkruhen qartë;
  - të sigurohet që ambienti dhe kushtet klimatike që kanë qenë në kohën e inspektimit të mbahen shënim dhe të përshkruhen dhe
  - të sigurohet që veprimet e ndërmarra të mundësojnë ruajtjen e duhur të të gjitha gjurmëve dhe objekteve në mënyrë të tillë që të mos dëmtohen ose prishen.

Për listën e përmendur më sipër, shihni Rulebook on performing police tasks - Fletore zyrtare e Maqedonisë së Veriut 114/06, 6/09, 145/12, 41/14 dhe 117/14.

inspektimit;

- ⊙ vendndodhja e ngjarjes, distanca nga pikat e referimit (të tilla si ura, mbikalimi, pikë karburanti, dyqan, shtyllë elektrike dhe shtyllë tjetër, etj.), pozicioni (veri, lindje, perëndim, jugperëndim, etj.), drejtimi dhe të dhëna të tjera për konkretizimin e vendngjarjes duhet të evidentohen;
- ⊙ referimi fillestar nga oficerët përgjegjës të policisë dhe informacioni që ata kanë mbledhur në vendngjarje nga persona me interes;
- ⊙ masat që kanë qenë në fuqi për sigurinë, masat e sigurimit, dhe sigurimi i provave dhe sigurimi i vendngjarjes;
- ⊙ të dhënat për identifikimin e të gjithë individëve të pranishëm në vendngjarje (i dyshuari, viktimja, dëshmitari, oficeri i policisë) dhe informacion nëse i dyshuari dhe dëshmitari janë të veçuar ose mund të komunikojnë lirisht;
- ⊙ informacion nëse ofrohet ndihma mjekësore;
- ⊙ informacion për pikat e hyrjes/daljes në vendngjarje, kushtet e ndriçimit, kushtet klimatike dhe temperaturën e ambientit në vendngjarje;
- ⊙ informacion në lidhje me pozicionin e viktimës, dhe nëse viktimja ose i dyshuari është zhvendosur, informacioni se ku ishin, ku janë transferuar dhe për cilat arsye janë zhvendosur, duhet të përfshihet;
- ⊙ përshkrimi i viktimës;
- ⊙ informacion për veprimet e ndërmarra, të tilla si fotografimi, regjistrimi, skicat, provat e mbledhura, kampionët e marrë;
- ⊙ shënimin se ku ndodhet secila pjesë, secila provë, ku janë marrë kampionët e gjakut, flokët e trupit, flokët, gjurmët e gishtave, veshjet, armët e gjetura, plumbat, gëzhojat e plumbave, bishtat e cigareve, dhe dhe prova të tjera;
- ⊙ mënyra e ruajtjes së gjurmëve të marra të cilat mund të shërbejnë si prova (paketimi, transporti dhe magazinimi);
- ⊙ kërkesat e paraqitura dhe kërkimi i kryer shkencor, testet, diagramet, deklaratimet e marra;
- ⊙ identifikimi i saktë i provave, duke shënuar sendet që mungojnë dhe vendet nga janë marrë, emrin e markës, markën, ngjyrën dhe

modelin e sendit, numrin serial të sendit, shenjat karakteristike, gërvishtjet dhe shenjat e tjera për individualizimin e objektit, vlerën e objektit, gjendjen e objektit;

- dëmtimet e viktimit ose të të dyshuarit dhe të dhëna të tjera në varësi të ngjarjes specifike.

Nëse prokurori merr pjesë në verifikimet e ngutshme në vend, këshillohet që ai/ajo të mbajë shënime për rrethanat më të rëndësishme. Pas marrjes së procesverbalit nga OPGJ, prokurori mund të kërkojë korrigjimin e fakteve ose rrethanave që ndryshojnë nga ato që ka shënuar prokurori.

Gjatë verifikimeve të ngutshme në vend, prokurori mund të urdhërojë policinë të ndërmarrë veprime të tjera hetimore si këqyrja e personave ose vendeve, mbledhja e informacionit nga dëshmitarët, kryerja e kontrollit personal dhe në banesë, kryerja e njohjeve, sekuestrimeve, etj., në varësi të situatës faktike dhe mundësive në rastin konkret.

### **1.1.3.10. Këqyrjet<sup>106</sup>**

Prokurori mund të urdhërojë këqyrjen e personave, vendeve dhe sendeve kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të një veprë penale. Këqyrjet si veprim hetimor zakonisht kryhen në fazat më të hershme të hetimit, menjëherë pasi të ketë informacion që ka ndodhur një krim, por gjurmët dhe pasojat materiale të veprës penale nuk janë zbuluar ende plotësisht. Sigurisht, këqyrjet mund të urdhërohen në çdo fazë të hetimit nëse është nevoja.

Prokurori mund të urdhërojë këqyrjen e personave, këqyrjen e kufomave dhe këqyrjen e vendeve dhe sendeve.

Bëhen dy lloj këqyrjesh kryesore të personave: këqyrja e përgjithshme e personit dhe këqyrja kur nevojitet marrja e kampionëve biologjikë ose kryerja e procedurës mjekësore.

Kur urdhëron këqyrjen e personave, prokurori duhet të marrë parasysh nëse personi që do të këqyret ka dhënë pëlqimin, sepse zbatohen kërkesa të ndryshme procedurale. Nëse një person që duhet të këqyret jep pëlqimin, atëherë këqyrja bëhet në bazë të vendimit të një prokurori. Sidoqoftë, nëse personi nuk jep pëlqimin për këqyrjen, atëherë prokurori duhet të paraqesë një kërkesë në gjykatë për kryerjen e këqyrjes së personit. Të njëjtat rregulla zbatohen në rastet kur nevojitet marrja e kampionëve

106 Nenet 198 -201/b e KPP.



biologjikë ose kryerja e një procedure mjekësore. Prokurori duhet të dërgojë një kërkesë në gjykatë për nxjerrjen e një urdhri gjyqësor për marrjen e kampionëve biologjikë ose kryerjen e një procedure mjekësore kur një person refuzon të japë pëlqimin e tij. Nëse personi jep pëlqimin, atëherë prokurori mund të kërkojë marrjen e kampionëve biologjikë me qëllim krijimin e profilit të ADN-së ose kryerjen e një procedure mjekësore.<sup>107</sup> Prokurori duhet të sigurohet që pëlqimi të jepet me shkrim.<sup>108</sup> Prokurorët duhet gjithashtu të japin udhëzime në mënyrë që këqyrja të kryhet në një vend të duhur, duke respektuar dinjitetin personal dhe integritetin e personit që këqyret.

Këqyrja e kufomave, si dhe zhvarrosja mund të urdhërohen nga prokurori. Kur prokurori urdhëron këqyrjen e kufomave, prokurori duhet në të njëjtën kohë të caktojë një mjek që do të kryejë këqyrjen.

Këqyrja e vendeve dhe sendeve mund të bëhet bazuar në vendimin e prokurorit që duhet t'i jepet të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në zotërim vendin ku do të kryhet këqyrja ose sendin që do të këqyret.

Në rastet kur vepra penale nuk ka lënë gjurmë ose pasoja materiale ose kur ato janë shkatërruar, kanë humbur, kanë ndryshuar ose janë zhvendosur, prokurori mund të urdhërojë policinë gjyqësore të përshkruajë gjendjen e tyre dhe, kur është e mundur, të verifikojë gjendjen në të cilën ishin para ndryshimeve, dhe gjithashtu të marrin masa për të përcaktuar metodën, orën dhe shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur. Prokurori mund të urdhërojë fotografimin ose regjistrimin me video ose çdo veprim tjetër teknik për të dokumentuar procesin e këqyrjes.

### **1.1.3.11. Kontrollët<sup>109</sup>**

Kontrollët kryhen kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se dikush fsheh provat materiale të veprës penale ose sendet që i përkasin veprës penale.

---

<sup>107</sup> Për shembull nëse një kampion biologjik për ADN duhet të merret nga një person që refuzon të japë pëlqimin, atëherë prokurori duhet t'i dërgojë kërkesë gjykatës që të nxjerrë një urdhër për marrjen e kampionit biologjik. Të njëjta rregulla vlejnë për rastin kur nevojitet një procedurë mjekësore (për shembull nxjerrja nga stomaku i një personi i paketimeve të dyshuara që përmbajnë drogë). Nëse personi jep pëlqimin, nuk ka nevojë për urdhër gjykate dhe këqyrja, marrja e kampionit biologjik apo kryerja e procedurës mjekësore mund të bëhen bazuar në vendimin e prokurorit.

<sup>108</sup> Neni 201/a paragrafi 3 i KPP.

<sup>109</sup> Nenet 202-207, Neni 298 i KPP.



Para kryerjes së kontrollit, prokurori ose policia gjyqësore me autorizimin e prokurorit mund të kërkojë dorëzimin. Këtu duhet të theksohet se dorëzimi duhet të kërkohej vetëm nëse është lëshuar një urdhër kontrolli: në këtë mënyrë, në rast refuzimi, urdhri i kontrollit mund të ekzekutohet menjëherë.

Kontrollet duhet të kryhen në situata ku ekzistenca e provave dyshohet, por nuk është e verifikuar, kështu që kontrolli është një mjet që do të mundësojë verifikimin e faktit nëse ekzistojnë prova dhe llojin e provave në fjalë. Në situata kur dihet se çfarë lloj prove kërkohej dhe ku ndodhen provat, marrja e kësaj prove në bazë të urdhrimit të sekuestrimit është mënyra e duhur.

Kontrollet kryhen në bazë të një urdhri kontrolli të lëshuar nga një gjykatë.<sup>110</sup> Ka dy lloje kryesore të urdhrave të kontrollit: Urdhrat e kontrollit personal që lejojnë kontrollin e personit dhe urdhra për kontrollin e vendeve ose banesave që lejojnë kontrollin e vendeve dhe banesave. Prokurori duhet të paraqesë një kërkesë në gjykatë për nxjerrjen e një urdhri kontrolli. Kërkesa e prokurorit duhet të përmbajë (i) llojin e kontrollit që kërkohej, (ii) personin që do të kontrollohet dhe të dhënat e tij / saj personale, (iii) vendndodhjen ose vendbanimin që do të kontrollohet, (iv) provat ose sendet që pritet të gjenden, (v) arsyet për lejimin e kontrollit, si edhe (vi) organin që do të kryejë kontrollin.<sup>111</sup> Sendet që pritet të gjenden gjatë kontrollit duhet të tregohen qartë, pasi shënimi i tyre në vendimin që autorizon kontrollin është një nga kushtet për sekuestrimin e tyre.

Prokurorët gjithashtu në kërkesën për lëshimin e urdhrimit të kontrollit mund të tregojnë emrat e oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar me ekzekutimin e urdhrimit.

Avokati mbrojtës i personit nën hetim ka të drejtë të marrë pjesë në kontroll, pa njoftim paraprak.

Prokurori, kur vijon me kryerjen e një kontrolli, njofton të pandehurin që të jetë i pranishëm së bashku me avokatin e tij personal. Nëse i pandehuri nuk ka avokat, prokurori cakton avokatin *ex officio*. Nëse i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës janë njoftuar siç duhet, por nuk janë të pranishëm pa ndonjë shkak të arsyeshëm, prokurori duhet të caktojë një avokat *ex officio*. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin përkatës.

<sup>110</sup> Përjashtimet rregullohen në nenin 298 të KPP.

<sup>111</sup> Ligji nuk përshkruan përmbajtjen e kërkesës së prokurorit për kontroll, por përmbajtja mund të përcaktohet në bazë të vendimit të gjykatës që autorizon kontrollin.

Para se të kryhet kontrolli, prokurori duhet t'i kërkojë OPGJ-së informacione operative për vendndodhjen dhe personin që do të kontrollohet. Situatat e paparashikuara mund të ndodhin gjithmonë<sup>112</sup>, kështu që diskutimi i sfidave që mund të ndodhin gjatë kontrollit mund të kontribuojë në një rezultat më të mirë. Gjatë ekzekutimit të urdhrave të kontrollit, prokurori duhet të informohet për të gjitha dilemat që ka OPGJ për mënyrën e veprimit gjatë kontrollit dhe duhet të jetë i gatshëm të japë udhëzime. Prokurori duhet të japë gjithashtu udhëzime në lidhje me sekuestrimin e llojeve të caktuara të provave të gjetura gjatë kontrollit, si blloqet me shënime dhe sende të tjera private të të pandehurit që mund të jenë të dobishme për çështjen (p.sh. bizhuteri shumë të shtrenjta, vepra arti, etj.).

Prokurori duhet të ketë parasysh që nëse nevojiten disa kontrolle në një rast (p.sh. kontrolle në shumë vende; kontrolle të shumë personave; disa lloje të ndryshme kontrollesh, etj.), atëherë këshillohet që kontrollet të bëhen njëkohësisht. Gjithashtu, disa veprime hetimore (p.sh. pyetja e dëshmitarëve, përgjimet, etj.) mund të bëhen paralelisht me kontrollet.

### 1.1.3.12. Sekuestrimet<sup>113</sup>

Sekuestrimet janë veprimtari hetimore që kanë për qëllim ruajtjen e provave materiale dhe sendeve në lidhje me veprën penale, kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Që të bëhet sekuestrimi, duhet të dihen sendet dhe vendndodhja e tyre.

KPP-ja dallon qartë situatat kur kërkohet një vendim gjyqësor nga ato kur mjafton vendimi i prokurorit, dhe bën një rregullim të hollësishëm të institutit.

Prokurori, kur vijon me kryerjen e një sekuestrimi, njofton të pandehurin të jetë i pranishëm së bashku me avokatin e tij personal. Nëse i pandehuri nuk ka avokat, prokurori cakton avokatin *ex officio*. Nëse i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës janë njoftuar siç duhet, por nuk janë të pranishëm pa ndonjë shkak të arsyeshëm, prokurori duhet të caktojë një avokat *ex officio*. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin përkatës.

Sendet që i nënshtrohen sekuestrimit duhet të regjistrohen dhe

---

112 Për shembull, vendi që do të kontrollohet mund të ruhet me qen; akses i veçantë elektronik mund të nevojitet për të hyrë në vendndodhje; personi që do të kontrollohet mund të ketë probleme mjekësore siç janë paaftësitë ose sëmundjet kronike që mund të ndikojnë te kontrolli, etj.

113 Nenet 208 – 220 e KPP

të përshkruhen siç duhet në mënyrë që të mundësohet dallimi i tyre nga sendet e tjera që mund të jenë pjesë e dosjes së çështjes. Për shembull, nëse janë sekuestruar regjistra bankarë, ata duhet të identifikohen siç duhet nga informacioni si emri i bankës, mbajtësi i regjistrave bankarë, lloji i regjistrave bankarë, periudha që mbulojnë regjistrat bankarë etj.

Duhet të theksohet se përveç sekuestrimeve sipas urdhrimit të sekuestrimit, edhe objektet e tjera të gjetura gjatë kontrolleve sekuestrohen. Prandaj, prokurori duhet të marrë masat e duhura për sistemimin e dosjeve të çështjes në mënyrë që ai/ajo të përcaktojë lehtësisht se si janë mbledhur provat. Duke ndjekur shembullin e mëparshëm, regjistrat bankarë mund të gjenden gjatë kontrollit në banesën e të pandehurit, kështu që duhet të ketë një dallim të qartë se cilat prova janë mbledhur gjatë cilit veprim hetimor.

Duke iu referuar në mënyrë specifike **sekuestrimit të korrespondencës**<sup>114</sup>, prokurori duhet të shënojë gjithashtu emrin e oficerit të policisë gjyqësore që do të jetë përgjegjës për sekuestrimin, duke përmendur detyrimin për të mos hapur ose për të mos u njohur me përmbajtjen e korrespondencës para se t'ia dorëzojë atë prokurorit.

### 1.1.3.13. Përgjimet<sup>115</sup>

Përgjimi i komunikimeve ofron informacione të rëndësishme për synimet, veprimtaritë dhe lidhjet e personave. Sidoqoftë, përgjimi i komunikimeve çënon rëndë të drejtën e privatësisë së individëve dhe duhet të përdoret si një masë e fundit për marrjen e informacionit përkatës në lidhje me veprimtaritë kriminale me rëndësi të veçantë.

Kuadri ligjor në Shqipëri njih dy lloje kryesore të përgjimeve: përgjimet e bëra për qëllim të hetimeve penale dhe përgjimet parandaluese. Përgjimet parandaluese rregullohen me një ligj të veçantë dhe rezultatet e përgjimeve parandaluese nuk mund të përdoren si prova në procedime penale.

Përgjimet gjatë një procesi penal bëhen në bazë të urdhrave të lëshuara nga gjykata ose nga prokurori. KPP përshkruan rregulla të hollësishme procedurale për llojin e përgjimeve që lejohen dhe kushtet që duhet të plotësohen për të lejuar përgjimet.

Me kërkesë të prokurorit, përgjimet autorizohen nga gjykata bazuar

114 Neni 209 i KPP

115 Nenet 221 -226 e KPP.

në një vendim të arsyetuar, për sa kohë që (i) është e domosdoshme të vazhdohet me hetimin e filluar, (ii) ekziston një dyshim i arsyeshëm kundër personit dhe (iii) është e bazuar në prova se ai/ajo ka kryer një veprë penale.

Prokurori në kërkesë duhet të specifikojë:

- ⊙ llojin e përgjimit që do të autorizohet;
- ⊙ informacionin mbështetës për të bërë të mundur përgjimin si numrat e telefonit, numrat e faksit, kompjuterët dhe vendndodhjen e një vendi privat, emrin e personit, bisedat e të cilit kërkohet të përgjohen;
- ⊙ statusin e personit ndaj të cilit kërkohen përgjimet (një i dyshuar për një veprë penale; një person i cili besohet se ka marrë ose ka transmetuar komunikime nga personi i dyshuar; një person i cili ka marrë pjesë në transaksione me të dyshuarin ose një person vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose identitetit të të dyshuarit);
- ⊙ mënyrën dhe afatin kohor për ekzekutimin e përgjimeve, të cilat nuk mund të kalojnë pesëmbëdhjetë ditë<sup>116</sup>;
- ⊙ veprën penale në fjalë;
- ⊙ shkaqet dhe provat që tregojnë ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se i dyshuari ka kryer veprën penale;
- ⊙ shkaqet që tregojnë se përgjimet janë të domosdoshme për të ndjekur hetimin e filluar.

Prokurori kur kërkon regjistrim të fshehtë fotografik ose me video ose përgjim të bisedave në vende private, mund të tregojë emrin e një oficeri të policisë gjyqësore ose të një specialisti të kualifikuar dhe të kërkojë autorizim që ata të hyjnë në fshehtësi në këto vende.

Përgjimet autorizohen drejtpërdrejt nga prokurori në dy raste.

Prokurori vendos përgjimin me akt të motivuar kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'i vijë një dëm i rëndë hetimeve, në situata ku përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një veprë penale. Sidoqoftë, në këtë rast prokurori njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit pas vleftësimit nga gjykata të vendimit të prokurorit.

---

116 Këto afate ligjore mund të shtyhen nga gjykata për një periudhë prej 15 ditësh, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, sa herë që është e nevojshme, nëse ekzistojnë kushtet për autorizimin fillestar të përgjimit dhe nëse rezultati i përgjimit tregon nevojën për të shtyrë afatin kohor.

Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

Për vepra penale të kryera me dashje, që dënohen me jo më pak se tre vjet burgim, në afatin maksimal, regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike ose përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes autorizohen nga prokurori. Në vendim, prokurori duhet të specifikojë:

- ⊙ krimin në fjalë;
- ⊙ statusin e personit ndaj të cilit autorizohen përgjimet;
- ⊙ llojin e përgjimit që autorizohet;
- ⊙ metodën dhe afatin kohor për ekzekutimin e përgjimeve;
- ⊙ shkaqet dhe provat që tregojnë ekzistimin e një dyshimi të arsyeshëm se i dyshuari ka kryer veprën penale, dhe
- ⊙ shkaqet që tregojnë se përgjimet janë të domosdoshme për të vazhduar me hetimin e filluar.

Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësitë teknike që ekzistojnë për kryerjen e përgjimeve. Nëse, për shembull, nuk ka mundësi teknike për të përgjuar komunikimet e bëra me anë të një kompjuteri, atëherë prokurori duhet të konsiderojë forma të tjera të përgjimeve nëse ka. Gjithashtu, në mënyrë që të vendosë se cilën formë të përgjimit do të urdhërojë, prokurori duhet të ketë dijeni për rezultatit e pritshëm. Rezultati i përgjimit të komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni, me anë të telefonit, faksit, kompjuterit ose ndonjë mjeti tjetër është përmbajtja e bisedave të zhvilluara personalisht ose përmes numrit të telefonit që është në përgjim, si edhe metadata të krijuara nga secili komunikim (data, ora, kohëzgjatja e thirrjes dhe vendndodhja).

Rezultatet e përgjimit të fshehtë të bisedave me anë të mjeteve teknike në një vend privat janë zakonisht skedarë audio që përmbajnë të gjithë tingujt, përfshirë bisedat që kanë ndodhur në vendin privat në fjalë. Rezultatet e përgjimit audio dhe video në vende private janë skedarët video të shoqëruara me skedarët audio që përfaqësojnë një regjistrim të ngjarjeve që kanë ndodhur në vendet private në fjalë. Rezultati i regjistrimit të numrave të thirrjeve hyrëse dhe dalëse është vetëm një listë e numrave të telefonit që kanë komunikuar me personin ose numrave të telefonit në përgjim, pa përfshirë përmbajtjen e bisedave. Rezultati i regjistrimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video të personave në vende publike është

regjistrimi video dhe audio i ngjarjeve që kanë ndodhur në vende publike.

Rezultati i përgjimeve nuk mund të përdoret kur ato ndodhin përtej rrethanave të parashikuara nga ligji ose nëse nuk përmbushen kërkesat procedurale.

### **1.1.3.14. Veprime simuluese<sup>117</sup>**

Ky veprim hetimor synon të japë prova në lidhje me përfshirjen e personave të caktuar në aktivitete kriminale dhe mund të çojë në zbulimin e provave materiale dhe sendeve të tjera që lidhen me veprën penale.

Këto veprime kryhen me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit. Para se të autorizojë këto veprime, prokurori duhet të thërrasë një takim koordinues me OPGJ për të diskutuar planin e aktiviteteve, vendin ku planifikohen fillimisht aktivitetet dhe personat e përfshirë në aktivitete, përfshirë oficerët e policisë nga policia e shtetit që mund të ofrojnë mbështetje operationale (p.sh. rregullimi i qarkullimit rrugor dhe qarkullimi i njerëzve në vendin ku duhet të zhvillohet aktiviteti), protokollet e komunikimit, përcaktimin e skenarëve alternativë për veprim, qarkullimin e informacionit si edhe përmbajtjen e relacionit shpjegues që prokurori pret të marrë. Prokurori duhet të theksojë kërkesat procedurale dhe caqet e veprimeve të policisë që veprimtaria të jetë ligjërishit e vlefshme, dhe shmangien e rrezikut të nxitjes së një personi për të kryer një krim, të cilin ai/ajo nuk do ta kishte kryer, nëse policia nuk do të kishte ndërhyrë.

Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i paraqesë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një relacion përmbledhës. Relacioni përmbledhës duhet të përmbajë të gjithë informacionin përkatës për rastin.

### **1.1.3.15. Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal<sup>118</sup>**

Një tjetër veprim i fshehtë hetimor që policia gjyqësore mund të ndërmarrë nën drejtimin dhe me autorizimin e prokurorit është infiltrimi në grupe kriminale. Ky veprim hetimor është një nga më të rrezikshmit dhe duhet të përdoret vetëm në situata kur nuk ka mjete të tjera për shpërbërjen e grupit kriminal dhe hetimin e krimeve.

117 Neni 294/a i KPP.

118 Neni 294/b i KPP.

Qëllimi i këtij veprimi hetimor është zbulimi i anëtarëve të grupit kriminal dhe *modus operandi* të grupit dhe mund të çojë në zbulimin e një sasive të madhe të provave materiale dhe sendeve të lidhura me krimin.

Prokurori dhe OPGJ duhet të bien dakord për protokollet e sigurisë gjatë veprimtarisë, si edhe për një plan të përgjithshëm të veprimeve dhe periudhën kohore fillestare të infiltrimit. Gjithashtu, ata duhet të diskutojnë mbi veprimet dhe skenarët alternativë për veprimet në situata krizash (p.sh.: si të reagojnë nëse ekspozohet identiteti i OPGJ, nëse do të lejohet OPGJ t'i japë grupit kriminal ndonjë informacion të parëndësishëm në lidhje me hetimin dhe të luajë rolin e agjentit të dyfishtë, etj.), llojin e veprimtarisë së paligjshme që mund të duhet të kryhet nga OPGJ gjatë aktivitetit, si dhe qarkullimin e informacionit dhe mënyrën, shpeshtësinë dhe formën në të cilën prokurori do të informohet gjatë veprimtarisë.

Prokurori duhet gjithashtu t'i tregojë OPGJ-ve kërkesat procedurale dhe kufijtë e veprimeve të tyre në mënyrë që veprimtaria të jetë ligjërishit e vlefshëm duke shpjeguar që oficeri i policisë gjyqësore i infiltruar nuk duhet të provokojë një vepër penale që përndryshe nuk do të ishte kryer pa ndërhyrjen e tij/saj.

Edhe pse KPP nuk e rregullon këtë aspekt specifik, në rastet e riskut të shtuar për sigurinë dhe jetën e OPGJ-së, pas marrjes së këtij informacioni dhe pasi të sigurohet që OPGJ i infiltruar është në një vend të sigurt, prokurori duhet të vendosë nëse do të përfundojë infiltrimin para mbarimit të periudhës kohore të specifikuar në vendimin për autorizim.

Oficeri i infiltruar i policisë gjyqësore mund të merret në pyetje si dëshmitar. Nëse dëshmia e marrë nga persona të infiltruar është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, dëshmia merret duke respektuar rregullat për ruajtjen e anonimatit të informatorit. Kur këta të fundit nuk thirren si dëshmitarë, informacioni që ata japin, nuk mund të përdoret.

Duhet të theksohet se ky veprim i fshehtë mund të kombinohet me veprime të tjera hetimore si përgjimet audio dhe video në vende private, ku prokurori mund të caktojë OPGJ-në e infiltruar që të kryejë dhe të regjistrojë përgjimin. Kërkesat procedurale për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore duhet të plotësohen në çdo rast, pavarësisht nga fakti që ato do të kryhen së bashku me infiltrimin.

### **1.1.3.16. Dorëzimi i kontrolluar<sup>119</sup>**

Dorëzimi i kontrolluar autorizohet nga prokurori që drejton hetimet paraprake, me kërkesë të autoriteteve kompetente. Prandaj, që prokurori të autorizojë dorëzimin e kontrolluar, duhet të jetë bërë informacion dhe kërkesë me shkrim nga autoritetet kompetente (policia e shtetit, doganat, autoritetet e huaja).

Prokurori vendos kushtet për dorëzimin e kontrolluar dhe nxjerr një akt të motivuar që autorizon dhe urdhëron dorëzimin e kontrolluar, që duhet të tregojë emrin e të dyshuarit ose të të pandehurit, nëse dihet, provat që vërtetojnë natyrën e paligjshme të sendeve që duhet të hyjnë, të kalojnë tranzit ose të nxirren nga territori i shtetit dhe mënyrën se si do të kryhet kontrolli ose mbikëqyrja e tyre. Gjithashtu, rekomandohet që urdhri i prokurorit të tregojë bazën ligjore për autorizimin e dorëzimit të kontrolluar. Kur është e përshtatshme, urdhri i prokurorit do t'i bashkëngjitet aktit që autorizon zëvendësimin e plotë ose të pjesshëm të sendeve të paligjshme dhe vendin ku ndodhen kampionët e marrë.

Dorëzimi i kontrolluar ekzekutohet nga policia gjyqësore, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit.

## **1.2. Zhvillimi i mëtejshëm i hetimit**

Pasi të jenë kryer veprimet fillestare hetimore, prokurori duhet së pari të analizojë informacionin dhe provat në mënyrë që të përcaktojë rëndësinë e tyre për hetimin dhe të vendosë nëse nevojiten veprime hetimore shtesë. Prokurori duhet të vlerësojë vazhdimisht provat dhe inteligjencën për të përcaktuar ndikimin e tyre në hetim dhe për të planifikuar veprimet e ardhshme hetimore. Planifikimi shtesë në hetim është i nevojshëm (i) kur ndodhin zhvillime të reja të paparashikuara gjatë hetimit; (ii) kur veprimet hetimore nuk kanë mbuluar të gjitha aspektet e çështjes; (iii) kur shtrirja e hetimit ka rezultuar të jetë më e madhe nga sa pritej; dhe (iv) në çdo rast tjetër kur ka nevojë për të kontrolluar rrethana të caktuara, për të verifikuar informacione të caktuara ose për të mbledhur prova të caktuara.

Paragrafët në vijim analizojnë disa nga mjetet në dispozicion të prokurorëve për të arritur qëllimet e përmendura.

---

119 Neni 294/c i KPP.



### 1.2.1. Angazhimi i një eksperti<sup>120</sup>

Shpesh hetimet penale kërkojnë njohuri specifike për përcaktimin e fakteve të rëndësishme dhe nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishme. Në këto raste, prokurorët kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e një eksperti. Ekspertimi lejohet kur është e nevojshme të kryhet një kërkim ose të merren informacione ose vlerësime që kërkojnë njohuri të veçanta teknike, shkencore ose kulturore.

Gjatë hetimeve, një ekspert mund të caktohet në bazë të vendimit të prokurorit ose policisë gjyqësore. Ndryshe nga veprimet e tjera hetimore, policia gjyqësore mund të caktojë një ekspert me iniciativën e saj.<sup>121</sup>

Vendimi i prokurorit ose policisë gjyqësore për ekspertim duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- ⊙ caktimin e ekspertit, dhënien e informacionit personal dhe të kontaktit të ekspertit dhe fushën e tij/saj të ekspertizës;
- ⊙ një prezantim të përmbledhur të çështjes, duke nënvizuar rrethanat mbi të cilat eksperti duhet të japë një mendim;
- ⊙ ditën, orën dhe vendin e caktuar për paraqitjen e ekspertit, dhe
- ⊙ periudhën kohore në të cilën pritet që eksperti të japë mendimin e tij/saj.

Para se të caktojë një ekspert, prokurori dhe policia gjyqësore duhet të jenë të qartë në lidhje me faktet dhe rrethanat për të cilat kërkohet ekspertiza, duhet të jenë të saktë në shtjellimin e pyetjeve për ekspertim dhe duhet të sigurohen që ekspertimi të jetë vlerë e shtuar për hetimin.

### 1.2.2. Masat e sigurimit<sup>122</sup>

Qëllimi kryesor i masave të sigurimit është të mundësojnë kryerjen efektive dhe efikase të hetimit, duke eliminuar pengesat që mund të ndikojnë në rezultatin dhe efektet e përgjithshme të hetimit. Kuadri ligjor në Shqipëri dallon dy lloje kryesore të masave të sigurimit, përkatësisht masat e sigurimit personal dhe masat e sigurimit pasuror.

Meqenëse masat e sigurimit ndikojnë në të drejtat dhe liritë e njerëzve, ato i nënshtrohen kërkesave të rrepta procedurale që prokurorët

<sup>120</sup> Nenet 178 – 186, Neni 294 paragrafi 3, Neni 314 i KPP.

<sup>121</sup> Neni 294 paragrafi 3 i KPP.

<sup>122</sup> Neni 227 et seq i KPP.

duhet të kenë gjithmonë parasysh dhe të respektojnë.<sup>123</sup>

Prokurorët, kur vendosin nëse do të kërkojnë ose zbatojnë masa sigurimi, si edhe natyrën e tyre, duhet të shmangin çdo lloj ndërhyrjeje ose ndikimi. Ndonjëherë policia arreston një person pa autorizimin e prokurorit dhe i bën presion prokurorit që të kërkoet ndalimi, edhe në rastet kur nuk ekzistojnë shkaqe për ndalim. Prokurori duhet të sigurohet që vendimi i tij/saj të bazohet vetëm në fakte dhe prova që përfshihen në fashikullin e prokurorit dhe duhet të regjistrojë çdo veprimtari të policisë që bëhet në kundërshtim me urdhrin e prokurorit.

Për më tepër, kur vendos të kërkojë apo të zbatojë masa sigurimi, prokurori nuk duhet të marrë parasysh vetëm nëse ekzistojnë kushtet për autorizimin e tyre, por edhe ndikimin - në lidhje me rezultatet e hetimit - që masat do të kenë në hetim.

**Masat e sigurimit personal** duhet të kërkoen vetëm kur ekzistojnë këto nevoja, duke pasur parasysh proporcionalitetin e masës me seriozitetin e fakteve dhe dënimin e parashikuar për veprën penale konkrete. Para se të vendosë të kërkojë dhe të zbatojë masat e sigurimit personal, prokurori duhet të jetë i vetëdijshëm për efektet që do të prodhojë çdo masë sigurimi personal dhe duhet të zgjedhë gjithmonë një masë që është më e përshtatshme për arritjen e qëllimeve të hetimit. Për shembull, nëse qëllimi kryesor i masës së sigurimit personal është risku i arratisjes, prokurori mund të kërkojë lëshimin e urdhrin për ndalimin e largimit, por në rast se i pandehuri tashmë është larguar nga vendi, prokurori duhet të kërkojë paraprakisht arrest në burg pasi vendimi i gjykatës shërben si bazë ligjore për lëshimin e një urdhër arresti ndërkombëtar.

**Masat e sigurimit pasuror** duhet të kërkoen sa herë që plotësohen kushtet ligjore. Arsyetimi për këtë është se masat e sigurimit pasuror sigurojnë që autori i krimit të mos i mbajë të ardhurat e krimit, çdo lloj tjetër pasurie që mund të konfiskohet dhe në përgjithësi sende që lidhen me veprën penale të cilat mund të përkeqësojnë ose të zgjasin pasojat e saj ose të lehtësojnë kryerjen e veprave të tjera penale. Për më tepër, rëndësia e

---

123 Për shembull, për zbatimin e masës së sigurimit personal, duhet të ekzistojnë kushtet e mëposhtme: (i) dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova, që një person ka kryer një krim; (ii) mungesa e shkaqeve të pandëshkueshmërisë ose të shuarjes së veprës penale, ose dënimin; (iii) shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; (iv) i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet dhe kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit; (v) ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

konfiskimit dhe nevoja për miratimin dhe zbatimin e masave të mëtejshme për të përmirësuar konfiskimin është nënvizuar në raportin e progresit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2019. Kështu, masat e sigurimit pasuror janë të një rëndësie të madhe dhe duhet të përdoren më shpesh. Megjithatë, duhet të theksohet se për të zbatuar masat e sigurimit pasuror, prokurori duhet së pari të zbulojë të gjitha objektet (sendet, pronat, të ardhurat, etj.) që mund t'u nënshtrohen masave të sigurimit, dhe kjo ka rezultuar si pjesa më e vështirë në hetim. Rikuperimi i aseteve mbetet një nga pikat e errëta në hetime në të gjithë botën dhe shtete të ndryshme kanë miratuar masa të ndryshme në mbështetje të rikuperimit të aseteve.<sup>124</sup>

### **1.2.3. Kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare<sup>125</sup>**

Sipas KPP të Shqipërisë, prokurori mund të kërkojë ndihmë juridike ndërkombëtare për të mbledhur prova që ndodhen jashtë vendit përmes letërporosive. Në letërporosi, prokurori duhet të tregojë shkaqet ligjore që e detyrojnë shtetin e kërkuar të veprojë. Këto shkaqe ligjore mund të gjenden në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar. Marrëveshja më e rëndësishme shumëpalëshe që ofron bazën ligjore për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe që është ratifikuar nga 50 shtete<sup>126</sup> është Konventa Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale me protokollet e saj shtesë. Jo më pak të rëndësishme janë Konventa e OKB-së kundër trafikimit të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, Konventa e OKB-së kundër korrupsionit, Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe për financimin e terrorizmit, Konventa e Këshillit të Europës e të Drejtës Penale për korrupsionin, Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin e terrorizmit, etj.

124 Krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve është një mënyrë efektive për të gjurmuar asetet, sepse mundëson komunikim më të mirë ndërmjet autoriteteve të vendeve të ndryshme, ofron mënyrë të centralizuar në gjurmimin e aseteve dhe rikuperimin e aseteve dhe të dhëna të centralizuara, ofron njohuri të specializuara, etj.

125 Neni 509 et seq i KPP.

126 [https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/030/signatures?p\\_auth=DIRsD5IS](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/030/signatures?p_auth=DIRsD5IS)

Letërporosia e prokurorit duhet të përmbajë sa më poshtë:

- ⊙ emri i autoritetit lëshues (emri i prokurorisë);
- ⊙ data dhe vendi i lëshimit të letërporosisë;
- ⊙ numri i protokollit të çështjes;
- ⊙ emri i shtetit nga kërkohen provat;
- ⊙ baza ligjore për kërkimin e ndihmës juridike;
- ⊙ përshkrim i shkurtër i fakteve të çështjes, duke dhënë informacion të mjaftueshëm që do të sigurojë autoritetet e huaja se ekziston një nivel i caktuar dyshimi i arsyeshëm në lidhje me ekzistencën e një krimi dhe përfshirjen e personave të dyshuar dhe që mund t'iu mundësojë atyre kryerjen e veprimtarive të kërkuara. Përshkrimi i shkurtër i fakteve të çështjes duhet të përmbajë përshkrimin e ngjarjeve që kanë ndodhur dhe përshkrimin e fakteve që burojnë nga provat, personat e përfshirë dhe lidhjen e tyre me krimin ose personat e dyshuar dhe të gjitha detajet e tjera që prokurori konsideron të nevojshme të përfshihen në letërporosi;
- ⊙ një cilësim juridik të krimit në fjalë dhe një kopje të dispozitave ligjore të Kodit Penal të Shqipërisë që zbatohen për krimin në fjalë dhe që mbështesin cilësimin juridik të krimit;
- ⊙ qëllimin kryesor të letërporosisë: kërkesë për kryerjen e veprimeve specifike hetimore ose kërkesë për mbledhjen e llojit specifik të provave, duke specifikuar saktësisht llojin e provës që kërkohet të merret ose veprimet hetimore që prokurori kërkon të kryhen (p.sh.: marrja në pyetje e personave, kryerja e kontrolleve, konfiskimi i produkteve të veprës penale<sup>127</sup>, etj.);
- ⊙ kërkesa për plotësimin e kushteve të veçanta në lidhje me disa kërkesa procedurale sipas legjislacionit shqiptar (p.sh.: kërkesë e veçantë që nëse marrja në pyetje e të pandehurit kryhet nga policia, të sigurohet prania e detyrueshme e avokatit mbrojtës<sup>128</sup>);
- ⊙ informacion shtesë që mund të jetë me rëndësi (p.sh. kërkesa për të trajtuar letërporosinë me urgjencë, duke përmendur arsyet e

---

127 Në dispozicion të publikut ka manuale për mënyrën e të kërkuarit të ndihmës ndërkombëtare juridike për qëllim të konfiskimit të produkteve të krimit: shihni për shembull [https://www.unodc.org/res/cld/bibliography/manual-on-international-cooperation-for-the-purposes-of-confiscation-of-proceeds-of-crime\\_html/Confiscation\\_Manual\\_Ebook\\_E.pdf](https://www.unodc.org/res/cld/bibliography/manual-on-international-cooperation-for-the-purposes-of-confiscation-of-proceeds-of-crime_html/Confiscation_Manual_Ebook_E.pdf)

128 Neni 296 paragrafi 1 i KPP.

urgjencës - çështje paraburgimi, afati i parashkrimit, etj.; kërkesa për të trajtuar letër porosinë me fshehtësi, etj.);

- ⊙ emri i prokurorit përgjegjës dhe të dhënat e kontaktit.

Letërporosia u drejtohet autoriteteve kompetente të huaja dhe i dërgohet Ministrit të Drejtësisë së Shqipërisë, e cila merr masat për dërgimin e letërporosisë në prokurori. Në raste urgjence, organi procedues mund të urdhërojë dërgimin e drejtpërdrejtë të letërporosisë, duke njoftuar Ministrinë e Drejtësisë.<sup>129</sup>

Prokurori duhet të ketë parasysh se procedura për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare mund të jetë e gjatë, në varësi të qëllimit të kërkesës dhe disponueshmërisë dhe gatishmërisë së autoriteteve të huaja kompetente për t'u përgjigjur. Kështu, prokurorët duhet të marrin masa për të përshpejtuar procedurën. Shqipëria ka pikat e saj të kontaktit në Rrjetin Gjyqësor Europian në çështjet penale dhe EUROJUST. Rrjeti Gjyqësor Europian në çështjet penale (EJN) është rrjeti i pikave kombëtare të kontaktit për lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, ndërsa EUROJUST është Agjencia e Bashkimit Europian për Bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë Penale që ka marrëveshje bashkëpunimi me Shqipërinë. Prokurori që ka dërguar letërporosinë në Ministrinë e Drejtësisë, por që akoma nuk ka marrë ndonjë informacion për ekzekutimin e saj mund t'u drejtohet pikave të kontaktit që Shqipëria ka në EJN dhe EUROJUST dhe të kërkojë informacione në lidhje me statusin e ekzekutimit të letërporosisë. Meqenëse pika e kontaktit mund të vendosë kontakte të drejtpërdrejta me autoritetet e huaja kompetente, përshpejtohet procedura për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare.

### **1.3. Mbyllja e hetimit**

Pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të jenë mbledhur të gjitha provat e nevojshme dhe të disponueshme dhe të jenë sqaruar të gjitha rrethanat përkatëse, prokurori duhet të organizojë dhe të planifikojë një sistem për shqyrtimin e materialit dhe provave të mbledhura dhe të zgjedhë metodat dhe proceset e shqyrtimit. Prokurori duhet gjithashtu

<sup>129</sup> Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera duhet të merren parasysh gjithashtu. Marrëveshja dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje civile dhe penale ofron mundësinë që autoritetet kompetente të të dyja vendeve, në çështje urgjente, të dërgojnë letërporosi dhe informacion nëpërmjet INTERPOL: shihni nenin 4 paragrafi 3 të Marrëveshjes ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë së Shqipërisë për ndihmën juridike në çështje civile dhe penale, 15 janar 1998.

të identifikojë burimet e nevojshme për të përfunduar shqyrtimin e provave dhe duhet të vlerësojë hetimin nga një këndvështrim gjithëpërfshirës. Këshillohet që prokurori të regjistrojë të gjitha vendimet kritike të marra gjatë hetimit për qëllim llogaridhënieje.

Vendimi përfundimtar i prokurorit varet nga rrethanat e çdo çështjeje. Prokurori mund të marrë vendimet e mëposhtme përfundimtare: (i) të pezullojë hetimin, (ii) të pushojë akuzën ose çështjen, (iii) të kërkojë gjykim të drejtpërdrejtë, (iv) të kërkojë një urdhër penal, (v) të kërkojë verifikimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit dhe (vi) të dërgojë çështjen në gjyq.

### **1.3.1. Pezullimi i çështjes<sup>130</sup>**

Pezullimi i çështjes bëhet kur i pandehuri nuk njihet, ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që pengon hetimin e mëtejshëm, pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.

Pezullimi i çështjes urdhërohet në bazë të një vendimi të arsyetuar të lëshuar nga prokurori, ku prokurori duhet të përshkruajë veprimet hetimore që janë ndërmarrë, rezultatit e veprimeve hetimore dhe të shpjegojë ekzistencën e shkaqeve ligjore për pezullimin e hetimit.

Vendimi i arsyetuar i njoftohet palës së dëmtuar ose personit që ka paraqitur kallëzimin penal, të cilët kanë të drejtë të apelojnë para gjyqtarit të seancës paraprake. Nëse ankimi pranohet, gjykata vendos rifillimin e hetimit dhe prokurori duhet të rifillojë hetimin, duke ndjekur udhëzimet e gjykatës.

Në të gjitha rastet e tjera, është prokurori ai që, nëse ekzistojnë shkaqe, vendos për rifillimin e hetimit. Në këtë drejtim, futet në lojë roli proaktiv i prokurorit. Në veçanti, në rastet kur i pandehuri është i panjohur, prokurori duhet të kërkojë në mënyrë aktive informacion në lidhje me ekzistencën e provave që mund të çojnë në identifikimin e të dyshuarit. Veprimet hetimore që mund të ndihmojnë në identifikimin e të pandehurit, siç është theksuar në kapitullin për organizimin e punës në rastet e autorëve të panjohur, përfshijnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve, shqyrtimin e provave materiale, kërkimin e regjistrimeve të mbikëqyrjes me video, ekzaminimet mjeko-ligjore, kontrollin e bazave ekzistuese të të dhënave dhe krahasimin me provat e çështjes, kërkimin e burimeve në internet dhe të dhënave elektronike, analiza financiare, etj.

<sup>130</sup> Neni 326 i KPP

Në rastet kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë e cila pengon hetimin e mëtejshëm, prokurori mund të bëjë kërkesë me shkrim drejtuar institucionit shëndetësor që ka verifikuar sëmundjen e të pandehurit, duke kërkuar shpjegim në lidhje me natyrën e sëmundjes sa i përket kohëzgjatjes së saj dhe vazhdimësisë së saj. Në varësi të përgjigjes nga institucioni shëndetësor, prokurori mund t'i dërgojë në mënyrë periodike kërkesa institucionit shëndetësor për të mbledhur informacion në lidhje me gjendjen aktuale shëndetësore të të pandehurit ose mund t'i kërkojë institucionit shëndetësor që të informojë prokurorin për çdo ndryshim në lidhje me gjendjen shëndetësore të të dyshuarit.

Duhet të theksohet se vendimi për pezullimin e hetimit ka karakter të përkohshëm. Nëse prokurori merr informacion shtesë që mund të çojë në nocionin e ndryshimit të rrethanave dhe nuk ka më arsye për pezullimin e çështjes, prokurori duhet të ndërmarrë veprime të tjera hetimore dhe të rifillojë hetimin.

Pezullimi i çështjes nuk ka ndonjë efekt në mbarimin e afatit të parashkrimit të veprës penale të parashikuar në Kodin Penal. Prandaj, prokurori duhet të bëjë kontrole periodike në lidhje me ekzistencën e shkaqeve për të rifilluar hetimin para se të mbarojë afati i parashkrimit.

### **1.3.2. Pushimi i akuzës ose çështjes<sup>131</sup>**

Pushimi i akuzës ose çështjes varet nga lloji i veprimtarisë kriminale në fjalë. Pushimi i çështjes për kundërvajtjet penale bëhet nga prokurori dhe pushimi i çështjes për krimet bëhet nga gjykata, por në të dy rastet baza ligjore për pushimin është e njëjtë. Prandaj, një çështje mund të pushohet kur:

- ⊙ del qartë se fakti nuk ekziston;
- ⊙ fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
- ⊙ viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;
- ⊙ personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;
- ⊙ ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;
- ⊙ del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

<sup>131</sup> Nenet 328 -330 i KPP.

- me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;
- i pandehuri vdes;
- në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Kur vendos pushimin e akuzës ose çështjes, prokurori duhet të ketë parasysh detyrimin për t'i ngarkuar personit të dëmtuar, që ka vënë në lëvizje procesin, shpenzimet dhe dëmet.<sup>132</sup>

### **1.3.3. Kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë<sup>133</sup>**

Gjykimi i drejtpërdrejtë është një mundësi e parashikuar për situata ku i pandehuri arrestohet në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një vepre penale që gjykohet nga një gjyqtar. Kushtet e vendosura në KPP për gjykimin e drejtpërdrejtë janë kumulative dhe duhet të plotësohen në mënyrë që të zbatohen dispozitat ligjore për gjykimin e drejtpërdrejtë.

Këtu duhet të vërehet se nëse nevojitet hetim i mëtejshëm, prokurori duhet të vendosë të vazhdojë hetimin. Prokurori duhet të sigurohet që të jetë në gjendje të provojë çështjen para se të kërkojë gjykim të drejtpërdrejtë, pasi nëse nuk arrin të provojë çështjen, çështja do të gjykohet me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe i pandehuri nuk mund të hetohet dhe të gjykohet për të njëjtën vepër.

### **1.3.4. Kërkesa për urdhër penal<sup>134</sup>**

Në rastin e një kundërvajtjeje penale, brenda tre muajve nga regjistrimi i emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, prokurori nxjerr urdhër penal të arsyetuar për caktimin e dënimit dhe i kërkon gjykatës miratimin e tij, kur çmon se nuk duhet të zbatohet dënimi me burgim.

Ligji parashikon rregulla që prokurori duhet të zbatojë kur propozon dënimin. Kështu, në urdhrin penal, prokurori cakton gjobën si dënimin kryesor, por gjithashtu mund të vendosë një ose më shumë dënime plotësuese. Në varësi të gjendjes ekonomike të të pandehurit, prokurori mund të urdhërojë që gjoba të paguhet me këste, duke caktuar edhe afatet e pagimit të tyre. Dënimi me gjobë nuk mund të kalojë gjysmën e maksimumit

<sup>132</sup> Neni 330 i KPP.

<sup>133</sup> Neni 400 -402 i KPP.

<sup>134</sup> Nenet 406/a – 406/ç e KPP.



që parashikon Kodi Penal për këtë lloj dënimi.

Në përfundim të hetimeve, kërkesa për miratimin e urdhrit penal depozitohet në sekretarinë e gjykatës, së bashku me të gjitha aktet e fashikullit të hetimeve paraprake. Kërkesa për miratimin e urdhrit penal i njoftohet të pandehurit.

Kërkesa për miratimin e urdhrit penal duhet të përmbajë:

- ⊙ emrin e autoritetit lëshues (emri i prokurorisë);
- ⊙ emrin e prokurorit të çështjes;
- ⊙ të dhënat personale të të pandehurit;
- ⊙ parashtrimin e faktit dhe cilësimin juridik të veprës penale;
- ⊙ burimin e provës dhe fakteve të cilave ato u referohen;
- ⊙ kërkesën për miratimin e urdhrit penal
- ⊙ masën e dënimit me gjobë, modalitetet e ekzekutimit të saj dhe llojin e dënimit plotësues të caktuar;
- ⊙ datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

Para paraqitjes së kërkesës për miratimin e urdhrit penal, prokurori duhet të sigurohet që të mos ekzistojë asnjë shkak për pushimin e akuzës ose të çështjes dhe që i pandehuri të mos akuzohet për një vepër penale për të cilën ligji nuk lejon zbatimin e dënimit. Gjithashtu, prokurori duhet të sigurohet që dënimi që ai/ajo kërkon të jetë i përshtatshëm dhe që aktet paraprake të hetimit që i bashkëlidhen kërkesës për miratim të jenë të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes.

### **1.3.5. Kërkesa për verifikimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit<sup>135</sup>**

Pranimi i fajësisë mund të bëhet gjatë procesit penal, nga momenti i regjistrimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, deri në momentin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Procesi i pranimit të fajësisë ka dy aspekte kryesore, domethënë arritjen e marrëveshjes mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe arritjen e marrëveshjes mbi dënimin që duhet të jepet. Duhet të kujtojmë që nuk lejohet pranimi i pjesshëm i akuzave dhe që marrëveshja duhet të përmbajë

<sup>135</sup> Nenet 406/d – 406/f e KPP

pranimin e fajësisë për të gjitha akuzat kundër të pandehurit.

Procesi i pranimit të fajësisë fillon me **një propozim për arritjen e një marrëveshjeje**. Propozimi mund të bëhet nga prokurori, i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm. Në rast se propozimi bëhet gojarisht nga i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm, këshillohet që prokurori të përgatisë një procesverbal për propozimin. Në rastet kur prokurori vendos të propozojë një marrëveshje, prokurori duhet të përgatisë një procesverbal, ku të përmendë arsyet e vendimit të tij/saj për të filluar procesin e pranimit të fajësisë me të pandehurin. Në këtë fazë, prokurori duhet të ketë kuptuar qartë rolin e të pandehurit, pra nëse i pandehuri mund të konsiderohet bashkëpunëtor i drejtësisë dhe nëse të pandehurit do t'i jepet ky status, pasi dispozitat që kufizojnë marrëveshjen për veprat penale për të cilat ligji parashikon një dënim maksimal prej jo më shumë se 7 vjet burgim nuk zbatohen në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë<sup>136</sup>.

Në disa raste, kur nuk plotësohen formalisht kushtet ligjore për marrëveshje, prokurori duhet të konsiderojë gjithsesi nëse marrëveshja në çështjen konkrete do t'i shërbente qëllimit të drejtësisë apo nëse do të perceptohej si një trajtim preferencial i të pandehurit, duke dëmtuar kështu reputacionin e prokurorisë. Këto çështje mund të përfshijnë ato ku viktimat janë traumatizuar rëndë; çështje ku ngjarja kriminale ka shkaktuar ankth dhe neveri në publik; çështje të lidhura me korrupsionin; çështje ku është bërë dëm i konsiderueshëm dhe nuk ka gjasa që dëmi të rregullohet nga i pandehuri; çështje që përfshijnë të mitur, etj.

Në këtë fazë, prokurori duhet të shqyrtojë (i) nëse ekzistojnë shkaqet për mosfillimin e procedimit ose pushimin e akuzës ose çështjes, (ii) nëse provat në fashikullin e prokurorit janë të mjaftueshme dhe vërtetojnë që i pandehuri ka kryer veprën penale dhe (iii) nëse cilësimi juridik i veprës penale dhe rrethanat e kryerjes së saj korrespondojnë me provat në fashikullin e prokurorit.

Pasi të jetë paraqitur propozimi për arritjen e një marrëveshjeje, faza e dytë e procesit të pranimit të fajësisë konsiston në **bisedime për arritjen e marrëveshjes**. Gjatë bisedimeve është e detyrueshme prania e avokatit mbrojtës të të pandehurit. Për bisedimet, prokurori duhet të mbajë procesverbal, ku të specifikojë propozimet e paraqitura nga prokurori, nga i pandehuri dhe avokati i tij dhe propozimet mbi të cilat u arrit marrëveshja përfundimtare. Prokurori duhet të sigurohet që (i) i pandehuri të mos ndihet

<sup>136</sup> Statusi i bashkëpunëtorit të drejtësisë fitohet në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 37/a të KPP.

nën presion për të arritur një marrëveshje me prokurorin, (ii) që pjesëmarrja e tij/saj në bisedime të jetë me dëshirën e tij/saj, (iii) që i pandehuri e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj dhe pasojat e miratimit të marrëveshjes dhe (iv) jep pëlqimin për miratimin e marrëveshjes dhe ekzekutimin e saj. Sqarimi i këtyre aspekteve para se marrëveshja t'i dërgohet gjykatës është i rëndësishëm, pasi i pandehuri do të pyetet për këto rrethana nga gjykata dhe gjykata mund të refuzojë marrëveshjen nëse vërtetohet se vullneti i të pandehurit ka qenë i vesuar. Kur gjykata refuzon të miratojë marrëveshjen, nuk lejohet depozitimi i një kërkesë të re, kështu që përpjekjet e prokurorit për të arritur një marrëveshje do të jenë të kota. Gjatë negociimit për dënimin e të pandehurit, prokurori duhet të sigurohet që dënimi për të cilin është rënë dakord të jetë i përshtatshëm në lidhje me veprën penale të kryer dhe karakterin e të pandehurit.

Pas përfundimit të bisedimeve, **marrëveshja lidhet** me shkrim. KPP kërkon që marrëveshja të përmbajë disa elemente me pasojë pavlefshmërie.<sup>137</sup> Megjithëse nuk përfshihet në to, këshillohet që marrëveshja të përmbajë gjithashtu të dhënat personale të të pandehurit dhe mbrojtësit dhe informacion tjetër personal të nevojshëm për identifikimin e tyre dhe faktin që i pandehuri është përfaqësuar nga mbrojtësi i tij/saj gjatë gjithë procedurës.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori njofton viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, duke i dërguar kopje të saj. Marrëveshja i dërgohet gjykatës për miratim së bashku me të gjitha aktet e hetimit paraprak.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e procesit të bisedimeve për pranimin e fajësisë, do të ishte i dobishëm miratimi i një Udhëzimi të Përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm. Udhëzimi i Përgjithshëm për bisedimet për pranimin e fajësisë mund të përfshijë rregulla se si do të organizohet dhe regjistrohët procesi i propozimit dhe bisedimit, duke përcaktuar rregulla për vendin ku do të zhvillohen bisedimet<sup>138</sup>, masat që duhet të merren për të siguruar praktikë uniforme nga prokurorët, situatat ku nuk rekomandohet të arrihet marrëveshje, situatat ku inkurajohet arritja e një marrëveshjeje, etj.

137 Neni 406/d paragrafi 3 i KPP.

138 Ambientet e prokurorisë janë vendi më i përshtatshëm për bisedime. Megjithatë, vëndndodhje të tjera, nëse konsiderohet e përshtatshme, mund të sugjerohen gjithashtu (p.sh. ambient i ndalimit ose burgu ku i pandehuri po vuan dënimin, strehë e sigurt ku qëndron bashkëpunëtori i drejtësisë, etj.).

### **1.3.6. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq<sup>139</sup>**

Zbatimi i testit të ndjekjes penale në një çështje para se të dërgohet në gjykim është një detyrë e rëndësishme e prokurorisë që përfshin shqyrtimin me kujdes të të gjitha provave dhe fakteve, vlerësimin e ekzistencës së mundësive për vendime të tjera përfundimtare të prokurorisë, dhe përcaktimin nëse përmbushen kërkesat procedurale për dërgimin e çështjes në gjyq. Kur prokurori vendos që asnjë vendim tjetër përfundimtar i prokurorisë nuk mund të zbatohet dhe janë plotësuar kërkesat procedurale, prokurori do të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq.

Kërkesa e prokurorit për të dërguar çështjen në gjyq duhet të përmbajë:

- ⊙ të dhënat personale të të pandehurit dhe të viktimës, kur është e mundur, si dhe çdo element tjetër që shërben për identifikimin e tyre;
- ⊙ parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale;
- ⊙ burimet e provave dhe faktet të cilave u referohen;
- ⊙ kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq;
- ⊙ datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër. Prokurori duhet të marrë një rol proaktiv në propozimin e akteve që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit, pasi gjykata do të zhvillojë seancën e dëgjimit të palëve për të përcaktuar aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit. Prokurori duhet të sigurohet që të gjitha provat përkatëse që i duhen prokurorit për të provuar çështjen të përfshihen në fashikullin e gjykimit.

Gjatë seancës paraprake, do të vlerësohen kushtet për dërgimin e çështjes në gjyq. Palët mund të paraqesin marrëveshje për kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, dhe kërkesën për sigurimin e provave. Mundësitë e lartpërmendura janë shumë të rëndësishme pasi ato mundësojnë qasjen proaktive të prokurorit edhe pasi prokurori ka mbaruar hetimin dhe ka kërkuar që çështja të dërgohet në gjyq. Prandaj, prokurori duhet t'i përdorë këto mundësi sa herë që ekziston një rast i tillë.

---

139 Nenet 331-332/gj e KPP.

## **2. Trajtimi i situatave specifike**

Në mënyrë që të ushtrojë plotësisht dhe në mënyrë të efektshme rolin e tij drejtues, prokurori duhet të jetë i vetëdijshëm për mundësitë ligjore që ekzistojnë dhe sfidat që mund të lindin gjatë hetimit. Për përballimin e pengesave, prokurori duhet të ndjekë një qasje jashtë kornizave, gjithmonë duke iu bindur kërkesave procedurale, por duke gjetur zgjidhje që mund të mos jenë shprehur qartësisht në ligj. Kështu, roli drejtues i prokurorit nënkupton një qasje proaktive dhe novatore të prokurorit.

### **2.1. Sigurimi i provës<sup>140</sup>**

Gjatë hetimeve, prokurori mund të marrë dijëni se disa nga provat nuk mund të paraqiten para gjykatës ose paraqitja e tyre pengohet nga vështirësi të caktuara. Në raste si këto, prokurori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur provat.

Për të trajtuar situata të ngjashme, prokurori mund të kërkojë sigurimin e provave.

### **2.2. Kryerja e hetimeve financiare**

Hetimet financiare janë një mjet thelbësor i përgjigjes moderne dhe efektive ndaj kërcënimeve kriminale sidomos veprave penale ndërkombëtare dhe financimit të terrorizmit. Ato mund të ndihmojnë që të ofrojnë prova të veprimtarive kriminale, të identifikojnë rrjete kriminale, sidomos degëzimet e tyre ndërkombëtare, si dhe të zbulojnë dhe të gjurmojnë të ardhurat e krimit. Përveç vlerës së tij proaktive, hetimi financiar ka edhe vlerë të shtuar parandaluese, pasi mund të ofrojë njohuri mbi modelet e krimit. Në shumë raste, hetimet financiare janë të nevojshme për të gjetur prova kundër kriminelëve të sofistikuar, të nivelit të lartë, me qëllim shkatërrimin e rrjeteve ndërkombëtare dhe të krimit të organizuar. Hetimet financiare ndihmojnë hetimet penale me anë të identifikimit të motiveve, asociimeve dhe lidhjeve me njerëz dhe vende; identifikimit të përdorimit të shërbimeve të tjera të tilla si telefonat, transporti dhe pajisjeve me rëndësi për çështjen; përcaktimit të vendndodhjes ose identifikimit të të dyshuarit, dëshmitarëve ose viktimave; dhënies së informacionit mbi lëvizjet e një të dyshuari (përdorimi proaktiv, i fshehtë i informacionit financiar); dhënies së informacionit për të adresuar çështjen e autorëve përsëritës dhe atyre

<sup>140</sup> Nenet 316 – 322 e KPP

me përparësi kur asnjë metodë e mëparshme nuk ka qenë e suksesshme; gjurmimit të personave duke përfshirë edhe të zhdukurit, etj.<sup>141</sup>

Qëllimi i hetimit financiar është i ndryshëm nga qëllimi i hetimit penal. Ndërsa qëllimi i këtij të fundit është të zbulojë një vepër penale dhe autorin e krimit dhe të mbledhë prova, qëllimi i hetimit financiar është të zbulojë të ardhurat nga krimi, të identifikojë pasurinë që mund të konfiskohet dhe të sigurojë informacion të mjaftueshëm mbi të cilin kjo pasuri mund të sigurohet përkohësisht në mënyrë që të mundësohet konfiskimi përfundimtar në të ardhmen.<sup>142</sup> Meqenëse në disa vepra penale, të ardhurat nga krimi janë një element i krimit, hetimi financiar përfaqëson një mekanizëm specifik hetimor për të provuar ekzistencën e këtij elementi. Prandaj, hetimet financiare janë pjesë e një hetimi dhe kryhen paralelisht me hetimet penale. Në disa raste, hetimet financiare mund të çojnë në zbulimin e një krimi të veçantë (p.sh. pastrimi i parave).

Këshillohet që të kryhen hetime financiare në fazën e hershme të hetimit penal të krimeve që gjenerojnë fitime. Suksesi i hetimeve financiare varet nga disa faktorë, të tillë si përfshirja e hetuesve të specializuar në hetimet financiare dhe ekspertëve në kontabilitetin financiar ose kriminalistik; bashkëpunimi i ngushtë dhe shkëmbimi i informacionit midis hetuesve financiarë dhe oficerëve të policisë përgjegjës për hetimin penal; organizimi i duhur, menaxhimi dhe analiza e informacionit dhe provave; përdorimi proaktiv i veprimeve hetimore, etj.

Për kryerjen e hetimeve financiare ka udhëzime gjerësisht të disponueshme.<sup>143</sup>

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen hetuesit është përpunimi dhe menaxhimi i volumit të madh të të dhënave që prodhohen normalisht nga hetimet financiare. Prandaj është e domosdoshme që prokurorët dhe oficerët e angazhuar në këtë lloj aktiviteti të krijojnë një sistem kontrolli të standardizuar si pjesë e hetimeve financiare, një sistem për menaxhimin e materialeve dhe provave të mbledhura dhe një sistem për regjistrimin e gjetjeve.

Për të njëjtat arsye, prokurorët duhet të miratojnë një sistem për

---

141 Rëndësia e hetimeve financiare dhe avantazheve të tyre është përcaktuar shumë qartë nga Komisioni i BE-së [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/financial-investigation\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/financial-investigation_en)

142 Hetimi Financiar dhe Konfiskimi i Produkteve të Krimit, Manual Trajnimi për Agjencitë Ligjzbatuese dhe Gjqësorin, KiE, Gusht 2006 - <https://rm.coe.int/16806ef391>

143 [https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Operational%20Issues\\_Financial%20investigations%20Guidance.pdf](https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Operational%20Issues_Financial%20investigations%20Guidance.pdf) <https://rm.coe.int/16806ef391>

qëllime arkivimi dhe regjistrimi. Disa shembuj të këtyre sistemeve jepen në këtë Manual në kapitullin mbi organizimin e punës në çështje komplekse.

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore mund të krijojnë një listë verifikimi që identifikon të gjitha kontrollet e nevojshme për t'u kryer gjatë hetimeve financiare, duke përfshirë ato që lidhen me personin e dyshuar dhe ato që lidhen me personat që kanë marrëdhënie të ngushta me të dyshuarin (anëtarët e familjes, përfshirë të miturit, bashkëpunëtorët e ngushtë, partnerët, etj.).<sup>144</sup> Lista e verifikimit ndryshon në çdo sistem ligjor dhe mund të përmbajë kontrole të llogarisë bankare, kontrole të dhënave të tjera bankare (pronësia e depozitave, kasaforta, etj.), kërkesën për transferim të shpejtë të parave, detaje rreth pronësisë dhe rolit të menaxhimit në kompani, statusin e pronësisë përfituese (mund të kërkohej nga bankat gjithashtu), pronësinë e automjeteve dhe mjeteve të tjera të transportit (helikopterë, aeroplanë, anije lundrimi, etj.), pronësinë e tokës dhe pasurive të patundshme, raporte tatimore, informacion nga doganat (importet dhe eksportet e mallrave), informacion nga depozituesit e letrave me vlerë, sigurimet (p.sh: sigurimet e jetës), fondet e investimeve, etj. Nëse nëpunësit publikë janë nën hetim, duhet të kërkohej gjithashtu raportet zyrtare për zbulimin e pasurive që u janë raportuar agjencive shtetërore.

Një shembull i një liste verifikimi përfshihet në Aneksin VII të këtij Manuali.

Analiza e të dhënave financiare duhet të përqendrohet në gjurmimin e aktiviteteve të pazakonta dhe të dyshimta siç janë stili i jetësës, shpenzimet mujore, të ardhurat, depozitat në para, etj. Kontabiliteti kriminalistik duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë pagesave të parave *cash*, rishikimit përmbledhës të të ardhurave dhe daljeve nga/tek individët dhe personat juridikë, pagave, të ardhurave të rregullta, të ardhurave të tjera të punësimit (kompensim për largimin nga puna, ushqimi, transporti, etj.), tarifave, hyrjet dhe daljet e kapitalit (dividendët, depozitat e themelimit, letrat me vlerë, kontratat e shitjes, qira, etj.), donacioneve, shpenzimeve të rregullta, depozitave dhe transfertave bankare, huave dhe transaksioneve të tjera financiare. Analiza e informacionit financiar duhet të krahasohet me informacionin tjetër për pasurinë dhe sendet e mbledhura gjatë hetimit financiar. Gjetjet e hetimit financiar duhet të renditen në një mënyrë të qartë dhe të saktë, me një përmbledhje të rezultateve dhe një përshkrim të pasurive

<sup>144</sup> Për identifikimin e personave që do të përfshihen në hetim financiar, nevojitet bashkëpunim i ngushtë me OPGJ që janë përgjegjës për hetimin penal sepse ata mund të mbledhin informacion në terren dhe të japin inteligjencë të rëndësishme.



aktuale të personave nën hetim dhe çdo veprimtari të dyshimtë siç janë sendet e paverifikuara. Prandaj, për të mbajtur nën kontroll këtë informacion dhe këto të dhëna, është e nevojshme që prokurorët të miratojnë një sistem për regjistrimin e gjetjeve të hetimit financiar. Shembull i një sistemi të tillë është krijimi i profilit financiar të subjektit, ku paraqiten informacionet operacionale dhe financiare të personit.<sup>145</sup>

### 2.3. Rastet e korrupsionit

Hetimi i rasteve të korrupsionit është një tablo që ende nuk është shpalosur me sukses. Ka shumë histori suksesi, por shumica e rasteve të korrupsionit përfundojnë pa u ndëshkuar. Pavarësisht nga vështirësitë e hetimit dhe ndjekjes penale, pasojat me shtrirje dhe zgjerim të madh si dhe dëmet nga veprimtaritë korruptive e bëjnë luftën kundër korrupsionit një nga përparësitë kryesore në të gjithë botën.

Në shoqërinë shqiptare, si në shoqëritë e tjera në Ballkanin Perëndimor, korrupsioni nuk pranohet nga qytetarët - ata shprehin shqetësim të madh në lidhje me të - megjithatë mitmarrja duket se tolerohet si një mjet për të zgjidhur punë dhe për të marrë trajtim më të mirë.<sup>146</sup> Meqenëse korrupsioni është shpesh me avantazh për autorin dhe viktimën, njerëzit ngurrojnë të kallëzojnë dhe dëshmitarët ngurrojnë të jenë në dispozicion. Në situata të ngjashme, prokurorët shpesh detyrohen të përdorin mbledhjen e provave fizike, kryerjen e hetimeve financiare dhe përdorimin e teknikave speciale të hetimit si përgjimet dhe veprimet e simuluar.

Përkundër rrethanave të sipërpërmendura, krijimi i një strategjie për hetimin e rasteve të korrupsionit është një veprimtari thelbësore përgatitore për prokurorët. Prokurorët duhet të kenë parasysh se të dyshuarit në çështjet e korrupsionit shpesh janë shumë krijues, kanë qasje në informacion, njerëz dhe qendra pushteti dhe shtyhen nga fitimi. Kështu, gjatë hartimit të

---

145 Profilët financiarë duhet të përshtaten me specifikat e vendit. Për shembull, duke pasur parasysh përdorimin e parasë cash në Ballkanin Perëndimor dhe traditën që ekziston, profilët financiarë, sa herë që është e mundur, duhet të përmbajnë informacion për të ardhurat e dyshuara në *cash* dhe kursimet cash të subjektit dhe pronësinë e arit dhe sendeve të tjera me vlerë.

146 [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Western\\_balkans\\_corruption\\_report\\_2011\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Western_balkans_corruption_report_2011_web.pdf)  
[https://www.unodc.org/documents/southeasterneurope/corruption/Albania\\_corruption\\_report\\_2011\\_web\\_small.pdf](https://www.unodc.org/documents/southeasterneurope/corruption/Albania_corruption_report_2011_web_small.pdf)  
[https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2019/12/Corruption-in-the-Western-Balkans-2019-Trends-and-Policy-Options\\_fin.pdf](https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2019/12/Corruption-in-the-Western-Balkans-2019-Trends-and-Policy-Options_fin.pdf)



strategjisë për hetimin, prokurori duhet të konsiderojë të gjitha pengesat që ai/ajo mund të hasë gjatë hetimit, duke marrë parasysh personalitetin e të dyshuarit dhe përkushtimin e të dyshuarit për të penguar hetimin. Shkatërrimi i provave materiale, fshirja e mesazheve elektronike dhe korrespondencave të tjera elektronike, kërcënimi dhe ndikimi i dëshmitarëve dhe llojet e tjera të pengesave janë praktika të njohura në rastet e korrupsionit. Prandaj, qëllimi kryesor i prokurorit duhet të jetë planifikimi i hetimit ku prokurori të jetë gjithmonë përpara dhe të jetë në gjendje të mundë kundërshtarit, duke vendosur se cilat veprime hetimore do të përdorë dhe sipas cilës radhë do të ndërmerren veprimet hetimore.

Si shembull, strategjia në fjalë mund të parashikojë mbledhjen e informacionit në radhë të parë nga dëshmitarët kyç siç janë personat që punojnë në zyrë me personin e dyshuar, llogaritarët e zyrës ku punon i dyshuari, punonjësit e bankës në rastet kur bëhet fjalë për depozitime të parasë *cash*, ish-partnerë të të dyshuarit që mund të kenë informacione dhe motive të rëndësishme për të dëshmuar, etj. Për të ruajtur sekretin e hetimit, prokurori duhet të sigurohet që dëshmitarët të paralajmërohen në këtë drejtim.

Kryerja e veprimtarive të koordinuara njëkohësisht është një shembull tjetër i strategjisë së hetimit. Në mënyrë të veçantë, veprimtaritë do të rregullohen në mënyrë të tillë që ndërsa OPGJ mbledh provat materiale ose ekzekuton urdhra kontrolli ose urdhra sekuestrimi, prokurori ose OPGJ-ja tjetër në të njëjtën kohë mbledh informacion nga dëshmitarët kyç të çështjes.

Në rastet e korrupsionit, një prokuror duhet të ketë parasysh se informacioni në lidhje me veprimet e nevojshme hetimore mund të rrjedhë nga punonjësit e gjykatës të ngarkuar me përpunimin e këtyre kërkesave. Prandaj, kërkesat për urdhër kontrolli, sekuestrime ose përgjim duhet të bëhen pasi të jenë vendosur masat e duhura të sigurimit. Për shembull, para se prokurori të kërkojë veprimet e përmendura hetimore, ai/ajo mund të kërkojë nga OPGJ-ja të monitorojë pronën që do të kontrollohet për ndonjë aktivitet të pazakontë<sup>147</sup> ose mund të urdhërojë ruajtjen e përsheptuar të të dhënave të caktuara kompjuterike.

Zakonisht, hetimi i suksesshëm i rasteve të korrupsionit varet nga fakti nëse prokurori është në gjendje të gjejë të ardhurat e korrupsionit. Kështu, fillimi i një hetimi financiar në fazën e hershme të hetimit penal është i nevojshëm.

<sup>147</sup> p.sh. nxjerrja e kutive ku mund të mbahen dokumente nga vendndodhja që do të kontrollohet; pakësimi ose kufizimi i lëvizjes së personave në vendin që do të kontrollohet etj.

Prokurorët duhet të kenë parasysh ekzistencën e organeve mbikëqyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare që mund të ndihmojnë për hetimin e rasteve të korrupsionit. Për shembull, në rastet e keqmenaxhimit të fondeve të BE-së, prokurori mund të vendosë kontakte me zyrtarë të Zyrës Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF)<sup>148</sup>. Në nivel kombëtar, në rastet e aktivitetit të dyshimtë financiar, prokurori mund të kontaktojë GPH dhe të kuptojë nëse ky aktivitet i është raportuar FIU dhe nëse janë bërë kontrollet e nevojshme. Gjithashtu, prokurori mund t'i kërkojë FIU që të kryejë kontrolle shtesë dhe të mbledhë inteligjencë në rastet e dyshuara të pastrimit të parave.<sup>149</sup> Në fakt, komunikimi me FIU është thelbësor në rastet e pastrimit të parave pasi prokurori mund të marrë të gjithë inteligjencën e rëndësishme në fazat e hershme të hetimit dhe të ketë kohë të mjaftueshme për të planifikuar dhe përgatitur letërporosi për të verifikuar informacionin e marrë nga FIU.

### 2.4. Grupet e Përbashkëta Hetimore

Grupet e përbashkëta hetimore janë grupe ku marrin pjesë përfaqësues nga agjenci të ndryshme kombëtare ose të huaja me qëllim kryerjen e hetimeve penale për vepra penale që kërkojnë nivele dhe lloje të larmishme ekspertize ose që ndikojnë në të gjitha agjencitë pjesëmarrëse.

**Grupet e përbashkëta hetimore** krijohen nga prokurorët të cilët mund të vendosin lirisht për përfshirjen e përfaqësuesve të agjencive të ndryshme shtetërore në çështje komplekse që kërkojnë ekspertizë përkatëse dhe/ose mbështetje të veçantë hetimore.<sup>150</sup> Kuadri aktual ligjor përcakton që veprimet e përbashkëta hetimore duhet të ndërmerren vetëm nga përfaqësuesit e policisë gjyqësore. Megjithatë, në mbështetje të oficerëve të policisë gjyqësore, prokurori mund të vendosë të përfshijë oficerë policie nga policia e shtetit ose punonjës të tjerë nga agjencitë shtetërore që mund të ofrojnë mbështetje administrative ose teknike për anëtarët e grupit. Prokurori duhet të vendosë rolet e anëtarëve të grupit, përfshirë një drejtues

<sup>148</sup> Zyra Europiane kundër Mashtrimit (OLAF) është i vetmi organ i BE-së me detyrë të zbulojë, të hetojë dhe të ndalojë mashtrimin me fondet e BE-së.

<sup>149</sup> FIU Shqiptare është anëtare e Grupit EGMONT, i cili është organ i bashkuar i 165 Njësive të Hetimit Financiar që ofron një platformë për shkëmbim të sigurt të ekspertizës dhe inteligjencës financiare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Kështu FIU mund të marrë informacion për llogaritë bankare, pronësinë përfituese të shoqërive dhe informacion tjetër të rëndësishëm që ndodhet jashtë vendit në mënyrë shumë të shpejtë. Megjithatë, prokurorët duhet të jenë në dijeni të faktit që informacioni i mbledhur përmes FIU është vetëm inteligjencë dhe që duhet të dërgohen letërporosi që të merren prova të rëndësishme për hetimin penal.

<sup>150</sup> Neni 26 dhe Neni 4 i Ligjit nr. 25/2019.

grupi, një koordinator komunikimi, drejtues të nën-grupeve ose ndonjë rol tjetër që prokurori e konsideron të nevojshëm.

**Vendimi i prokurorit për të krijuar një grup të përbashkët hetimor kombëtar** duhet të bëhet me shkrim, dhe të tregojë numrin e dosjes së çështjes, informacion të shkurtër për hetimin e nisur, emrin e të dyshuarit dhe krimet për të cilat ai/ajo akuzohet, nevojën për përfshirjen e agjencive të ndryshme shtetërore, emrat e agjencive të përfshira, emrat e personave që do të jenë pjesë e grupit me rolet e përcaktuara për ta dhe një shpjegim të shkurtër mbi arsyet e krijimit të grupit të përbashkët hetimor kombëtar. Vendimi duhet të firmoset nga prokurori. Drejtuesit e agjencive shtetërore, punonjësit e të cilave janë të përfshirë në grupin e përbashkët hetimor, duhet të informohen për përfshirjen e punonjësve të tyre dhe kohën që punonjësit e tyre duhet t'i kushtojnë hetimit. Para se të merret një vendim për të ngritur një grup të përbashkët hetimor kombëtar, këshillohet që prokurori të zhvillojë një takim me përfaqësues nga të gjitha agjencitë shtetërore që do të përfshihen dhe të diskutojë të gjitha çështjet përkatëse, përfshirë caktimin e anëtarëve të grupit, protokollet e komunikimit, mbulimin e ngjarjeve në media, veprimet hetimore, etj.

Në lidhje me **grupet e përbashkëta hetimore ndërkombëtare**, edhe pse kuadri ligjor aktual nuk i njeh qartësisht si një formë e veçantë bashkëpunimi në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, as nuk përjashton krijimin e tyre. Për më tepër, Shqipëria ka ratifikuar disa instrumente ndërkombëtare që bëjnë të mundur që autoritetet shqiptare të marrin pjesë në grupe të përbashkëta hetimore. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka një Seksion Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Hetimi të Përbashkët dhe një koordinator Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Hetimi të Përbashkët.<sup>151</sup> Për krimet që janë kompetencë e Prokurorisë së Posaçme, ky seksion mund të caktojë anëtarët në organet e hetimit të përbashkët të krijuara në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose në bazë të një përcaktimi në lidhje me një çështje individuale, për qëllime të hetimit, ndjekjes penale ose përfaqësimit para gjykatës në Republikën e Shqipërisë ose në një ose më shumë shtete të tjera. Lidhur me hetimet e përbashkëta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimeve të Përbashkëta në Prokurorinë e Posaçme mbikëqyr zbatimin e rregulloreve të brendshme dhe respektimin e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë.

<sup>151</sup> Neni 17, Neni 22 dhe Neni 23 i Ligjit nr. 95/2016.

Kur duhet të krijohet një grup i përbashkët hetimor ndërkombëtar, prokurori duhet të dërgojë një letërporosi tek autoriteti i huaj kompetent dhe të kërkojë një marrëveshje në këtë drejtim. Nëse autoriteti i huaj është dakord, duhet të nënshkruhet një marrëveshje për krijimin e një GPH. Në mungesë të rregullave procedurale që rregullojnë GPH-të, autoritetet kompetente shqiptare duhet të adresojnë me kujdes të gjitha çështjet përkatëse, duke filluar nga çështjet organizative si mbulimi i shpenzimeve, përkthimi, shqyrtimi i dokumenteve, etj., të çështjet procedurale si rregullat për ndërmarrjen e veprimeve hetimore në territorin e shtetit tjetër, pranueshmëria e provave, vendimi për ndjekje penale, etj.

Autoritetet kombëtare shqiptare duhet të mbajnë parasysh mundësitë për të kërkuar mbështetje financiare për GPH të cilat zakonisht gjenerojnë shpenzime të larta. Në rastet kur përfshihet një vend anëtar i BE-së, agjencitë e BE-së si EUROJUST-i mund të ofrojnë mbështetje financiare për GPH. Gjithashtu, projektet IPA për luftën kundër krimeve të rënda dhe krimin të organizuar në Ballkanin Perëndimor mund të ofrojnë mbështetje financiare nëse është përfshirë ndonjë shtet anëtar i BE-së.

### **3. Përmirësimi i bashkëpunimit me OPGJ**

Prokurorët dhe OPGJ-të në Shqipëri përballen me të njëjtin problem - ngarkesa e madhe në punë dhe pamjaftueshmëria e burimeve në dispozicion.<sup>152</sup> Prandaj, përmirësimi i bashkëpunimit me njëri-tjetrin për të qenë më efikas dhe për të përdorur burimet në dispozicion në mënyrë më efektive është mënyra për të përdorur sa më mirë kapacitetet aktuale duke ruajtur dhe mundësisht duke rritur standardet e cilësisë së ofrimit dhe profesionalizmit në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse. Në mënyrë të pashmangshme, çështjet e bashkëpunimit janë të lidhura me pritshmëritë që kanë të dyja palët.

Të kuptuarit qartë i roleve që kanë OPGJ-të dhe prokurorët në hetime është thelbësor për qartësimin e bashkëpunimit të tyre. Në hetime penale, OPGJ dhe prokurorët kanë një qëllim të përbashkët: luftën efektive kundër krimin. Sidoqoftë, rolet e tyre janë të ndryshme. OPGJ është forca shtytëse e hetimeve. Ata shpesh janë të parët që kanë dijeni për ndodhinë e ngjarjeve kriminale, ata bëjnë punën në terren, mbledhin informacione, inteligjencë dhe prova dhe sigurohen që ngjarjet kriminale të regjistrohen, të hetohen dhe të përpunohen. Nga ana tjetër, prokurorët

<sup>152</sup> Raport i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 25

janë përgjegjës për të siguruar drejtësinë procedurale për ngjarjet kriminale të ndjekura penalisht, për të orientuar dhe drejtuar hetimin, për të siguruar shmangien e mosndëshkimit. Kjo është arsyeja kryesore pse ligji u ngarkon prokurorëve rolin drejtues në hetime. Gjatë ushtrimit të këtij roli, prokurorët duhet të sigurohen që OPGJ-të të kuptojnë qartë pse prokurorët bëjnë kërkesa të caktuara, çfarë mund të dëmtojë punën e bërë gjatë hetimit, cili është rezultati përfundimtar i një çështjeje, etj. Rrjedhimisht, komunikimi i duhur dhe i shpeshtë midis të dy palëve është me rëndësi të madhe. Prokurorët duhet të perceptohen si mentorë që do të drejtojnë punën e OPGJ-ve në mënyrë që të sigurojnë një shkallë më të mirë suksesi në procedimet penale.

### 3.1. Referimi i çështjes

Cilësia e referimit të çështjeve duket se është një nga shqetësimet më të mëdha të prokurorëve. Shpesh informacionit referues të OPGJ-së i kanë munguar elementet e përshkruara në KPP dhe ka raste kur veprimtaritë e referuara nuk përbëjnë as vepër penale.<sup>153</sup> OPGJ-të u paraqesin prokurorëve dy raporte kryesore: informacionin fillestar të referimit të veprës penale dhe relacionin shpjegues (përfundimtar).

Në shumicën e rasteve, policia informon prokurorin për veprën penale duke paraqitur një **njoftim ose informacion fillestar referimi të veprës penale**. Informacioni fillestar i referimit të veprës penale duhet të përmbajë elementet thelbësore të veprës penale të dyshuar, burimet e provës, të dhënat personale, adresën dhe çdo informacion tjetër që shërben për të identifikuar personin të cilit i atribuohet vepra penale, personin e dëmtuar dhe ata që kanë dijeni për rrethanat e faktit.<sup>154</sup> Në këtë fazë të procedimit është shumë e vështirë që prokurori të ndikojë drejtpërdrejt në përmbajtjen e informacionit të referimit pasi vetë referimi është akti që fillon bashkëpunimin e mëtejshëm midis prokurorit dhe OPGJ-së. Gjithashtu, meqenëse ende nuk është marrë një vendim për regjistrimin e çështjes, prokurori nuk mund të kërkojë zyrtarisht nga policia të ndërmarrë veprime specifike hetimore. Sidoqoftë, prokurori mund të caktojë një takim me OPGJ që ka paraqitur referimin në mënyrë që të tregojë pjesët problematike të dokumentit, përmbajtjen e tij dhe të kërkojë sqarime bazuar në informacionin në dispozicion.

Në mënyrë që prokurori të jetë në gjendje të marrë një vendim, prokurori duhet të mbajë procesverbal të takimit me OPGJ, duke përfshirë

<sup>153</sup> Raport i vitit 2019 i Prezencës OSBE-së, cituar, supra, shënim 3, fq. 34-35.

<sup>154</sup> Neni 293 i KPP.

sqarimet që janë kërkuar dhe përgjigjet që janë dhënë. Gjatë takimit, prokurori duhet të parashtojë shumë qartë pyetjet dhe dilemat që e pengojnë atë të vendosë për regjistrimin e një çështjeje dhe pritshmëritë e tij/saj mbi përmbajtjen e informacionit. Prokurori mund të kërkojë që sqarimet të jepen me shkrim brenda 10 ditëve të para të marrjes së informacionit të referimit, në mënyrë që të veprohet brenda afati ligjor prej 15 ditësh për regjistrimin e çështjes.

Raporti përfundimtar që OPGJ i paraqet prokurorit është **relacioni shpjegues**, i cili i dërgohet prokurorit së bashku me provat e mbledhura pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore.<sup>155</sup> Relacioni shpjegues duhet të përmbajë sugjerimet e OPGJ mbi përfundimin e hetimeve dhe gjetjet përfundimtare të tij/saj. Prandaj, relacioni shpjegues ka ndikim të rëndësishëm në punën e mëtejshme të prokurorëve.

Ndryshe nga informacioni fillestar i referimit, prokurorët mund të ndikojnë në cilësinë e relacionit përfundimtar, pasi gjatë hetimit prokurorët kanë kontakte dhe komunikojnë me OPGJ. Përveç kësaj, **prokurorët në urdhrin e hetimit mund të shtojnë një pjesë të fundit**, ku duhet të përshkruajnë përmbajtjen që pritet të ketë relacioni përfundimtar, duke përfshirë materialet që duhet të bashkëngjiten dhe mënyrën se si duhet të paraqiten provat.

Relacioni shpjegues duhet të hartohet në mënyrë që të bëjë të mundur që prokurori të kontrollojë lehtësisht gjetjet, të shqyrtojë provat dhe të dalë në konkluzione. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë:

- ⊙ emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe metodën e përdorur për identifikimin e tij/saj;
- ⊙ përshkrimin e faktit penal të dhënë në lidhje me veprën penale të dyshuar (ky përshkrim është më mirë të bëhet në mënyrë kronologjike, duke shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur, personat e përfshirë etj., dhe mënyrën se si kjo lidhet me elementet e krimit të dyshuar);
- ⊙ cilësimin juridik të veprës penale;
- ⊙ shpjegimin e veprimeve hetimore që janë ndërmarrë, përfshirë rezultatit e secilës veprimtari hetimore, duke shpjeguar se cilat prova janë mbledhur përmes kujt veprimi hetimor;
- ⊙ analizën e provave, duke theksuar lidhjen e tyre me veprën penale;

<sup>155</sup> Neni 327 i KPP.

- ⦿ opinionin e OPGJ-së për ekzistencën e krimit, përgjegjësinë penale të të dyshuarit dhe sugjerimin e OPGJ-së për veprimtarinë dhe vendimin e ardhshëm të prokurorit;
- ⦿ çdo informacion që OPGJ beson se është i nevojshëm për t'u ndarë me prokurorin.

Një paraqitje e duhur e provave bën të mundur që prokurori të shqyrtojë më mirë rezultatet e hetimit. Provat mund të paraqiten sipas radhës në të cilën janë kryer veprimet hetimore dhe janë mbledhur provat, ose në një mënyrë kronologjike, ose në ndonjë mënyrë tjetër të kërkuar nga prokurori.

Këshillohet që pas përfundimit të veprimeve hetimore të zhvillohet një takim mes prokurorit dhe OPGJ-së. Gjatë takimit, prokurori informohet gojarisht për rezultatin e hetimit dhe mund të japë komente në lidhje me përmbajtjen e relacionit shpjegues.

Nëse prokurori mban fashikullin e çështjes për arsye sigurie dhe konfidencialiteti ai mund të urdhërojë që OPGJ të përgatisë relacionin shpjegues në prokurori.

### **3.2. Komunikimi me OPGJ-të**

Komunikimi i duhur është një mjet kryesor për hetimin efikas dhe efektiv. Prokurorët duhet të vendosin komunikim të menjëhershëm me OPGJ-në dhe të nxisin një kulturë besimi dhe pune në grup.

Për të përmirësuar komunikimin, prokurorët duhet të krijojnë modele dhe protokolle për komunikim dhe të informojnë OPGJ-në përkatësisht. Për shembull, prokurorët mund të caktojnë dy ditë të javës për hetime dhe të qëndrojnë në dispozicion të OPGJ-së për konsultim. Prokurorët duhet të caktojnë takime të detyrueshme javore ose dyjavore me OPGJ-në në mënyrë që të mbikëqyrin kryerjen e veprimeve hetimore dhe të shkëmbejnë ide në lidhje me aktivitetet e mundshme në të ardhmen. Takimet me OPGJ-në mund të caktohen duke përdorur adresën elektronike zyrtare dhe mjete të tjera që mundësojnë regjistrimin e iniciativave të prokurorit dhe proaktivitetin gjatë hetimit.

Takimet janë mjete shumë të rëndësishme komunikimi, pasi prokurori mund të vendosë kontakte personale me OPGJ-në dhe të njihet me grupin e tij/saj, të marrë dhe të sigurojë vlerësime gjatë bisedës, të qartësojë menjëherë të gjitha keqkuptimet dhe të përshtatë pritshmëritë. Meqenëse



OPGJ ka normalisht më shumë përvojë në terren për kryerjen e hetimeve, prokurorët duhet të jenë gjithmonë të hapur për të shqyrtuar sugjerime dhe ide nga oficerët e policisë, për të vlerësuar ide dhe iniciativa të dobishme dhe për të nxjerrë në pah të gjitha praktikat e mira të OPGJ-së. Krijimi i një procesi konstruktiv vlerësimi ka një ndikim pozitiv në proaktivitetin e OPGJ-së dhe ndjenjën e përgjithshme të besimit dhe punës në grup.

OPGJ merr pjesë aktivisht në hetim dhe ata janë të interesuar të dëgjojnë për rezultatin përfundimtar të punës së tyre. Prandaj, prokurorët duhet të miratojnë një praktikë të informimit të OPGJ-së për të gjitha fazat e procedimit penal, vendimet e marra dhe arsyetimin e tyre, nëse janë të ndryshme nga sugjerimet e dhëna nga OPGJ, dhe vendimin e gjykatës.

Krijimi i protokolleve të komunikimit gjatë hetimit është i rëndësishëm për të siguruar qarkullimin e duhur të informacionit, për të penguar rrjedhjen dhe për të mbrojtur integritetin e hetimit. Çështja e protokollit të komunikimit është trajtuar në seksionet paraardhëse. Këtu duhet të vërehet se protokollat e komunikimit për komunikim të menjëhershëm midis prokurorëve dhe OPGJ-ve duhet të japin informacion të qartë për mënyrën se si do të zhvillohet komunikimi (takime, posta elektronike, telefon, mesazhe etj.), shpeshtësinë e komunikimit, pjesëmarrësit në komunikim, rrjedhën e komunikimit (kush komunikon me kë në cilat situata), gjuhën e komunikimit (përdorimi i kodeve në komunikim) dhe çdo aspekt tjetër komunikimi që mund të jetë i nevojshëm.

### **3.3. Krijimi i efektivitetit të OPGJ-së**

Efektiviteti i OPGJ-së në hetim është po aq rezultat i etikës dhe përkushtimit të tyre në punë, sa edhe i motivimit të tyre. Prandaj, prokurorët duhet të ndërmarrin masa organizative dhe masa pune që kanë një efekt motivues për OPGJ.

Prokurorët duhet të krijojnë një mjedis pune miqësor, por profesional duke e vënë veten në dispozicion për OPGJ-në dhe duke krijuar një kulturë të punës në grup, ku çdo kontribut i anëtarëve të grupit të pranohet dhe të vlerësohet. Prokurorët duhet të jenë një shembull dhe frymëzim për OPGJ, duke treguar respekt të lartë për integritetin e të gjithë personave të përfshirë në procedime, dedikim dhe përkushtim të lartë në punë, duke zbatuar strategji pozitive komunikimi dhe duke mbështetur vlerat morale dhe etike duke i bërë ata persona me të cilët të gjithë do të donin të punonin.



Vizioni i përgjithshëm në hetime duhet të jetë gjithmonë i dukshëm për OPGJ-në që lufta kundër krimit të jetë gjithmonë një qëllim kuptimplotë dhe i cili ia vlen të arrihet. Prandaj, edhe kur drejtojnë hetimin, prokurorët duhet të mirëpresin të gjitha idetë, duke u siguruar që OPGJ-të të kenë autonomi të mjaftueshme për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë veprime hetimore me nismën e tyre, dhe duke inkurajuar krijimtarinë e tyre.

Në varësi të llojit të hetimit, vendosja e qëllimeve lehtësisht të arritshme për çdo javë ose në një kohë të shkurtër, do të ndihmojë në ruajtjen e motivimit, përkushtimit dhe krijimit të ndjesisë që gjërat po lëvizin.

Një nga mjetet më të suksesshme për të rritur efektivitetin e OPGJ-ve është zbatimi i sistemit të meritës në vlerësimin e punës së OPGJ-ve duke krijuar një ritual vlerësimi që mirëpret idetë dhe praktikat pozitive të OPGJ-ve. Për shembull, OPGJ-së që ka treguar proaktivitet mund t'i jepet mundësia që t'i bashkohet prokurorit në seancat gjyqësore. OPGJ-ja që ka dështuar në kryerjen e detyrave të caktuara mund të hiqet nga hetimi dhe detyrat e tij t'i caktohen një OPGJ-je tjetër. Në këtë mënyrë, prokurori do të inkurajojë konkurrencën e shëndetshme mes OPGJ-ve dhe do të tregojë vlerësim për kontributin që çdo OPGJ jep në hetim.

OPGJ duhet të ndiejë se mund t'u besojë prokurorëve. Një nga elementët kryesorë për rritjen e besimit është transparenca, kështu që prokurori duhet të jetë transparent me OPGJ-në, duke ndarë me ta vështirësitë me të cilat përballen në hetim dhe kur është e mundur, duke përfshirë OPGJ-në në marrjen e vendimeve që do të kenë ndikim të rëndësishëm në hetim. Gjithashtu, mirëpritja e sugjerimeve nga OPGJ-ja do të rrisë cilësinë e punës së prokurorit dhe do të ndërtojë marrëdhënie më të forta dhe të besueshme.

# PJESA III

## ANEKSE

Anekset e mëposhtme ofrojnë instrumente dhe mjete praktike për tema dhe veprime specifike që do të ndërmerren. Disa nga Anekset janë programe kompjuterike të bëra posaçërisht, që korrespondojnë me legjislacionin shqiptar dhe janë të përshtatshme për përdorim nga profesionistët. Të tjerat ofrojnë udhëzime dhe ide se si të trajtohen çështje specifike. Anekset përmbajnë shënime shpjeguese të cilat ofrojnë udhëzime praktike për qëllimin dhe përdorimin e duhur.

## **Aneksi I Udhëzim i Përgjithshëm për Policinë Gjyqësore**

Udhëzimi i Përgjithshëm për policinë gjyqësore mund të trajtojë dhe parashikojë rregulla për problemet më të dukshme dhe vështirësitë praktike që ndodhin gjatë hetimeve.

### **Kuadri ligjor përkatës për miratimin e Udhëzimit të Përgjithshëm për policinë gjyqësore**

Këshillohet që Prokurori i Përgjithshëm të miratojë Udhëzimin e Përgjithshëm për policinë gjyqësore që të garantojë uniformitetin e veprimeve më të rëndësishme që kryen policia gjyqësore. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e mëposhtme: neni 3 paragrafi 1; neni 38 paragrafi 2-dh dhe 2-g; Neni 46 paragrafët 1, 2, 3-a dhe 4 i Ligjit nr. 97/2016 për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë; neni 3 paragrafi 1-dh; neni 5 paragrafi 2, neni 7 paragrafët 1 dhe 6; Neni 8; neni 21 paragrafët 1 dhe 3; neni 22 paragrafët 3 dhe 4; neni 33 paragrafi 4 i ligjit nr. 25/2019 për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore dhe neni 103; neni 104 dhe neni 279 paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Kur bëhet fjalë për Prokurorin e Posaçëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të nxjerrë Udhëzim të Përgjithshëm që rregullon të njëjtat çështje duke marrë parasysh nenin 5, nenin 15 paragrafët 2-a, 2-e dhe 2-ë e ligjit nr. 95/2016 për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe nenin 3 paragrafi 1-dh; nenin 5 paragrafi 2, nenin 7 paragrafët 1 dhe 6; nenin 8; nenin 21 paragrafët 1 dhe 3; nenin 22 paragrafët 3 dhe 4; nenin 33 paragrafi 4 të ligjit nr. 25/2019 për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore dhe nenin 103; nenin 104 dhe nenin 279 paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale.

### **Përmbajtja e Udhëzimit të Përgjithshëm**

Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të trajtojë të gjitha pyetjet që mbeten hapur në lidhje me bashkëpunimin mes OPGJ-ve dhe prokurorëve, si varësia e dyfishtë e OPGJ-së dhe zinxhiri i komandës gjatë hetimeve, transferimi dhe komandimi i OPGJ, protokollat e komunikimit, shkëmbimi i praktikave më të mira, referimi nga policia, etj. Këshillat në lidhje me referimin nga

policia përfshihen në Aneksin II dhe mund të rregullohen me një Udhëzim të Përgjithshëm të veçantë ose si pjesë e Udhëzimit të Përgjithshëm për Policinë Gjyqësore.

### 1. Dispozita të përgjithshme

Qëllimi i Udhëzimit të Përgjithshëm për Policinë Gjyqësore është të nxisë kulturën e objektivit të përbashkët, të unifikojë veprimtaritë e policisë gjyqësore dhe të krijojë hierarki të qartë gjatë hetimeve, duke mundësuar komunikim dhe bashkëpunim më të mirë mes policisë gjyqësore dhe prokurorëve.

Objektivat që duhet të synojë të arrijë Udhëzimi i Përgjithshëm për policinë gjyqësore janë:

- Rritja e nivelit të bashkëpunimit mes OPGJ dhe prokurorit
- Rritja e nivelit të ruajtjes së fshehtësisë së hetimeve
- Përmirësimi i kulturës së objektivit të përbashkët dhe qasjes së përbashkët në hetime
- Garantimi i qëndrueshmërisë më të madhe në hetime

### 2. Zinxhiri i komandës

Çështja e zinxhirit të komandës gjatë hetimeve sjell shumë sfida në praktikën e përditshme, prandaj është thelbësore që Udhëzimi i Përgjithshëm të merret me këtë çështje. Ligji përcakton qartë që gjatë hetimeve OPGJ-të japin llogari para prokurorëve<sup>156</sup>. Megjithatë, realiteti është që OPGJ-ja e shërbimeve kryen veprimtari të tjera përveç hetimeve dhe janë edhe nën varësinë e drejtuesit të policisë. Kështu, udhëzimi i përgjithshëm duhet të përmbajë **rregulla të qarta se si të kapërcehet mbivendosja e detyrave të OPGJ-ve gjatë hetimeve.**

Një mundësi është që pasi informacioni i referimit të veprës penale të jetë pranuar nga prokurori dhe të regjistrohet procedimi, prokurori të informojë drejtuesin e drejtorisë së policisë ku ndodhet OPGJ për nevojën që OPGJ-ja i caktuar të përfshihet në hetim. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat personale të OPGJ-së, numrin e çështjes ku do të përfshihet OPGJ-ja dhe kohën e parashikuar të përfshirjes së OPGJ (për shembull 3 muaj

<sup>156</sup> Neni 7 i Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore

me veprimtari me kohë të pjesshme, përfshirje të plotë për një muaj, etj.). Është e rëndësishme që drejtuesi i policisë i OPGJ-së të informohet se cili OPGJ që ka paraqitur informacionin e referimit është i përfshirë në hetime. Gjithashtu, informacioni në lidhje me hetimin ku është i përfshirë OPGJ-ja duhet t'i jepet drejtuesit të policisë së OPGJ-së, duke treguar emrin e prokurorisë, numrin e procedimit dhe emrin e prokurorit kompetent. Duhet të theksohet se drejtuesi i policisë duhet të mbajë një evidencë të të gjithë OPGJ-ve që kanë paraqitur informacione referimi në mënyrë që të kenë mundësi të ndjekin përfshirjen e tyre të mëtejshme në hetime.

Mund të jetë e dobishme të përfshihen rregulla për caktimin e detyrave të reja për OPGJ-të që janë përfshirë tashmë në hetime. Për shembull: drejtuesit e policisë duhet të kërkojnë mendim me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë përpara se të përfshijnë në veprimtari të tjera administrative ose policore OPGJ-në që është përfshirë tashmë në më shumë se 5 hetime, duke përshkruar nevojën e përfshirjes së tyre dhe kohën e parashikuar për veprimtarinë, duke treguar në të njëjtën kohë numrat e çështjeve të procedimeve ku është përfshirë OPGJ-ja. Drejtuesi i prokurorisë, pasi mbledh informacion nga prokurorët mbi hetimet ku është përfshirë OPGJ-ja shkruan një opinion për disponueshmërinë e tij. Drejtuesi i policisë është i detyruar të përshtasë detyrat e OPGJ, duke marrë parasysh opinionin e drejtuesit të prokurorisë.

Gjithashtu, duhet të vendosen **rregulla për atë që OPGJ mund t'i raportojë drejtuesit të policisë në lidhje me hetimet**. Rrjedhimisht, OPGJ-të duhet të raportojnë numrin e procedimit ku janë përfshirë dhe informacion të përgjithshëm mbi subjektin e hetimit (p.sh. lloji i veprës penale, ngjarja kriminale e kallëzuar, etj.). OPGJ-ja nuk duhet të bëjë me dije drejtuesin e tij të policisë në lidhje me veprime hetimore të urdhëruara nga prokurorët, provat e mbledhura, faktet nga provat si dhe fakte dhe informacione të tjera të çështjes. Nëse prokurori konstaton se ky informacion mund të ndahet me drejtuesit e policisë, atëherë prokurori mund të dërgojë informacion me shkrim që përmban këto detaje. Gjithashtu, drejtuesve të policisë të OPGJ-ve duhet t'u jepet mundësia të kërkojnë informacion shtesë nga prokurori në lidhje me hetimet specifike në bazë të kërkesës së arsyetuar me shkrim. Prokurori mund të japë informacionin e nevojshëm nëse nuk pengon hetimin.

Duhet të trajtohet edhe bërja e kopjeve të dokumenteve nga policia. Disa sugjerime janë dhënë tashmë në Manual, por mirëprehen masa të mëtejshme për të parandaluar krijimin e dosjeve që do të përmbajnë të

njëjtat dokumente si fashikulli i prokurorit. Për shembull, përveç rregullave për shpërndarjen e informacionit brenda policisë, duhet të vendosen rregulla për të mbajtur nën kontroll se kush mund të njihet me informacion dhe kur.<sup>157</sup>

Është e nevojshme të përcaktohen (i) **rregullat e raportimit** mbi përfshirjen e OPGJ-së dhe kohën efektive të shpenzuar për hetime, si edhe (ii) rregullat e raportimit për cilësinë e punës së OPGJ-së gjatë hetimeve. Kjo do të kërkonte prezantimin e procedurave për të monitoruar kohën që OPGJ u kushton hetimeve dhe për të vlerësuar rezultatet e punës së tyre.

Ndjekja e veprimtarisë<sup>158</sup> së OPGJ-së përfshin llogaritjen e kohës së nevojshme nga OPGJ për të përfunduar veprimet hetimore. Gjithashtu, prokurorët duhet të raportojnë çdo muaj te drejtuesi i prokurorisë mbi statistikën në lidhje me veprimtarinë e OPGJ-së. Drejtuesi i prokurorisë pasi mbledh statistikën, mund t'i dërgojë raport mujor drejtuesit të policisë. Ky raport duhet të përmbajë një përfundim të përgjithshëm rreth kohës që OPGJ i ka kushtuar hetimeve, duke paraqitur numrin e hetimeve ku është i përfshirë OPGJ.

Sa i përket cilësisë së punës, prokurorët duhet të informojnë çdo vit<sup>159</sup> drejtuesin e prokurorisë në lidhje me cilësinë e përgjithshme të punës së OPGJ-së, duke vlerësuar punën e secilit OPGJ në mënyrë të pavarur, duke përshkruar pikat e forta dhe të dobëta të OPGJ-së. Prokurorët duhet të përfshijnë mendimin e tyre nëse koha që OPGJ ka shpenzuar për veprimet e caktuara hetimore mund të konsiderohet efektive ose nëse prokurori beson se veprimtaria mund të ishte kryer më shpejt. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet cilësisë së referimeve nga OPGJ-ja, duke marrë parasysh kërkesat për referim cilësor të përcaktuara në KPP dhe Udhëzimin e Përgjithshëm për referimin.

Raportimi mbi përfshirjen e OPGJ-së dhe cilësinë e punës duhet të standardizohet. Formatet tip dhe modelet e vlerësimit duhet të përfshihen në aneksin/aneksat e Udhëzimit të Përgjithshëm.

---

157 Parimi i nevojës për të marrë dijeni duhet të zbatohet në lidhje me të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një dosje penale, pavarësisht nëse mund të mos çojnë në hetim penal.

158 Manuali përmban sugjerime për ndjekjen e veprimtarisë së OPGJ-së gjatë hetimit. Formatet për ndjekjen e veprimtarisë jepet në Aneksin IV gjithashtu.

159 Neni 29 paragrafi 2 i Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore

### 3. Lëvizshmëria gjatë hetimeve

Një çështje tjetër që ndodh shpesh dhe shqetëson profesionistët është transferimi dhe komandimi i shpesh të OPGJ-ve.<sup>160</sup> Meqenëse kuadri ligjor aktual parashikon pak rregulla në këtë drejtim, këshillohet që kjo çështje të rregullohet në Udhëzimin e Përgjithshëm.

Qëllimi kryesor do të jetë dhënia e informacionit për prokurorinë në rastet kur ndodh transferimi ose komandimi i OPGJ-së. Meqenëse Ligji<sup>161</sup> dallon dy faza të procedurave të transferimit dhe komandimit, ekzistojnë dy mundësi për të trajtuar këtë çështje.

E para është trajtimi i fazës së propozimit të transferimit dhe komandimit, ndërsa e dyta është trajtimi i fazës së vendimit mbi transferimin ose komandimin e OPGJ-së.

Prandaj, Prokurori i Përgjithshëm ose institucioni shtetëror përkatës përpara se të propozojë dhe të vendosë mbi transferimin ose komandimin duhet të mbledhë të dhëna (i) nëse OPGJ ka paraqitur tashmë informacione referimi për krime, (ii) emrin e prokurorisë ku OPGJ ka paraqitur referimet, (iii) nëse OPGJ është përfshirë në hetime të vazhdueshme dhe (iv) emrin e prokurorisë ku po kryhen hetimet që përfshijnë OPGJ-në.

Në të dy rastet, pas marrjes së informacionit fillestar, një opinion me shkrim duhet të kërkohet nga prokurori që drejton hetimin në të cilin është përfshirë OPGJ ose për të cilin është paraqitur informacion referimi nga OPGJ.<sup>162</sup> Opinioni i prokurorit duhet t'i referohet ndikimit të transferimit ose komandimit të OPGJ-së në hetim. Nisur nga kjo, prokurori, me një akt të arsyetuar me shkrim, mund të kërkojë që transferimi ose komandimi të shtyhet në një kohë të mëtejshme, të përshtatshme (p.sh.:deri në përfundimin e veprimtarive të nevojshme). Akti me shkrim i prokurorit duhet të përmbajë të dhënat personale të OPGJ-së, informacion të përgjithshëm në lidhje me hetimin në të cilin është përfshirë OPGJ, shpjegimin se pse OPGJ është i domosdoshëm për hetimin dhe afatin kohor gjatë të cilit pritet përfshirja e OPGJ-së për përfundimin e hetimit. Autoriteti propozues<sup>163</sup> ose autoriteti vendimmarrës<sup>164</sup> për transferimin ose komandimin duhet të marrë në konsideratë mendimin e prokurorit.

160 Rritja e Bashkëpunimit dhe Koordinimit ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në Shqipëri, OSBE, Tiranë 2019 <https://www.osce.org/files/f/documents/3/f/442660.pdf>

161 Neni 21 dhe neni 22 i Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore.

162 Opinioni për çështje për të cilat është depozituar vetëm informacioni i referimit mund të jetë i rëndësishëm në çështje komplekse, ku policia ka ndërmarrë një sërë veprimesh përpara paraqitjes së informacionit të referimit dhe është mbledhur sasi e madhe provash.

163 Prokurori i Përgjithshëm ose institucioni shtetëror përkatës.

164 Komisioni i Policisë Gjyqësore.

#### 4. Protokollat e komunikimit

Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të përmbajë rregulla që trajtojnë protokollin e komunikimit mes OPGJ-së dhe prokurorisë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që komunikimi është një temë që duhet të rregullohet me detaje për të parandaluar rrjedhjen e informacionit, mund të jetë më praktike të konsiderohet miratimi i një Udhëzimi të Përgjithshëm të veçantë për komunikimin.

Protokolli i komunikimit duhet t'u japë përgjigje pyetjeve:

- ⦿ **kush** duhet të marrë dijeni (duke përcaktuar marrës të mundshëm të informacionit)
- ⦿ **çfarë** informacioni u nevojitet atyre (duke përcaktuar atë që mund t'u dërgohet marrësve - p.sh. : urdhri i hetimit, urdhri i sekuestrimit, akte të tjera, informacioni në lidhje me rezultatin e procedimit penal, etj.)
- ⦿ **pse**-ja që qëndron pas informacionit (duke shpjeguar arsyen pas një iniciative ose qëllimi të caktuar që supozohet të arrijë - p.sh.: me anë të informacionit të dhënë pritet të kryejë veprimtari hetimore, të zgjidhë çështje organizative, të informohet, etj.).
- ⦿ **kur** duhet ta dinë (përcaktoni mundësitë kur do të jepet informacioni), dhe
- ⦿ **si** do t'u jepet atyre informacioni.

Në këtë këndvështrim, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të përmbajë **rregulla se si merret informacioni në prokurori**, duke bërë një dallim të momentit kur informacioni vjen për herë të parë dhe kur bëhet fjalë për një informacion vijues. Rregullat duhet të përcaktojnë se kush e merr informacionin, çfarë informacioni duhet të dijë marrësi dhe pse. Gjatë hartimit të këtyre rregullave, duhet të kihet parasysh se rregullat duhet të ndjekin **parimin e nevojës për të marrë dijeni**, duke u siguruar që vetëm personat që kanë nevojë të njihen me një lloj të caktuar informacioni, të kenë qasje vetëm në atë informacion. Kjo nënkupton shtresëzimin e informacionit<sup>165</sup> që po dërgohet, kështu që formatet tip për komunikimin dhe ndarjen e informacionit mund të përshkruhen si një Aneks i Udhëzimit të Përgjithshëm.

Për shembull, përmbajtja e referimit të policisë nuk është një informacion me të cilin duhet të njihet stafi administrativ i policisë dhe

<sup>165</sup> Shtresëzimi i informacionit do të thotë ndarje e informacionit në shtresa në mënyrë të tillë që në një moment të caktuar të shihet vetëm një shtresë e informacionit.



prokurorisë që dërgojnë/marrin referimin. Parimi i nevojës për të marrë dijeni do të thotë që stafi administrativ duhet të njihet vetëm me informacionin e dokumentit që bën të mundur të kryejnë punës së tyre siç duhet. Prandaj, duhet të përgatitet një format tip për referimin e policisë. Format i tip mund të kërkojë që përmbajtja e referimit të ndahet nga faja e parë, ku duhet të përfshihet vetëm informacion i përgjithshëm.<sup>166</sup> Të gjitha detajet në lidhje me ngjarjen që raportohet, veprimtaritë e ndërmarra, provat e mbledhura, etj., duhet të jepen në faqet e tjera. Stafi administrativ në polici dhe prokurori duhet të njihet vetëm me informacionin e dhënë në faqen e parë. Mund të parashikohet mundësia për të vulosur përmbajtjen e referimit në një zarf, duke lënë të dukshme vetëm faqen e parë.

Gjithashtu, duhet të parashikohen rregullat në lidhje me dhënien e llojeve të tjera të informacionit që i dërgohen prokurorisë me shkrim. Rregullat duhet të përmbajnë kërkesa për vlefshmërinë e informacionit të dërguar në prokurori (p.sh. vula, nënshkrimi, mundësia për dërgimin e kopjeve etj.).

Më tej, Udhëzimi duhet gjithashtu të parashikojë rregulla për komunikimin gjatë hetimit dhe mënyrën e dërgimit të informacionit nga prokuroria. Për shembull, mund të ketë disa mundësi kur bëhet fjalë për dërgimin e urdhrin të hetimit tek OPGJ<sup>167</sup>:

- ⊙ Prokurori mund të dërgojë urdhrin e hetimit tek OPGJ përmes Prokurorisë, në një zarf të mbyllur, të shoqëruar me shkresë përcjellëse për dorëzimin e urdhrin të hetimit. Shkresa duhet të përmbajë vetëm informacionin bazë si emrin e OPGJ-së të cilit duhet t'i dorëzohet urdhri i hetimit; numrin e çështjes në prokurori; detaje themelore në lidhje me ngjarjen kriminale dhe të dyshuarin(t); ose informacion tjetër që nuk dëmton hetimin. Prokurori duhet gjithashtu të theksojë që përmbajtja e urdhrin të hetimit duhet t'i bëhet me dije vetëm OPGJ-së
- ⊙ Prokurori mund t'ia dorëzojë urdhrin e hetimit OPGJ-së drejtpërdrejt, duke u siguruar që askush përveç OPGJ të mos informohet për

166 Për shembull, një paraqitje e llojit të referimit (nëse është informacion referimi i veprës penale, apo relacion shpjegues) dhe detaje të tjera të nevojshme për të regjistruar referimin në sistemin e menaxhimit të çështjes (emri i personit të dyshuar; vepra penale e referuar; emri i viktimave ose personave të dëmtuar; etj.)

167 Mundësia për disa alternativa është zgjidhja e preferuar sepse praktika aktuale e dërgimit të çështjeve përmes rrugëve zyrtare, bën të mundur që një numër i pakontrolluar i personave të njihen me dosjen e çështjes dhe të rrezikohet fshehtësia e hetimit. Në vend të kësaj, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të parashikojë mënyra të ndryshme të dorëzimit të informacionit gjatë hetimeve.

përmbajtjen e urdhrin të hetimit

- Prokurori mund të dërgojë urdhrin e hetimit në mënyrë të rregullt, duke dërguar urdhrin përmes prokurorisë në një zarf të hapur, duke mos kufizuar personat që mund të informohen për përmbajtjen e urdhrin të hetimit

**Rregullat në lidhje me mbajtjen e dosjes së çështjes** mund të parashikohen gjithashtu. Prokurori mund të vendosë të mbajë dosjet e çështjes në zyrën e tij/saj dhe t'i komunikojë OPGJ-së vetëm urdhrin e hetimit dhe veprimet hetimore që duhet të ndërmerren. Në rastë si ky, prokurori, pasi informohet që OPGJ ka kryer të gjitha veprimet e kërkuara hetimore dhe të gjitha verifikimet e nevojshme, duhet të ftojë OPGJ-në në zyrë në mënyrë që OPGJ të përgatisë relacionin shpjegues. Po kështu prokurori gjithashtu mund të vendosë t'i dërgojë OPGJ-së dosjet e çështjes së bashku me urdhrin e hetimit. Në këtë rast, dërgimi i dosjes së çështjes mund të bëhet në të njëjtën mënyrë si dërgimi i urdhrin të hetimit, duke nënvizuar faktin nëse ndonjë person tjetër përveç OPGJ-së ka të drejtë të njihet me informacionin e dosjes së çështjes.

Udhëzimi duhet të përmbajë rregulla se ku do të mbahen provat e mbledhura gjatë hetimit. Rregulli themelor duhet të jetë që provat të mbahen së bashku me dosjen e çështjes. Mund të bëhet përjashtim nga ky rregull, në varësi të llojit të provave të mbledhura ose ndjeshmërisë dhe konfidencialitetit të provave.

Gjatë hartimit të protokollit të komunikimit, udhëzimi i përgjithshëm duhet të parashikojë vetëm rregulla të përgjithshme dhe mundësi të shumta, duke i lënë prokurorit kompetenca diskrecionare për të zgjedhur opsionin më të përshtatshëm në varësi të rrethanave të secilës çështje.<sup>168</sup> Sidoqoftë kjo nuk prek mundësinë e përfshirjes së një sërë rregullash në lidhje me veprimtaritë e detyrueshme (p.sh.: rregullat kur prokurori është i detyruar të mbajë fashikullin e çështjes në zyrën e tij ose kur prokurori është i detyruar t'i dërgojë drejtpërdrejt aktet tek OPGJ duke u siguruar që vetëm OPGJ të njihet me to). I tillë mund të jetë rahti që ka të bëjë me çështje me interes të lartë publik, abuzim me autorizimin policor, etj.

---

<sup>168</sup> Duke i dhënë kompetencë diskrecionare prokurorit që të vendosë mbi mënyrën e dërgimit tek OPGJ kompetent të urdhrin dhe materialeve mbështetëse, prokurorit i jepet mundësia që të vendosë se cilat materiale do të ndahen me OPGJ dhe cilat jo, duke i dhënë mundësi që të ketë kontroll mbi fshehtësinë e hetimit dhe të mbajë përgjegjësi për çdo çështje në mënyrë të pavarur pa u fshehur pas Udhëzimit të Përgjithshëm.

## 5. Ndërtimi i kapaciteteve në kuadër të hetimit

Dy aspekte kryesore mund të kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve brenda hetimit që nuk do të kërkojnë trajnime, por do të bazohen në shkëmbimin e përvojave mes pjesëmarrësve në hetime.

I pari është përgatitja e një publikimi me **nisma dhe praktika më të mira të oficerëve të policisë, i cili tashmë është përmendur në Manual**. Përveç sugjerimeve të dhëna në Manual, udhëzimi i përgjithshëm mund të parashikojë rregulla mbi raportimin e praktikave dhe nismave më të mira dhe publikimin e botimeve elektronike, si për shembull periudhat kohore për nxjerrjen e këtyre botimeve - çdo tre muaj, dy herë në vit, çdo vit - dhe procedurat e brendshme për raportimin e praktikave më të mira brenda prokurorisë.

**Grupet e përbashkëta** që përbëhen nga OPGJ të seksioneve dhe OPGJ të shërbimeve mund të kontribuojnë gjithashtu në shkëmbimin e përvojave dhe ndërtimin e kapaciteteve në kuadër të një hetimi. Kështu, Udhëzimi i Përgjithshëm mund të parashikojë rregulla se kur preferohet të formohet një grup i tillë i përzier<sup>169</sup>, duke u dhënë prokurorëve udhëzime për situatat kur këto grupe mund të sjellin një vlerë të shtuar në hetim. Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të rendisë mundësinë për këto grupe, duke i lënë prokurorit kompetencën diskrecionare për të vendosur mbi krijimin e tyre.

169 Për shembull, në situata ku duhet të kryhen veprime në terren (p.sh.: ekzekutimi i urdhër kontrollit, urdhër sekuestrimit); gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe dëshmitarëve, ku OPGJ i shërbimeve mund të kontribuojë me inteligjencë nga terreni ndërsa OPGJ i seksionit mund të sigurohet që janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore, etj.

## **Aneksi II Udhëzim i Përgjithshëm për Referimin e Policisë**

Referimet e policisë gjatë hetimeve kanë përdorime të ndryshme: (i) ndihmojnë në identifikimin e kriminelëve<sup>170</sup>; (ii) shërbejnë si procesverbale hetimore<sup>171</sup>; (iii) ndihmojnë në përgatitjen për gjykatë<sup>172</sup>, etj. Siç shpjegohet në manual, udhëzimi i përgjithshëm për referimin nga policia duhet të përmbajë dy pjesë kryesore: një për informacionin e referimit të veprës penale dhe një për relacionin shpjegues.

### **Kuadri ligjor përkatës për miratimin e Udhëzimit të Përgjithshëm për Referimin e Policisë**

Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin e Policisë nëse nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm, është detyrues për OPGJ<sup>173</sup>. Në rastin kur PP miraton Udhëzim të Përgjithshëm për Referimin e Policisë, zbatohen këto dispozita: neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 paragrafi 1; neni 38 paragrafi 2-dh dhe 2-g; neni 46 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë; neni 7 paragrafi 6 i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore; neni 281 paragrafi 4 dhe neni 293 i Ligjit për Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Nëse Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin nga Policia nxirret nga drejtuesi i prokurorisë, zbatohen këto dispozita: neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 42 paragrafi 1-a, 1-b, 1-e dhe 1-gj; neni 46 paragrafi 4 i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë; neni 281 paragrafi 4 dhe neni 293 i Ligjit për Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Nëse Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin nga Policia nxirret nga Prokurori i Posaçëm, zbatohen dispozitat e mëposhtme: Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 15 paragrafi 2-a, 2-e dhe 2-ë i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; neni 281 paragrafi 4 dhe neni 293 i

170 Referimi nga policia mund të shërbejë si dokument burimor për fillimin e hetimit penal, si edhe dokument burimor që ofron bazën për veprimtari të mëtejshme hetimore, që mund të ndihmojë me identifikimin, kapjen dhe ndjekjen penale të kriminelëve.

171 Referimi nga policia ndihmon prokurorët duke iu dhënë procesverbale të të gjitha veprimeve hetimore të ndërmarra dhe provave të mbledhura gjatë hetimit penal.

172 Referimi nga policia mund të ndihmojë OPGJ-në duke rifreskuar kujtesën e tyre në rast se ata do të dëshmojnë në seanca paraprake.

173 Neni 7 paragrafi 6 i Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore.

Ligjit për Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

## Përmbajtja e Udhëzimit të Përgjithshëm

Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin e Policisë duhet të përcaktojë qëllimin e miratimit të tij dhe objektivat kryesore që synon të arrijë, duke përcaktuar rregulla mbi referimin fillestar nga policia dhe rregulla mbi relacionin shpjegues të policisë, duke trajtuar pyetjet e përmbajtjes së referimit, cilësinë e referimit, paraqitjen e provave, procedura për dorëzimin e referimit, etj.

### 1. Dispozita të përgjithshme

Qëllimi i Udhëzimit të Përgjithshëm për Referimin e Policisë është të përmirësojë cilësinë e referimit nga policia në hetime, duke vendosur rregulla të qarta dhe koncize për përmbajtjen e referimeve, paraqitjen e provave dhe mjetet e komunikimit për qëllime referimi.

Objektivat që duhet të synojë të arrijë Udhëzimi i Përgjithshëm për Referimin e Policisë janë:

- ⊙ Rritja e nivelit të njohurive ligjore OPGJ-ve
- ⊙ Garantimi i uniformitetit në referimin nga policia
- ⊙ Përcaktimi i një procedure për depozitimin e referimeve nga policia

### 2. Informacioni i referimit nga policia

Informacioni fillestar i referimit nga policia është raporti që policia i dërgon prokurorisë, duke informuar prokurorin për dyshimin mbi ekzistencën e një vepre penale. Kur bëhet fjalë për referimin fillestar nga policia, KPP jep vetëm rregulla të përgjithshme në lidhje me përmbajtjen e referimit, duke deklaruar se referimi përmban elementet thelbësore të aktit dhe elementët e tjerë të mbledhur deri në atë moment, duke treguar burimet e provave dhe veprimet e ndërmarra. KPP gjithashtu parashikon që të gjitha aktet dhe provat e mbledhura duhet të dërgohen së bashku me referimin.<sup>174</sup> Për të përmbushur me sukses detyrimin e tyre të përcaktuar në KPP, OPGJ ka nevojë për udhëzime të qarta se si të hartojë një referim policor.

<sup>174</sup> Neni 293 i KPP

Në këtë aspekt, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet së pari të **përcaktojë cilësitë që duhet të ketë informacioni i referimit**. Informacioni i referimit duhet të pasqyrojë ngjarjen kriminale dhe detajet e veprës penale specifike.<sup>175</sup>

Më pas, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të **përcaktojë qëllimin e referimit**. Oficerët e policisë gjyqësore kur shkruajnë një informacion referimi gjithmonë duhet t'u përgjigjen pyetjeve **kush, çfarë, ku, kur, si dhe pse**.<sup>176</sup> Do të ishte e dobishme që Udhëzimi i Përgjithshëm të përmbajë një Shtojcë me shembuj të fakteve specifike dhe informacionit që mund të përfshihen në pjesën e referimit për të ndihmuar në dhënien e përgjigjeve për gjashtë pyetjet.

Pas dhënies së rregullave për cilësinë e referimit dhe qëllimin e referimit, udhëzimi i përgjithshëm duhet të **përcaktojë përmbajtjen e referimit**.<sup>177</sup> Në përgjithësi, referimi duhet të japë informacion në lidhje me ndodhinë e ngjarjeve kriminale dhe informacion se si ngjarja përbën një vepër penale, veprimet e kryera nga OPGJ dhe personat e identifikuar dhe pasurinë e lidhur me ngjarjen kriminale. Gjatë hartimit të një informacioni referimi, pas deklarimit të faktit, OPGJ duhet të tregojë provat që vërtetojnë ekzistencën e këtij fakti.

Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të përmendë **kërkesat shitesë që mund të ndikojnë në cilësinë e referimit**. Duhet të theksohet se për hartimin e raportit duhet të përdoret gjuha e duhur, pasi është e rëndësishme të përdoret saktë gramatika dhe fjalori për të shmangur keqkuptimet. Gjithashtu, kur është e mundur, oficeri i policë duhet të korrigjojë informacionin e referimit përpara se ta dërgojë.<sup>178</sup>

Përveç informacionit të referimit, oficerët e policisë duhet të paraqesin të gjitha aktet dhe provat e mbledhura. Prandaj, udhëzimi i përgjithshëm duhet të përmbajë **disa rregulla për organizimin dhe paraqitjen e provave**. Ka disa mënyra të ndryshme për të organizuar provat: (i) në mënyrë kronologjike sipas radhës së ndodhisë së ngjarjeve; (ii) në mënyrë kronologjike sipas radhës të mbledhjes së provave; (iii) në varësi të burimit

<sup>175</sup> Detajet mbi cilësinë që duhet të ketë informacioni efektiv i referimit të veprës penale i gjeni në: [https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/\\_internal/\\_documents/rwm.pdf](https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/_internal/_documents/rwm.pdf)

<sup>176</sup> Më shumë detaje mbi llojin e pyetjeve që duhet të bëhen dhe mënyrës se si, mund të gjeni në: [https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/\\_internal/\\_documents/rwm.pdf](https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/_internal/_documents/rwm.pdf)

<sup>177</sup> Disa sugjerime mbi përmbajtjen e referimit i gjeni në: [https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/\\_internal/\\_documents/rwm.pdf](https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/_internal/_documents/rwm.pdf)

<sup>178</sup> Rregulla në lidhje me korrigjimin e informacionit të referimit i gjeni në: [https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/\\_internal/\\_documents/rwm.pdf](https://www.csus.edu/campus-safety/police-department/_internal/_documents/rwm.pdf)

të provave<sup>179</sup> ose (iv) në varësi të fakteve që provat mbështesin. Këshillohet që të miratohet një metodë uniforme, e standardizuar e organizimit të provave gjatë referimit fillestar.

Pyetja e fundit në lidhje me referimin fillestar që duhet të përmbajë Udhëzimi i Përgjithshëm janë **rregullat dhe procedurat për paraqitjen e referimit**. Në këtë fazë është më se e qartë se referimi duhet të dorëzohet në prokurori me shkrim, por duhet të parashikohen rregullat e mëtejshme mbi procedurën e dorëzimit të referimeve me shkrim, si dhe mbi procedurën e referimeve me gojë në raste urgjente. Kur përcaktohet procedura për referimet me gojë, duhet të adresohen edhe pyetjet se kur kjo është e pranueshme, si do të regjistrohet referimi dhe si do të vazhdojë procedura<sup>180</sup>. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se këto pyetje mund të jenë pjesë e Udhëzimit të Përgjithshëm për Komunikimin. Kjo duhet të merret parasysh për të shmangur mbivendosjen e rregullave dhe rregullimin e së njëjtës temë në Udhëzime të Përgjithshme të ndryshme.

Një gjë tjetër që ka rëndësi të madhe për t'u përfshirë në Udhëzimin e Përgjithshëm janë rregullat në lidhje me **mosrespektimin nga ana e oficerëve të policisë të standardeve të përcaktuara në Udhëzimin e Përgjithshëm**. Mundësia për të kërkuar sqarime nga oficerët e policisë që kanë paraqitur referimin është përmendur në Manual dhe mund të rregullohet më tej. Duhet të parashikohen rregullat se si, kur, në cilin afat kohor dhe në çfarë mase duhen kërkuar sqarimet. Udhëzimi i Përgjithshëm gjithashtu mund të parashikojë një procedurë për informimin e drejtuesit të prokurorisë për të gjitha rastet kur referimet fillestare të policisë nuk plotësojnë standardet dhe rregullat e përcaktuara në Udhëzimin e Përgjithshëm. Drejtuesi i prokurorisë mund të informojë Prokurorin e Përgjithshëm çdo muaj për shkeljet e raportuara të Udhëzimit të Përgjithshëm. Gjithashtu mund të merren masa disiplinore, sepse mosrespektimi i Udhëzimit të Përgjithshëm mund të shkaktojë vonesa të proceseve hetimore.<sup>181</sup>

179 Në varësi të burimit nga i cili janë marrë provat. Për shembull, të gjitha provat e mbledhura në bazë të urdhrut të gjykatës mund të renditen të parat, më pas provat e mbledhura në bazë të urdhrut të prokurorit; pastaj provat e mbledhura nga dëshmitarët etj.

180 P.sh.: a është regjistruar çështja në prokurori në bazë të shërbimit për referim me gojë, apo janë kryer vetëm veprimet urgjente dhe çështja regjistrohet më vonë, me referimin me shkrim.

181 Neni 33 paragrafi 2/a i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore.

### 3. Relacioni përfundimtar i policisë

Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit, së bashku me një relacion shpjegues mbi ngjarjen dhe provat, si dhe sugjerimet e tij/saj për përfundimin e hetimeve.<sup>182</sup> Kështu, relacioni përfundimtar i policisë në fakt është relacion shpjegues që policia i dërgon prokurorit.

Kuadri ligjor ekzistues nuk jep rregulla se çfarë duhet të përmbajë saktësisht relacioni shpjegues. Pra, Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të **përcaktojë përmbajtjen e relacionit shpjegues**, duke përmendur të gjitha elementet që duhet të ketë relacioni. Paraqitja e relacionit shpjegues mund të jetë si më poshtë:

- Të dhëna personale të personit (personave) të dyshuar (nëse zbulohen), që japin informacion në lidhje me emrin, mbiemrin dhe pseudonimin, emrat e prindërve, vendin dhe datën e lindjes, numrin e identifikimit, adresën, vendbanimin, gjendjen gjyqësore, shtetësinë, familjen dhe statusin e punësimit dhe informacione të tjera të rëndësishme
- Detajet dhe përshkrimi i ngjarjeve kriminale, duke përshkruar veçanërisht datën, orën dhe vendin ku ka ndodhur vepra penale, përshkrimin e ngjarjes që përmban elementet e veprës penale, rolin e të dyshuarit në ngjarje, etj.
- Cilësimin juridik të krimit
- Emrin dhe të dhënat e viktimave dhe palëve të dëmtuara
- Detaje mbi shumën e dëmit
- Përshkrimin e të gjitha veprimeve hetimore të ndërmarra
- Përshkrimin e rezultateve të veprimeve hetimore (provat e mbledhura)
- Analizën e provave, duke përshkruar elementin e krimit që vërtetohet me një provë konkrete
- Gjetjet përfundimtare
- Sugjerimet për përfundimin e hetimeve dhe
- Informacion tjetër të rëndësishëm

<sup>182</sup> Neni 327 i KPP



Meqenëse provat duhet t'i bashkëngjiten relacionit, duhet të përcaktohen qartë **rregullat në lidhje me organizimin e provave**. Edhe në rastet kur dosja e çështjes qëndron në zyrën e prokurorit, duhet të ketë rregulla se kush, dhe si, duhet të organizojë provat dhe të përgatisë relacionin shpjegues. Mundësi të shumta duhet të parashikohen në këtë fazë, duke lënë mundësinë që prokurori të vendosë opsionin më të mirë për çështjen konkrete. Përveç rregullave për mënyrën e organizimit të provave, Udhëzimi i Përgjithshëm mund të përmbajë rregulla për materialet e mbledhura gjatë hetimit, që nuk është e nevojshme të përfshihen në raport (p.sh.: deklaratimet e dëshmitarëve që nuk kanë asnjë lidhje me çështjen, informacioni i inteligjencës, etj.).

Duke pasur parasysh që në këtë fazë të hetimeve oficerët e policisë gjyqësore tashmë kanë vendosur komunikim me prokurorët, rregullat për relacionin përfundimtar të policisë duhet të jenë të përgjithshme dhe duhet t'i japin prokurorit kompetenca të mjaftueshme diskrecionare, në mënyrë që të jetë në gjendje të ketë një rol proaktiv në fazën e përgatitjes së relacionit shpjegues dhe t'i japë sugjerime OPGJ-së.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet **mënyrave të paraqitjes së relacionit shpjegues**. Udhëzimi i Përgjithshëm mund të parashikojë rregulla në lidhje me procedurën e dorëzimit të relacionit shpjegues, duke dhënë disa mundësi, nga dërgimi i tij në prokurori, pasi të respektohet e gjithë hierarkia në polici, deri tek dërgimi i tij drejtpërdrejt në prokurori ose drejtpërdrejt prokurorit.<sup>183</sup> Duhet të jepen edhe rregullat në lidhje me dorëzimin e relacionit dhe provave (vendosja e relacionit dhe provave në zarf; kur është e nevojshme të bëhet një dorëzim i till, etj.). Dhënia e disa alternativave për dorëzimin e relacionit shpjegues dhe provave do të bëjnë të mundur që prokurori të përshtasë aktivitetet në secilin hetim në mënyrë të pavarur, të përshtatura për ndjeshmërinë dhe rëndesën e çështjes. Siç u përmend më parë, duhet të mbahet parasysh se kjo çështje mund të jetë pjesë e Udhëzimit të Përgjithshëm për Komunikimin, kështu që duhet të shmangët mbivendosja e rregullave dhe rregullimi i së njëjtës temë në Udhëzime të Përgjithshme të ndryshme.

---

<sup>183</sup> Mund të vendosen rregulla standarde për dorëzimin e relacionit, ku të parashikohet që prokurori mund të sugjerojë forma të tjera të paraqitjes së relacionit. Nëse prokurori nuk e specifikon mënyrën se si duhet të paraqitet relacioni, atëherë zbatohen rregullat standarde.

### **Aneksi III Udhëzim i përgjithshëm për praktikat profesionale**

Në Manual theksohet rëndësia e praktikave profesionale. Praktikave profesionale sjellin përfitime për prokuroritë dhe praktikantët. Praktikave profesionale ofrojnë mundësi për prokuroritë që të zgjerojnë kapacitetin, të shfrytëzojnë ide të reja, inovacionin dhe entuziazmin, të krijojnë marrëdhënie të mira me publikun, të përzgjedhin paraprakisht nëpunës të mundshëm, të krijojnë larmi në fuqinë punëtore dhe t'i japin praktikantit një përvojë pozitive mentorimi. Për praktikantët, praktika profesionale mundëson nxënien e aftësive në vendin e punës, në lidhje me kërkesat e vendit të punës, zhvillimin e rutinës në punë, identifikimin e opsioneve të mundshme të karrierës, të mësojnë se si të krijojnë marrëdhënie me profesionistët, të përjetojnë gjëra të reja, të fitojnë aftësi të reja profesionale dhe të frymëzohen.

#### **Kuadri ligjor përkatës për miratimin e Udhëzimit të Përgjithshëm për Praktikave Profesionale**

Nëse Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikave Profesionale nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm, zbatohen këto dispozita: Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 46 i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, Neni 33 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nëse Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikave Profesionale nxirret nga Drejtuesi i Prokurorisë, zbatohen këto dispozita: Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 paragrafi 1-a, 1-b dhe 1-j i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë; Neni 33 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nëse Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikave Profesionale nxirret nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, zbatohen këto dispozita: Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 15 paragrafi 2-a dhe 2-e i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar; Neni 33 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## Përmbajtja e Udhëzimit të Përgjithshëm

Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikat Profesionale duhet të përcaktojë qëllimin dhe objektivat kryesore që synon të arrijë, duke dhënë rregulla për mënyrën se si do të zhvillohet praktika profesionale, të drejtat, detyrat dhe detyrimet e praktikantëve, kohëzgjatjen e praktikave profesionale, marrëdhëniet midis praktikantëve dhe prokurorit dhe çdo problem tjetër që shfaqet, duke marrë parasysh praktikat profesionale që janë të detyrueshme për kandidatët magjiëstratë dhe nevojën për prezantimin e praktikave për studentët, të sapodiplomuarit në drejtësi dhe profesionistë të tjerë të rinj.

### 1. Dispozita të përgjithshme

Qëllimi i Udhëzimit të Përgjithshëm për Praktikat Profesionale është rregullimi i praktikave në prokurori, duke siguruar përfshirjen e praktikave profesionale brenda strukturës ekzistuese organizative të prokurorisë, duke mundësuar unifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve të praktikantëve, respektim të të gjitha kërkesave procedurale të parashikuara në ligj dhe pasqyrimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve të praktikantëve.

Objektivat që duhet të synojë të arrijë Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikat Profesionale janë:

- ⊙ Dhënia e mundësisë për praktikë profesionale efikase dhe efektive nga kandidatët magjiëstratë dhe profesionistë të tjerë të interesuar
- ⊙ Përkufizimi i të drejtave dhe detyrimeve të praktikantëve, si dhe marrëdhëniet administrative dhe profesionale midis praktikantëve dhe punonjësve të prokurorisë, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, ndalimin e botimit të akteve dhe ruajtjen e sekretit hetimor
- ⊙ Zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e punës dhe rezultateve të praktikantëve.

Udhëzimi i Përgjithshëm duhet të bëjë një dallim të qartë midis (i) praktikës profesionale të kandidatëve magjiëstratë dhe (ii) praktikës së profesionistëve ligjorë dhe profesionistëve të tjerë.

## 2. Praktika profesionale

Praktika profesionale është e përshkruar në Ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kështu që duke pasur parasysh dispozitat e nenit 33, udhëzimi i përgjithshëm duhet të trajtojë çështjet vijuese:

- Parakushtet për kryerjen e praktikave profesionale në prokurori (p.sh. një vendim i Këshillit që përcakton nëse prokuroria do të ofrojë praktikë profesionale për kandidatët magjistratë dhe se do të caktojë një magjistrat mentor për çdo kandidat magjistrat)
- Kohëzgjatjen e praktikës profesionale (12 muaj, duke filluar në korrik dhe duke përfunduar në qershor të vitit pasues)
- Të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve magjistratë (p.sh.: e drejta e pushimit vjetor: 25 ditë pune leje vjetore me pagesë, 15 prej tyre gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin mentor, që miratohen nga drejtuesi i prokurorisë, pas konsultimit me magjistratin mentor; detyrimi për të ruajtur sekretin hetimor, etj.)
- Mënyrën e kryerjes së praktikës profesionale (p.sh.: të përfshihet sa më shumë që të jetë e mundur në aspektet e punës së përditshme të magjistratit mentor, pavarësisht nga fakti që ajo/ai nuk po merr ende funksionin e magjistratit, përfshirë: shpjegime dhe diskutime mbi çështjet në proces; pjesëmarrje në seanca dëgjimore ose intervista; probleme të menaxhimit të çështjeve; përvoja me menaxhimin e dosjeve; përgatitja dhe diskutimi i projektvendimeve, përvoja në administrimin e prokurorisë; aspekte të standardeve etike dhe rregullave të sjelljes për magjistratët; rregulla për gjurmimin e aksesit të kandidatit magjistrat në dosje, performanca në punë, etj.)
- Vlerësimi i praktikës profesionale të kandidatit magjistrat (p.sh.: vlerësimi etik dhe profesional dhe vlerësimi i cilësisë së punës së kandidatit magjistrat, sipas kriterëve dhe notave vlerësuese të përcaktuara në Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe rregullat e nxjerra nga Këshilli, etj.)

## 3. Praktika profesionale e profesionistëve ligjorë dhe të tjerë

Përveç praktikave profesionale, duhet të parashikohen praktikat për studentët e drejtësisë, të sapodiplomuarit në drejtësi, profesionistë ligjorë dhe të tjerë siç janë studentët në fushën e sociologjisë, kriminologjisë, gazetarisë investigative, kontabilitetit për qëllim gjyqësor, etj. Gjatë hartimit

të rregullave për këtë lloj praktike profesionale duhet të kihet parasysh se praktikantët duhet të kuptojnë qartë shtysën e tyre për të marrë pjesë në praktikë. Mënyra më e përshtatshme është hartimi i një programi praktike profesionale që do të përshkruajë avantazhet e praktikantit, njohuritë e kërkuara për të marrë pjesë në programin e praktikës profesionale, kohëzgjatjen e praktikës profesionale, kohën që do të kalohet në sektorin e mbështetjes administrative të prokurorisë, kohën që do të kalohet me prokurorin, detyrat dhe detyrimet që pritet të përmbushen, të drejtat dhe detyrimet e praktikantëve, etj.<sup>184</sup>

Për rrjedhojë, Udhëzimi i Përgjithshëm për Praktikën Profesionale duhet të përmbajë:

- ⊙ Kushtet që kandidati duhet të plotësojë në mënyrë që të pranohet në programin e praktikës profesionale (formimi arsimor dhe kërkesa të tjera si njohuritë bazë të softuerit për redaktimin e tekstit, etj.)
- ⊙ Procedura për aplikim në programin e praktikës profesionale
- ⊙ Një paraqitje e programit të praktikës profesionale (orari i punës për praktikantin, kohëzgjatja e praktikës, lloji i praktikës - me pagesë ose jo; përmbajtja e praktikës, p.sh.: një muaj punë në seksionet administrative të prokurorisë, të paktën tre muaj punë me prokurorin ose OPGJ-në, etj.)
- ⊙ Rregullat për mënyrën e rregullimit të praktikës (nënshkrimi i marrëveshjes së praktikës profesionale me drejtuesin e prokurorisë që do të përfshijë datat e fillimit dhe mbarimit të praktikës; shpërblimin; marrëdhëniet organizative dhe/ose raportuese; detyrat kryesore, detyrat ose përgjegjësitë; kushtet e punës; konfidencialitetin; dhe çdo pritshmëri tjetër; vendosjen e rregullave se kush do të jetë përgjegjës për praktikantin gjatë praktikës, kush mund t'i japë praktikantit detyra të reja, kujt do t'i raportojë praktikanti, kush do të vlerësojë praktikantin, cili do të jetë objekti i vlerësimit, etj.)
- ⊙ Detyrat dhe detyrimet e praktikantit (përshkrimi i detyrave dhe detyrimeve që praktikanti pritet të kryejë, në secilin nga seksionet e prokurorisë në mënyrë të pavarur, për shembull: (i) detyrat administrative si sistemimi i dosjes së çështjes, shkrimi i fletëthirrjeve për dëshmitarët; (ii) detyrat ligjore si shkrimi i urdhrave penalë me kërkesë të prokurorit, mbajtja e procesverbalit të takimeve, kryerja e kërkimit ligjor; (iii) detyrat etike si detyrimi për të raportuar

184 Në fund të dokumentit jepet një shembull i paraqitjes së Programit të Praktikës Profesionale

keqkuptime ose lloje të tjera të problemeve të komunikimit te drejtuesi prokurorisë, etj.)

- ⊙ Të drejtat dhe detyrimet e praktikantëve (përcaktimi i pozicionit të përgjithshëm të praktikantit: përvoja e praktikës profesionale është në të mirë të praktikantit dhe praktikanti nuk zëvendëson nëpunësit e rregullt, por punon nën mbikëqyrje të ngushtë të stafit ekzistues, praktikanti nuk fiton domosdoshmërisht të drejtën për punë në fund të praktikës profesionale dhe informacion nëse praktikanti ka të drejtën e pagës për periudhën e praktikës; e drejta për leje për arsye shëndetësore dhe procedura për të raportuar raportin shëndetësor; e drejta për pushim vjetor dhe procedura për të ushtruar këtë të drejtë; detyrimi për të ruajtur sekretin hetimor; e drejta për t'u njohur me informacion dhe dosje të çështjes dhe masa deri ku praktikanti mund ta ushtrojë këtë të drejtë; detyrimi për t'iu bindur urdhrave dhe kërkesave të prokurorit, etj.)
- ⊙ Përfitimet nga programi i praktikës profesionale (shpërblimet që praktikanti do të marrë nëse përmbush me sukses detyrat dhe detyrimet si pjesëmarrja në një seancë gjyqësore me prokurorin; çfarë aftësish pritet të ketë praktikanti në fund të programit të praktikës; lëshimi i certifikatës për përfundimin e suksesshëm të programit të praktikës nëse plotësohen disa kushte si për shembull kohëzgjatja e praktikës më shumë se 6 muaj, shfaqja e një mendim të përgjithshëm pozitiv për interesin dhe përkushtimin e praktikantit, etj.)

## Shembull: Paraqitje e Programit të Praktikës Profesionale në Prokurori

### Objektivat e programit të praktikës profesionale

Programi i praktikës profesionale në prokurori parashikohet si një proces i dhënies së udhëzimeve dhe trajnimit për praktikantët, ndërkohë që u siguron mbështetje prokurorëve dhe stafit tjetër të prokurorisë. Programi i praktikës profesionale është krijuar për të ofruar njohuri për të kuptuar:

- ⊙ kërkesat procedurale në proceset penale
- ⊙ rolin e prokurorit në sistemin e drejtësisë
- ⊙ terminologjinë e saktë dhe akronimet e përdorura nga prokurorët
- ⊙ bashkëpunimin dhe marrëdhënien mes prokurorisë dhe policisë, etj.

Programi i praktikës profesionale është zhvilluar gjithashtu për të dhënë përvojë praktike në hetime dhe për të rritur nivelin e aftësive profesionale të praktikantëve.

### Përfitimet për praktikantin

Pas pjesëmarrjes në një program praktike profesionale që do t'i japë mundësi praktikantit të punojë në seksionin administrativ të prokurorisë gjatë dy muajve të parë të praktikës dhe të punojë me një prokuror gjatë pjesës tjetër të praktikës, pas përfundimit me sukses të programit të praktikës profesionale, praktikanti:

- ⊙ do të zhvillojë mënyrën e tij të të punuarit
- ⊙ do të mësojë aftësitë në vendin e punës dhe rreth kërkesave të vendit të punës
- ⊙ do të mësojë si të krijojë marrëdhënie me profesionistët
- ⊙ do të mësojë të shkruajë dokumente ligjore dhe të shprehë mendime juridike duke përdorur terminologjinë e saktë
- ⊙ do të përmirësojë aftësitë për kërkim ligjor
- ⊙ do të përmirësojë arsyetimin ligjor
- ⊙ do të përmirësojë aftësitë hetimore
- ⊙ do të përmirësojë aftësitë e tjera profesionale, etj.

## Veprimtaritë e praktikantit dhe burimet në dispozicion të praktikantit

- ⊙ Të lexojë shkresat e çështjeve të arkivuara
- ⊙ Të lexojë referimet e paraqitura nga policia dhe vendimet e prokurorisë me leje të prokurorit
- ⊙ Të marrë pjesë në takimet brenda prokurorisë, kur është i ftuar
- ⊙ Të vëzhgojë punën e prokurorëve dhe OPGJ-ve në prokurori
- ⊙ Të marrë pjesë në kryerjen e detyrave administrative (duke iu përgjigjur telefonatave, duke bërë fotokopje, duke shkruar fletë thirrje dhe njoftime, duke sistemuar dhe përgatitur dosje të çështjeve kur udhëzohet nga një punonjës, etj.)
- ⊙ Të marrë pjesë në diskutime kur është i ftuar të japë kontributin e tij
- ⊙ Të hartojë aktet e prokurorisë dhe vendimet e prokurorisë kur udhëzohet nga prokurori
- ⊙ Të mbajë procesverbale të takimeve
- ⊙ Të ndjekë seancat gjyqësore pas konsultimit paraprak me prokurorin dhe të vëzhgojë gjykimin
- ⊙ Të kryejë kërkime ligjore
- ⊙ Të lexojë ligje, rregullore, manuale, botime profesionale dhe materiale të tjera që mund të mbështesin punën e praktikantit
- ⊙ Të organizojë dhe regjistrojë shkresat
- ⊙ Të zhvillojë diskutime me prokurorët dhe OPGJ për çështje me interes
- ⊙ Të ndihmojë OPGJ të seksioneve kur këshillohet nga prokurori
- ⊙ Të kryejë detyra dhe aktivitete të tjera të caktuara nga një punonjës i prokurorisë ose prokurorët

## Kushtet për t'u pranuar në programin e praktikës profesionale

Programi i praktikës profesionale është i hapur për shtetasit shqiptarë që janë studentë në vitin e fundit të studimeve ose të sapodiplomuar në drejtësi, sociologji, psikologji, gazetari ose kontabilitet, si edhe profesionistë



të rinj, të disiplinave të përmendura, të cilët në momentin e aplikimit nuk janë të punësuar.

Interviçtimi i kandidatëve bëhet nga drejtuesi i prokurorisë. Kandidatët duhet të jenë të vetëdijshëm që mund të bëhet kontroll i integritetit dhe kërkesë për informacion shtesë.

## **Të drejtat dhe detyrimet e praktikantit**

Përvoja e praktikës profesionale është në të mirë të praktikantit dhe praktikanti nuk zëvendëson nëpunësin e rregullt, por punon nën mbikëqyrje të ngushtë të stafit ekzistues. Praktikanti nuk fiton domosdoshmërisht të drejtën për punë në fund të praktikës profesionale.

Praktikanti ka të drejtë lejeje për shkaqe shëndetësore dhe pushim vjetor, sipas konceptit që praktika profesionale është pa pagesë.

Praktikanti është i detyruar të ruajë sekretin hetimor dhe pritjet të respektojë të gjitha detyrimet e parashikuara në ligj dhe në marrëveshjen për pjesëmarrjen në programin e praktikës profesionale.

## **Kohëzgjatja e praktikës profesionale, ditët / orët e punës**

- ⦿ Data e fillimit: 1 tetor 2020, data e mbarimit 1 tetor 2021
- ⦿ E hënë, e martë, e mërkurë, e enjte, e premte nga ora 10:00 deri në 3:00 pasdite
- ⦿ Ditët dhe orët mund të ndryshojnë çdo javë, por orët do të jenë rreth 20-25 orë në javë

## Aneksi IV Fleta e Dokumentimit të Veprimtarisë

### Shënim shpjegues për Fletën e Dokumentimit të Veprimtarisë

Ka dy fletë të ndryshme për dokumentim. Fleta e tretë është e njëjtë me të dytën, vetëm se e përshtatur me afatet kohore për kryerjen e hetimeve në Prokurorinë e Posaçme. Fleta e katërt është lista e gjurmimit të veprimtarisë. Si një mjet praktik, Fleta e Dokumentimit është shtuar në USB e përfshirë në këtë Manual.

**Fleta e parë** është një fletë dokumentimi për verifikimin e referimeve dhe fillimin e procedimit.

Fusha e bardhë në fletë përmban informacionin bazë në lidhje me identifikimin e çështjes, siç është data kur çështja i është caktuar prokurorit dhe numri i çështjes.

Fusha gri në fletë (kolonat D-H) përshkruan fazën e parë të procedurës fazën ku prokurori vendos nëse do të regjistrojë procedimin penal. Nëse prokurori vendos të regjistrojë procedimin, atëherë në kolonën D ai/ajo shënon numrin “1” si tregues se vendimi është marrë. E njëjta gjë vlen për vendimin për të mos filluar procedimin dhe ky fakt shënohet në kolonën E. Në kolonën F shënohet data e vendimit të prokurorit. Kur prokurori jep një vendim, qeliza ku shënohet data bëhet e gjelbër, për të sinjalizuar se çështja është mbyllur, ose procedimi është regjistruar. Kolona G është e bazuar në formulë dhe llogarit automatikisht numrin e ditëve që iu deshën prokurorit për të marrë vendimin. Nëse numri i ditëve kalon 15, qeliza ku po llogaritet numri i ditëve bëhet e kuqe, si kujtesë për të marrë një vendim. Kolona H është e rezervuar për shënime, siç janë numri që merr çështja pasi fillon procedimi.

**Fleta e dytë** është një dokumentim për veprimet e kryera gjatë procedimit penal. Në cepin e sipërm të majtë, shfaqet data aktuale.

Fusha e bardhë e fletës (kolonat B-F) është e rezervuar për informacionin bazë, siç është numri i çështjes, data e regjistrimit të procedimit, krimi i dyshuar<sup>185</sup> dhe numri i personave të dyshuar. Kolona F është e bazuar në formulë dhe llogarit automatikisht numrin e ditëve që

185 Duhet të shënohet vetëm numri i nenit në Kodit Penal. Në këtë mënyrë, përmes filtrimit, mund të mblidhen statistika për krime specifike. Për shembull, jepet mundësia për të listuar vetëm krimet zgjedhore dhe duke përdorur tabelat pivot të nxirren statistika në lidhje me numrin e procedimeve, kohëzgjatjen mesatare të tyre, vendimet e marra etj.

kanë kaluar nga dita e regjistrimit të procedimit deri në ditën e sotme. Janë shtuar 3 opsione ngjyrimi: nëse numri i ditëve që kanë kaluar nga dita kur është regjistruar procedimi është mes 90 dhe 180 ditëve (mes tre dhe gjashtë muajve), atëherë qeliza bëhet e verdhë. Nëse numri i ditëve që kanë kaluar nga dita kur është regjistruar procedimi është mes 180-270 (gjashtë dhe nëntë muaj) qeliza bëhet portokalli dhe nëse numri i ditëve është midis 270 dhe 730 (nëntë muaj deri në dy vjet) qeliza bëhet e kuqe e lehtë. Nëse numri i ditëve kalon 720 (dy vjet) qeliza bëhet e kuqe e errët. Kjo bëhet për të ndihmuar prokurorët që të ndjekin afatet kohore për kryerjen e hetimeve paraprake.

Fusha blu (kolonat G-M) është e rezervuar për të shënuar veprimet gjatë hetimit paraprak. Në kolonën G shënohet fakti nëse është lëshuar urdhri i hetimit, duke shënuar numrin e urdhrave të hetimit që janë lëshuar (1, 2, etj.). Në kolonën H shënohet data e urdhrit të hetimit. Në kolonën I shënohet fakti nëse është bërë arrestitim në flagrancë, duke shënuar numrin e arrestimeve në flagrancë. Nëse gjatë hetimit paraprak kryhet një veprimtari shtesë, ky fakt shënohet në kolonën J, duke shkruar llojin e veprimit hetimor shtesë. Në kolonën K shënohet data e veprimit të fundit të ndërmarrë nga prokurori. Kolona L është një kolonë e bazuar në formulë që llogarit automatikisht numrin e ditëve që kanë kaluar nga veprimi i fundit të kryer. Në kolonën M mund të bëhen shënime.

Fusha me blu të lehtë (kolonat O-X) është e rezervuar për vendimet përfundimtare të prokurorisë gjatë hetimeve paraprake. Prokurorët mund të shënojnë një numër që tregon numrin e vendimeve të dhëna nga prokurori të cilat janë përmendur në fushën me blu të lehtë ose mund të shkruajnë llojin e vendimit përfundimtar të prokurorisë në qelizën 'lloje të tjera vendimesh' nëse opsioni nuk renditet në tabelë. Pastaj në kolonën V shënohet data e vendimit përfundimtar të prokurorisë. Kolona W automatikisht llogarit kohëzgjatjen e procedimeve të ndjekura nga prokurori.

Fusha e gjelbër (kolonat Z-AL) është e rezervuar për të shënuar rezultatin e vendimeve të gjykatës. Kjo tabelë mund të plotësohet duke shtuar numra të llojeve të caktuara të vendimit të dhënë ose prokurori mund të vendosë llojin e vendimit që nuk përmendet në kolonën AJ - lloj tjetër vendimi gjyqësor. Pastaj vendimi i gjykatës vendoset së bashku me shënime, nëse është e nevojshme.

Fusha e verdhë (kolona AN-AS) është e rezervuar për veprime vijuese në rastet kur gjykata ia ka kthyer çështjen prokurorit për veprime të mëtejshme. Në kolonën AN bëhet një përshkrim i veprimeve vijuese,

pastaj në kolonën AO shënohet data e veprimit vijues, pastaj vendimi vijues dhe data e vendimit vijues të marrë nga prokurori. Kolona AR llogarit automatikisht kohëzgjatjen e procedimeve të ndjekura nga prokurori në rastin e veprimeve vijuese. Mund të bëhen edhe shënime.

Fusha me portokalli të lehtë (kolonat AU-CD) është e rezervuar për masat e sigurimit. Për secilën masë sigurimi ka një fushë ku shënohen masat që janë kërkuar, sa prej tyre janë miratuar dhe ditën e fundit të miratimit (pasi këto masa mund të vendosen përsëri). Lidhur me masën e arrestit në shtëpi, arrestit në burg, dhe shtrimin të përkohshëm në spitalin psikiatrik, shtohet një fushë tjetër për datën e përfundimit të masës. Kjo fushë duhet të plotësohet nga prokurori. Një opsion i theksuar automatikisht do të nxjerrë në pah fushën me të verdhë nëse afati mbaron javën tjetër, portokalli nëse afati mbaron në javën aktuale dhe me të kuqe nëse afati mbaron të nesërmen ose atë ditë.

**Fleta e tretë** është një dokumentim për Prokurorinë e Posaçme, sepse afatet e hetimeve janë të ndryshme. Prandaj, përmbajtja, formulat dhe pjesët e ngjyrosura të tjera janë të njëjta me dokumentimin për të gjitha prokuroritë, përveç opsionit të ngjyrosur për numrin e ditëve që kalojnë nga dita e regjistrimit të procedimit. Për këtë janë shtuar 4 opsione ngjyrimi: nëse numri i ditëve që kanë kaluar nga dita e regjistrimit të procedimit është mes 180 dhe 360 ditë (midis gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj), atëherë qeliza bëhet e verdhë. Nëse numri i ditëve që kanë kaluar nga dita e regjistrimit të procedimit është mes 360-450 (dymbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë muaj) qeliza bëhet portokalli, nëse është mes 450-730 (pesëmbëdhjetë muaj dhe dy vjet) qeliza bëhet e kuqe e lehtë dhe nëse është ndërmjet 730-1080 (dy dhe tre vjet) qeliza bëhet e kuqe. Nëse numri i ditëve kalon 1080 (më shumë se tre vjet) qeliza bëhet e kuqe e errët. Kjo bëhet për të ndihmuar prokurorët që të ndjekin afatet kohore për kryerjen e hetimeve paraprake.

**Fleta e katërt** është lista e gjurmimit të veprimtarisë. Lista e veprimtarive është krijuar për të ndjekur veprimtarinë e OPGJ-ve. Dokumenti është organizuar në mënyrë që paraqet të gjitha veprimet që prokurori u ka caktuar oficerëve të policisë gjyqësore dhe afatet për ekzekutimin e tyre. Dokumenti ka formula që llogarisin automatikisht ditën kur skadon afati për veprimin e caktuar hetimor dhe një formulë që llogarit dhe nxjerrë në pah ditët pas mbarimit të afatit.

Prokurori ose një person që ndihmon prokurorin duhet të plotësojë rregullisht listën. Në kolonën e parë shënohet numri i çështjes. Pastaj shënohet lloji i veprimit hetimor (marrja në pyetje e dëshmitarëve, marrja

në pyetje e të d'ysuarve, mbledhja e provave, kryerja e përgjimeve, ekzekutimi i urdhrave të sekuestrimeve dhe urdhrave të kontrollit, etj.) dhe emri i OPGJ-së kompetent. Data e caktimit të veprimit duhet të shënohet siç shpjegohet më sipër. Në kolonën ku shënohet afati që i jepet OPGJ-së duhet të shënohet vetëm numri i ditëve që jepen si afat (p.sh.: 15, 30, 45, etj.), duke mos përdorur asnjë shkronjë. Nëse afati është një muaj, atëherë duhet të shkruhet numri 30, që domethënë është 30 ditë.

Data e mbarimit të afatit llogaritet automatikisht. Gjithashtu numri i ditëve të kaluar pas mbarimit të afatit llogaritet automatikisht dhe nëse vonesa është më shumë se një ditë, qeliza bëhet e kuqe. Në kolonën tjetër shënohet dita e përfundimit të veprimitarisë. Edhe pse veprimtaria ka mbaruar, numri i ditëve që kanë kaluar pas mbarimit të afatit do të tregohet përsëri, por kolona do të bëhet e gjelbër, për të sinjalizuar veprimin e përfunduar. Në kolonën e fundit llogaritet automatikisht numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e veprimeve që i janë caktuar OPGJ-së.

Çdo kolonë ka një filtër dhe duke klikuar në shigjetë mund të përzgjidhen lloje të caktuara të të dhënave për analiza të mëtejshme dhe raporte statistikore. Për shembull, emri i OPGJ-së mund të zgjidhet për të parë të gjitha veprimet që i janë ngarkuar, veprimet që u ka kaluar afati (ato me ngjyrë të kuqe) dhe ditët e nevojshme për të përfunduar veprimet hetimore. Kjo do të bëjë të mundur që prokurori të ndjekë punën e OPGJ-ve dhe të përgatisë raporte statistikore për efektivitetin e tyre nëse lind nevoja.

**SHËNIM I RËNDËSISHËM:** Për funksionimin e duhur të listës së veprimtarive, duhet të merren parasysh disa gjëra:

- ⦿ Për qëllime të formulës në fletën e katërt, në fushën e parë në të majtë shfaqet data aktuale, dhe kjo fushë nuk duhet të ndryshohet.
- ⦿ Në mënyrë që formulat të funksionojnë, paraqitja e datës në dokument duhet të jetë e njëjtë me paraqitjen e datës në kompjuter. p.sh.: 09/27/2020 or 27/09/2020 or 09-27-2020 or 27-09-2020. Stafii i IT-së mund të shpjegojë se si vendoset data në kompjuter dhe cili format date duhet të përdoret në dokument.

## **Aneksi V** Shembull i planifikimit të hetimit për kundërvajtjet penale

Vepra penale raportohet sipas nenit 121 të Kodit Penal. Kjo vepër penale parashikohet në seksionin e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit. Vepra penale sipas nenit 121 është mbrojtja e privatësisë së dikujt dhe inkriminimi i ndërhyrjes në jetën private.

Objektivi kryesor i hetimit është të përcaktohet (i) nëse ka pasur ndërhyrje në privatësinë e dikujt dhe nëse po, (ii) si, kur dhe ku është bërë kjo dhe (iii) nga kush.

Planifikimi i hetimit për kundërvajtjet penale duhet të bëhet në urdhrin e hetimit. Më konkretisht, urdhri i prokurorit për ndërmarrjen e veprimeve hetimore duhet të përmbajë një kërkesë për:

- ⊙ përcaktimin e aspekteve të jetës private të personit që janë ekspozuar;
- ⊙ përcaktimin e *modus operandi*,
- ⊙ përcaktimin nëse personi, jeta private e të cilit është ekspozuar, ka dhënë pëlqimin e tij,
- ⊙ data, ora dhe vendi i ngjarjeve,
- ⊙ autori, duke përfshirë informacionin në lidhje me të shkuarën e tij/saj kriminale, gjendjen e punësimit, të ardhurat e rregullta, detyrimet ligjore dhe informacion tjetër të rëndësishëm që do ta ndihmojë prokurorin të propozojë dënimin e duhur.

Gjithashtu urdhri i hetimit duhet të përcaktojë qartazi pistat hetimore, përcaktimin e elementeve të veprës penale që duhen provuar për të pasur një çështje të fortë. Prokurori, kur përcakton pistat hetimore, duhet të përqendrohet në ato aspekte të krimit që u mungojnë provat e mjaftueshme. Prandaj prokurori duhet të kërkojë kryerjen e veprimeve hetimore që do të mundësojnë mbledhjen e provave në lidhje me rrethanat që nuk provohen mjaftueshëm.

Në shembullin e dhënë, gjëja e parë që duhet përcaktuar është nëse ka ndodhur ndërhyrja në privatësinë e dikujt dhe cili aspekt i jetës private të personit është ekspozuar. Këtu, prokurorët duhet të kenë parasysh se ndonjëherë provat që tregojnë *modus operandi* mund të jenë prova për aspektet e jetës private që po ekspozohen/janë ekspozuar (p.sh.: foto e shoqëruesit të personit, foto e raportit mjekësor të një personi ose përgjim i bisedave private të një personi).

Pyetja e dytë shumë e rëndësishme është përcaktimi i *modus operandi*. Kjo vepër penale mund të ketë disa *modus operandi* të ndryshme, përfshirë instalimin e pajisjeve të cilat shërbejnë për dëgjimin ose regjistrimin e fjalëve ose imazheve; dëgjimi i bisedave; regjistrimi; transmetimi i fjalëve; kapja; përgjimi; transmetimi i imazheve; publikimi i të dhënave. Nëse referimi i policisë nuk jep detaje të *modus operandi*, atëherë urdhri i prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore duhet të përmbajë kërkesën për përcaktimin e tij, duke shprehur qartë të gjitha mundësitë që parashikon ligji dhe duke kërkuar sqarime se cila pre këtyre mundësive ndodhi në të vërtetë.

Elementi i tretë për këtë vepër penale është mungesa e pëlqimit të personit, jeta private e të cilit është ekspozuar. Ky fakt mund të përcaktohet nga një deklaram i personit, në jetën private të të cilit ka ndodhur ndërhyrja. Prokurori mund të përgatisë pyetjet që OPGJ duhet të bëjë dhe duhet të përmendë kërkesat procedurale që ekzistojnë në mënyrë që deklarimi të merret në mënyrë të ligjshme. Kjo duket veçanërisht e rëndësishme nëse viktimi e dyshuar e krimit nuk mund ose nuk është në gjendje të japë pëlqimin, siç janë të miturit ose personat me probleme mendore.

Urdhri i hetimit gjithashtu duhet të adresojë provat e mbledhura, duke parashikuar rregulla se si prokurori pret që të organizohen dhe të paraqiten provat.

## Aneksi VI Planifikimi i hetimit

Plani i hetimit i bërë nga prokurori gjatë hetimeve, siç theksohet në Manual, mund të ketë formën e një urdhri hetimi. Arsyetimi për këtë është se aspektet kryesore që urdhri i hetimit duhet të mbulojë, trajtohen edhe në planin e hetimit.<sup>186</sup> Gjithashtu, do të ishte e dobishme për prokurorin që të mbajë në një vend të gjitha shënimet në lidhje me hetimin. Prandaj, hartimi i urdhrit të hetimit në mënyrë që të përfshijë aspektet më të rëndësishme të planit të hetimit mund të rezultojë praktik. Sidoqoftë, nëse prokurori gjen se ka shkaqe të arsyeshme për të mos përfshirë të gjitha aspektet e planifikimit në urdhrin e hetimit, mund të përgatitet një plan i veçantë hetimi.

Plani i hetimit duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm:

- objektivi dhe qëllimi i hetimit
- cilat prova kërkohen për të përmbushur objektivin e hetimit
- burimet e mundshme të provave / informacioneve
- udhëzimet për hetimin: cilat prova duhet të merren; si do të merren; kur do të merren, dhe kush do të mbledhë provat
- rreziqet e mundshme për hetimin
- menaxhimi i komunikimit
- rezultati i pritshëm

Prokurorët mund të përfshijnë afatet kohore që parashikohet se nevojiten për secilën fazë të hetimit. Kjo ndihmon në menaxhimin e pritshmërive të të gjitha palëve të përfshira.

---

<sup>186</sup> Nëse nevojitet planifikim më i detajuar, prokurorët mund të hartojnë plane taktike, siç shpjegohen në Manual.



## Format tip i një plani hetimi

### Autoriteti lëshues

### Data

### Vendi

### Lënda: Plani i hetimit

Në përgjigje të referimit (numri dhe/ose data e referimit që jep arsyet për regjistrimin e procedimit), të paraqitur nga (detaje në lidhje me atë që ka paraqitur referimin), në lidhje me (përshkrim i shkurtër i ngjarjes kriminale), lëshohet plani i mëposhtëm i hetimit:

*p.sh. Në përgjigje të referimit nr. 123 të datës 08.09.2020, paraqitur nga Departamenti Qendror i Policisë për Trafikimin e Drogës në Tiranë, në lidhje me trafikimin e dyshuar të lëndës narkotikëve sipas nenit 283/a të KP, ku përfshihet i dyshuari XX dhe YY, lëshohet plani i mëposhtëm i hetimit:*

### Seksion I

#### 1. Objektivi dhe fusha e hetimit

Kur përcakton objektivat e hetimit, prokurori duhet të nxjerrë në pah qëllimin që synon të arrijë hetimi dhe cilat pyetje duhet të marrin përgjigje nga hetimi. Gjithashtu, duhet të jepet një përshkrim i qartë i fakteve që duhet të konstatohen.<sup>187</sup> Kur përshkruan këto fakte, prokurori duhet të ketë parasysh krimin e dyshuar, dispozitat ligjore në KP dhe të gjithë *modus operandi* sipas të cilit mund të kryhet krimi.

*p.sh. Objektivi kryesor i hetimit është përcaktimi i fakteve dhe rrethanave të rëndësishme për verifikimin e gjetjeve në informacionin e referimit për kryerjen e një krimi sipas nenit 283/a të Kodit Penal. Prandaj, hetimi duhet të synojë mbledhjen e provave në lidhje me trafikimin e dyshuar të narkotikëve, duke dhënë përgjigje në lidhje me mënyrën e trafikimit të narkotikëve, llojin e narkotikëve në fjalë, fushën e veprimtarive*

<sup>187</sup> Duke përshkruar faktet që duhet të vërtetohen, përcaktohet qëllimi i hetimit. Prandaj, prokurorët duhet të sigurohen që të jepet gjithmonë përgjigje për pyetjet në vijim: çfarë ka ndodhur, kur, ku, kush ka marrë pjesë, si është kryer veprimi dhe pse.

*kriminale, personat e përfshirë dhe të ardhurat eventuale të krimit. Rrjedhimisht, duhet të konstatohen faktet e mëposhtme:*

- ⊙ *Çfarë ka ndodhur? Cila nga veprimtaritë e mëposhtme janë kryer: import, eksport, kalim tranzit ose tregtim?*
- ⊙ *Kur dhe ku ka ndodhur trafikimi i lëndëve narkotike? Si janë kryer veprimtaritë; si ishte modus operandi?*
- ⊙ *Për çfarë lloj lënde narkotike bëhet fjalë? A është trafikimi i kësaj lënde narkotike në kundërshtim me ligjin?*
- ⊙ *Kush ka marrë pjesë në trafikim? Cili ka qenë roli i tyre dhe cilat veprimtari janë kryer?*
- ⊙ *Cila ishte shtysa e personave të dyshuar? Nga se përbëhen të ardhurat nga krimi?*

## 2. Provat e kërkuara për të përmbushur objektivin e hetimit

Këtu prokurori duhet të përmendë të gjitha provat e kërkuara për të provuar çështjen para Gjykatës. Disa nga provat mund të jenë mbledhur tashmë, por megjithatë prokurori duhet të bëjë një listë të të gjitha provave të nevojshme. Kjo më vonë mund ta ndihmojë prokurorin të arrijë rezultatet përfundimtare të hetimit dhe të bëjë verifikimet përfundimtare në lidhje me nevojën për të kryer veprime hetimore shtesë. Gjithashtu, do të ishte e dobishme që OPGJ të dijë këndvështrimin e prokurorit për nevojën e përgjithshme për të përfunduar me sukses hetimin. Ky seksion nuk është detyrues, por është i dobishëm të përfshihet.

*p.sh. Për vërtetimin e fakteve, provat e mëposhtme rezultojnë se janë të detyrueshme:*

- ⊙ *Prova në lidhje me datën, orën dhe vendngjarjen;*
- ⊙ *Prova në lidhje me mënyrën në të cilën është bërë trafikimi (modus operandi)*
- ⊙ *Prova në lidhje me llojin e lëndës narkotike në fjalë*
- ⊙ *Prova në lidhje me personat e përfshirë në trafik*
- ⊙ *Prova në lidhje me veprimtaritë që kanë ndërmarrë personat e dyshuar dhe rolin e secilit prej të dyshuarve*
- ⊙ *Prova në lidhje me identifikimin e personave të dyshuar*

- ⊙ *Prova në lidhje me personat e tjerë që ishin të përfshirë*
- ⊙ *Prova në lidhje me produktet e veprës penale*

### 3. Burimet e mundshme të provave / informacioneve

Prokurori mund të tregojë burime të mundshme të provave dhe informacioneve, të cilat ai / ajo mendon se OPGJ duhet t'i marrë në konsideratë. Të menduarit mbi burimet e mundshme të provave, mund të zhvillojë më tej aftësitë hetimore të prokurorit.

*p.sh. Si një burim i mundshëm i provave, duhet të konsiderohet shtëpia e gjyshërve të të dyshuarit që ndodhet në një fshat të izoluar.*

## Seksioni II

Pištat e hetimit janë një nga veprimtaritë më të rëndësishme në planifikimin e hetimit sepse ato pasqyrojnë strategjinë e përgjithshme që prokurori ka për hetimin. Kur jep pištat e hetimit, prokurori duhet të ketë parasysh rreziqet e mundshme që mund të pengojnë hetimin dhe duhet të hartojë një strategji që do të mundësojë hetim efikas dhe efektiv. Prandaj, prokurori duhet të përcaktojë se cilat prova duhet të merren; si do të merren (përcaktohen veprimet hetimore<sup>188</sup>); kur do të merren (përcaktohet afati) dhe kush do të mbledhë provat (përcaktohet personi përgjegjës për kryerjen e veprimeve hetimore).

*p.sh. Gjatë hetimit, duke pasur parasysh provat e mbledhura deri tani nga OPGJ, duhet të merren provat e mëposhtme:*

- ⊙ *Prova në lidhje me llojin e lëndës narkotike në fjalë*
- ⊙ *Prova në lidhje me veprimtaritë që kanë ndërmarrë personat e dyshuar dhe rolin e secilit prej të dyshuarve.*
- ⊙ *Prova të mëtejshme në lidhje me modus operandi, që do të mundësojnë verifikimin e tregtimit të lëndëve narkotikëve si: prova se ku ka përfunduar lënda narkotike, kush ishin blerësit përfundimtarë, cili ishte çmimi në treg, çfarë sasive e lëndës narkotike është tregtuar dhe sa para i janë*

<sup>188</sup> Për të zgjedhur veprimin e duhur hetimor, prokurori mund të përdorë Diagramën e Veprimit Hetimor, që jepet në Aneksin VIII si një orientim.

*dhënë të dyshuarit XX nga kush, si janë paguar paratë dhe ku kanë përfunduar paratë.*

- ⊙ *Prova të tjera që mund të rezultojnë të rëndësishme.*

*Për qëllim të mbledhjes së provave, duhet të kryhen këto veprime hetimore:*

1. *Ekspertimi në lidhje me llojin e lëndës narkotike në fjalë.*
2. *Identifikimi i personave me interes.*
3. *Marrja në pyetje e dëshmitarëve.*
  - a. *Pronari i magazinës ku është bërë tregtia bazuar në atë që ka dhënë me qira magazinën; si ka kontaktuar fillimisht me qiradhënësin; me kë ka pasur personalisht kontakte; që kur është dhënë me qira magazina; si është paguar qiraja; si ka komunikuar me qiradhënësin; a ka një numër telefoni të personit që ka dhënë me qira magazinën; a mund ta njohë personin nëse i tregohet, etj.*
  - b. *Fqinja e të dyshuarit YY bazuar në periudhën që kur ajo jeton afër me YY; nëse dhe sa kohë ajo e njeh YY; nëse ajo ka vërejtur ndonjë aktivitet të pazakontë në shtëpinë e YY; që kur; sa shpesh kanë ardhur njerëz aty; afërsisht sa njerëz kanë vizituar shtëpinë e YY çdo ditë; a ka vërejtur ajo ndryshime në stilin e jetësës së YY; çfarë ndryshon, etj.*
4. *Kontrolli i vendeve dhe personave:*
  - a. *Kontrolli i banesës dhe i të dyshuarit XX*
  - b. *Kontrolli i banesës dhe i të dyshuarit YY*
  - c. *Kontrolli i banesës së gjyshit XX*
  - d. *Kontrolli i kompjuterëve që ndodhen në magazinë*
5. *Marrja e provave fizike dhe digjitale.*
6. *Marrja në pyetje e të dyshuarve.*
7. *Kërkesa për NNJ.*
8. *Çdo veprim tjetër hetimor që ka rezultuar i nevojshëm, pas konsultimit paraprak me prokurorin.*

*Veprimet hetimore duhet të kryhen sipas radhës më poshtë:*

- ⦿ *së pari duhet të merren prova fizike dhe digjitale, pas identifikimit të personave që mund të japin informacion të dobishëm. Ky veprim hetimor duhet të kryhet nga OPGJ e shërbimeve jo më vonë se 30 ditë nga data kur ata marrin urdhrin e hetimit;*
- ⦿ *mendimi i ekspertit duhet t'i jepet OPGJ-së së shërbimeve menjëherë, jo më vonë se 15 ditë nga data kur ata marrin urdhrin e hetimit;*
- ⦿ *të gjitha kontrollet e përcaktuara në seksionin 3 duhet të kryhen njëkohësisht. Kontrollet duhet të kryhen nga grupe të OPGJ-ve të seksioneve dhe OPGJ-ve të shërbimeve, jo më vonë se 10 ditë pas mbledhjes së provave fizike dhe digjitale dhe identifikimit të personave me interes;*
- ⦿ *marrja në pyetje e dëshmitarëve duhet të bëhet nga OPGJ-të e shërbimeve jo më vonë se 15 ditë pasi të jenë bërë kontrollet;*
- ⦿ *kërkesa për NNJ do të dërgohet nga prokurori menjëherë pas lëshimit të urdhrin të hetimit;*
- ⦿ *marrja në pyetje e të dyshuarve do të bëhet nga prokurori pasi të jenë mbledhur të gjitha provat.*

*Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së identitetit të dëshmitarit gjatë hetimit pasi ekziston rreziku i frikësimit të dëshmitarit.*

### **Seksioni III**

Avantazhet e përcaktimit të zinxhirit komandues dhe qarkullimit të informacionit, me këshilla se si t'i adresoni këto pyetje, u shtjelluan në Manual dhe Aneksat I dhe II. Është e dobishme që në planin e hetimit të përfshihet baza e referimit për komunikim, pasi prokurori do të jetë në gjendje të ketë kontroll më të mirë mbi qarkullimin e informacionit.

*p.sh. Lidhur me hetimin, OPGJ duhet të komunikojë vetëm me prokurorin. OPGJ mund t'i raportojë drejtuesit të policisë vetëm ditët kur OPGJ do të kryejë veprimet hetimore të caktuara nga prokurori. Detajet rreth veprimeve hetimore të*

*kërkuara, afatet e dhëna dhe detajet në lidhje me informacionin që OPGJ ka mbledhur në hetim nuk duhet të ndahen me drejtuesin e policisë.*

*Dosja e çështjes do të mbahet në zyrën e prokurorit. OPGJ duhet t'i paraqesë drejtpërdrejt prokurorit të gjitha provat e mbledhura.*

*OPGJ do të zhvillojë takime të detyrueshme çdo dy javë me prokurorin në zyrën e prokurorit të mërkurën në orën 10:00, duke filluar nga data 09.09.2020.*

#### **Seksioni IV**

Prokurorët mund të shtojnë një pjesë të fundit në planin e hetimit, duke përshkruar rezultatin që pritet, përmbajtjen e pritshme të relacionit përfundimtar, si edhe materialet që duhet t'i bashkëngjiten dhe mënyrën si duhet të paraqiten provat. Një sugjerim për përmbajtjen e relacionit shpjegues jepet në Aneksin II të Manualit.

*p.sh. Relacioni shpjegues do të hartohet nga OPGJ në zyrën e prokurorit. Provat duhet të paraqiten në rend kronologjik.*

## **Aneksi VII** Listat e kontrollit për rezultatet dhe verifikimet e kërkuara

### **Shënim shpjegues për listat e kontrollit**

Ka dy lloje kryesore listash kontrollit që janë të dobishme për kryerjen e hetimeve financiare. Këto lista kontrolli plotësohen nga OPGJ-të që kryejnë hetimet financiare.

E para është një **listë kontrolli për verifikimet e kërkuara**. Siç shpjegohet në manual, gjatë hetimeve financiare duhet të bëhen shumë verifikime, kështu që është e dobishme të mbahet një regjistër i të gjitha verifikimeve që janë bërë tashmë. Lista e kontrollit nuk është asgjë tjetër veçse një listë e thjeshtë ku shënohet emri i subjekteve nga të cilët janë kërkuar verifikimet, dhe lloji i verifikimeve të kërkuara dhe shtohet një shënim nëse verifikimi është kryer apo jo. Për secilin person për të cilin bëhen verifikime gjatë hetimit financiar duhet të plotësohet një listë e veçantë kontrolli.

Lista e dytë e kontrollit është një **listë kontrolli për rezultatet**. Në këtë listë kontrolli shënohen të gjitha rezultatet e hetimit financiar. Në kolonën e parë shënohet emri i të gjithë personave për të cilët janë bërë verifikimet. Pastaj shënohet një përmbledhje e të gjithë informacionit në lidhje me të dhënat e marra. Për shembull: numri i llogarive bankare, automjetet e gjetura, pasuritë e paluajtshme, etj. Duhet të theksohet se shënohet vetëm një informacion i shkurtër. Në fund përmenden personat e lidhur, pasi ata mund të përfshihen në hetimin financiar. Të gjitha informacionet e marra nga verifikimet e bëra për personat e lidhur duhet të shënohen në të njëjtën listë kontrolli. Kjo listë kontrolli është vetëm një përmbledhje e shkurtër e rezultatit të verifikimeve. Analizat dhe rezultatet e hetimeve financiare bëhen në një dokument të veçantë. Si një mjet praktik, kjo listë kontrolli shtohet në USB që përfshihet në këtë Manual.

**Çështja nr.:**

**Lista e kontrollit për kërkesat e dërguara gjatë hetimit financiar në lidhje me: (emri dhe mbiemri i personit)**

| <b>Kërkesa për të dhënat bankare (lista e të gjitha bankave në Shqipëri)</b>  |                            |   |
|---|----------------------------|---|
| p.sh.:  | Banka e Parë e Investimeve | X |
| 1   |                            |   |
| 2   |                            |   |
| 3   |                            |   |
| 4   |                            |   |
| 5   |                            |   |
| 6   |                            |   |
|   |                            |   |
| <b>Kërkesa për statusin e pronësisë përfituese (lista e bankave ose institucioneve të tjera prej të cilave kërkohen të dhënat)</b>  |                            |   |
| 1   |                            |   |
| 2   |                            |   |
| 3   |                            |   |
| 4   |                            |   |
| 5   |                            |   |
| 6   |                            |   |
|   |                            |   |
| <b>Kërkesa për transferim të shpejtë të parave (listë e të gjitha bankave ose institucioneve financiare të autorizuara për transferim të shpejtë të parave si Money Gram dhe Western Union)</b> |                            |   |
| 1   |                            |   |
| 2   |                            |   |
| 3   |                            |   |
| 4   |                            |   |
| 5   |                            |   |
| 6   |                            |   |



| <b>Kërkesa drejtuar shoqërive të sigurimit (lista e shoqërive të sigurimit ose kursimeve)</b> |  |  |
|---|--|--|
| 1   |  |  |
| 2   |  |  |
| 3   |  |  |
| 4   |  |  |
| 5   |  |  |
| 6   |  |  |
|   |  |  |
| <b>Kërkesa drejtuar fondeve të investimeve (lista e të gjitha fondeve të investimeve)</b>     |  |  |
| 1   |  |  |
| 2   |  |  |
| 3   |  |  |
| 4   |  |  |
| 5   |  |  |
| 6   |  |  |
|   |  |  |
| <b>Kërkesa të tjera</b>   |  |  |
| 1   | Agjenci pronash dhe pronash të paluajtshme (kadastra e shtetit)  |  |
| 2   | Agjenci aviacioni ose tjetër që mund të verifikojë pronësinë e avionëve, helikopterëve etj.  |  |
| 3   | Kapitaneria ose organ tjetër që mund të verifikojë pronësinë e anijeve, mjeteve të lundrimit etj.  |  |
| 4   | Ministria e Brendshme ose agjenci tjetër që mund të verifikojë pronësinë e automjeteve, motomjeteve etj.   |  |
| 5   | Autoriteti tatimor   |  |
| 6   | Doganat  |  |
| 7   | Agjenci sigurimi të depozitave   |  |
| 8   | Regjistri i bizneseve  |  |
| 9   | Subjekte të tjera të rëndësishme (p.sh.: FIU - është raportuar i dyshuari për një veprimtari të dyshuar; Deklarimi i pasurive në rastin e figurave publike etj.) |  |

# Aneksi VIII

## Diagrami për përzgjedhjen e veprimit hetimor të përshtatshëm

Shënim shpjegues për diagramin për përzgjedhjen e një veprimi hetimor

Diagrami për përzgjedhjen e një veprimi hetimor fillimisht u krijua duke përdorur një program kompjuterik “mind mapping”. Diagrami gjendet edhe në USB-në e përfshirë në këtë Manual.

Diagrami kryesisht përcakton të gjitha veprimet hetimore që KPP përshkruan në dy kategori kryesore: (i) veprime hetimore ndaj personave dhe (ii) veprime hetimore ndaj vendeve dhe sendeve. Që këtu, diagrami evidenton situata reale ku, në varësi të objektivit që duhet të arrihet me veprimin hetimor dhe situatave që mund të ekzistojnë, përshkruhen veprimet hetimore që mund të përdoren në arritjen e objektivit dhe rregullat bazë për vlefshmërinë e tyre (kush i urdhëron dhe në cilat situata).



### DIAGRAMI PËR PËRZGJEDHJEN E VEPRIMIT HETIMOR TË DUHUR

